



# KORNIZA LIGJORE DHE POLITIKE E TË DREJTAVE NJERZORE

me fokus në përfshirjen sociale dhe uljen e varfërisë



Ludwig Boltzmann  
Institute of Human Rights (BIM)



financed by

Austrian  
Development Cooperation

# KORNIZA LIGJORE DHE POLITIKE E TË DREJTAVE NJERZORE ME FOKUS NË PËRFSHIRJEN SOCIALE DHE ULJEN E VARFËRISË

## **Botues**

Ludvig Boltzman Instituti për të drejtat e njeriut – BIM-FV Shkup

**Përgatitja dhe botimi i këtij publikimi financiarisht është përkrahur nga Bashkëpunimi austriak për zhvillim (ADC)**

## **Përgatitje**

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut i Republikës së Maqedonisë

## **Projekt**

### **Të Drejtat Njerëzore dhe Përfshirja Sociale në Maqedoni**

Ludvig Boltzman Instituti për të drejtat njerëzore (BIM-FV Shkup)

Rr. Velko Vllahoviq nr. 1A-1/4 1000 Shkup

Tel: +389 (0)2 3216 956

Faks: +389 (0)2 3216 982

## **Zyra përkrahëse e BIM – FV në Shkup**

Petranka Dellova Milladinova – Drejtuese e projektit

Stojan Mishev – Këshilltar për të drejta njerëzore

Ninosllav Milladeoviq – Këshilltar për të drejta njerëzore

Jagoda Iljov – Asistent administrativ

**Gjatë përdorimit të të dhënave, ju lutemi përmendni burimin: “Korniza ligjore dhe politike e të drejtave njerëzore me fokus në përfshirjen sociale dhe uljen e varfërisë”, shkurt 2011**

**QËNDRIMET E SHPREHURA KËTU SI DHE ATO TË AUTORËVE JO GJITHMONË E SHFAQIN QËNDRIMIN ZYRTAR TË LLUDVIG BOLLTCMAN INSTITUTIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT (BIM-FV) DHE BASHKËPUNIMIT AUSTRIAK PËR ZHVILLIM (ADC)**

## PARATHËNIE

Për gati një dekadë, mbrojtja nga varfëria dhe ç'kycja sociale, që janë koncepte të ndërlidhura me kohezionin social dhe përfshirjen sociale, përdoren nga krijuesit e politikave ndërkombëtare dhe kombëtare si një ide udhëzuese për qëllimet dhe arritjet sociale në Evropë.

E përbashkët për të gjitha këto koncepte është ajo se ato kanë në fokus mirëqenien shoqërore dhe i shohin marrëdhëniet sociale të harmonizuara dhe qëndrueshme, si pjesë përbërëse të progresit ekonomik dhe social, si dhe të bashkekzistencës paqësore.

Nga ky aspekt, kryesore është shkalla se sa njerëzit ndjehen të lidhur me shoqërinë, si dhe besnikëria dhe zotimi i tyre për një sërë vlerash dhe qëllime sociale të cilat bashkëndahen nga të gjithë. E gjitha kjo mundet më mirë të shihet vetëm nga korniza e të drejtave njerëzore, në suazat e ndonjë lënde specifike ose konteksti institucional, siqë është rendi publik evropian i mbrojtjes së të drejtave njerëzore, i cili përfshin një numër të organizatave evropiane ndërqeveritare, duke përfshirë Këshillin e Evropës (KIE) dhe Bashkimin Evropian (BE).

Për më tepër në këtë kontekst, duhet të merret parasysh plotsueshmëria dhe ndërlidhshmëria mes "të drejtave sociale dhe ekonomike" – agjendë e dy organizatave evropiane të lartpërmendura, e cila është e ndërlidhur me sistemin përkatës të KB (p.sh. në aspekt të konventave për të drejtat dhe Objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit – OZHM) dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare dhe ndërqeveritare, duke përfshirë Organizatën ndërkombëtare të punës (ONP).

Lufta kundër varfërisë dhe ç'kycjes sociale, gjithashtu është vendosur shumë lartë në agjendën e Republikës së Maqedonisë, në veçanti gjatë disa viteve të fundit. Gjegjesisht, varfëria dhe ç'kycja sociale krijojnë probleme komplekse dhe shumëdimensionale për shtetin maqedonas dhe për shoqërinë po ashtu, zgjidhja e të cilave kërkon mobilizimin e një sere të gjerë të politikave dhe angazhimeve nga të gjitha palët kompetent në shtet.

Përkushtimi i zmadhuar i Republikës së Maqedonisë, mund të shihet përmes miratimit të një numri të madh të ligjeve dhe dokumenteve politike, të gjitha nga të cilat kanë për qëllim që ti trajtojnë çështjet e më larta dhe ti udhëzojnë përpjekjet shtetërore në këtë sferë.

Në këtë kontekst, duhet të rikujtohem se kjo e fundit është njëkohësisht e stimuluar dhe/ose e përforcuar nga anëtarësimi i shtetit në organizatat kryesore ndërkombëtare dhe ndërqeveritare, duke përfshirë edhe sistemin përkatës të KB, ONP dhe Këshillin e Evropës (KIE), përmes miratimit të konventave dhe instrumenteve të tjera të këtyre organizatave.

Kjo e fundit, ka të bëjë me kapacitetin e shtetit kandidat për anëtarësim në BE, gjë e cila ka dhënë baza shtesë për një sërë veprimesh specifike kombëtare në kontekstin e njëjtë, që (në plotësim të proceseve vijuese të miratimit të acquis së BEsë, përfshirë edhe ato nga sfera sociale) përfshin (në mënyrë të rëndësishme) proceset vijuese të përgatitjes së Memorandumit të përbashkët për përfshirje nga ana e shtetit, i cili duhet të përpilohet në bashkpunim me BE-në.

Mu këtu duhet të theksohet plotsueshmëria e përpjekjeve aktuale maqedonase për ti arritur prioritetet e BEsë në sferat ekonomike dhe sociale, si dhe ato të bazuara në detyrat dhe përkushtimet të cilat burojnë nga anëtarësimi i plotë në KIE, OKB (p.sh. sa i takon realizimit të OZHM), ONP dhe të tjera.

Aktualiteti i lartpërmendur i përpjekjeve të ndërlidhura me anti-varfërinë dhe ç'kycjen sociale në Republikën e Maqedonisë mund të shihet në Strategjinë kombëtare për ulje të varfërisë dhe ç'kycjes sociale në Republikën e Maqedonisë (2010), e cila qartas e reflekton përkushtimin e madh shtetëror lidhur me çështjet e më larta dhe sfidat e ndërlidhura me të cilat ballafaqohet shteti dhe shoqëria maqedonase.

Për dallim të prapavijës së më lartë, shikuar nga perspektiva e qëllimeve të ndërlidhura të projektit të BIM-FV "Ulja e varfërisë dhe të drejtave njerëzore në Maqedoni", ky botim ka për qëllim që ti japë informatat më relevante të qasjes së bazuar mbi të drejtat njerëzore të Këshillit të Evropës dhe BEsë, në trajtimin e çështjeve të anti-varfërisë dhe përfshirjes sociale.

Kjo bëhet duke u fokusuar më së shumti në të drejtat ekonomike dhe sociale. Është dizenuar që ti pajisë përdoruesit e

tij me dijeninë më thelbësore lidhur me të lartpërmendurën, duke i mundësuar ato të krijojnë një qasje dhe metodologji të përshtatshme në trajtimin e lëndës shumëdimensionale të anti-varfërisë dhe ç'kyçjes sociale, në kontekst të agjendës sociale aktuale të Maqedonisë.

Më saktësisht, ka për qëllim që ti mundësojë përdoruesit e tij, për të zbatuar një mbikqyrje të duhur dhe gjithëpërfshirëse mbi veprimet aktuale dhe të ardhshme të Maqedonisë në sferat e më larta dhe për ti stimuluar dhe udhëzuar ato që të bëhen veprues pro-aktiv në dizenjimin dhe zbatimin e veprimeve vendore, posaçërisht në procesin e zbatimit të Strategjisë kombëtare për ulje të varfërisë dhe ç'kyçjes sociale, si dhe ajo që është edhe më e rëndësishme, në fazën përgatitëse të përfundimit të Memorandumit të përbashkët për përfshirje të BEsë, dhe në veçanti gjatë zbatimit të tij.

Duke e pasur ndërmend të lartpërmendurën, ky botim përbëhet prej pjesëve të ardhshme:

Pjesa I ju për kushtohet arritjeve të Këshillit të Evropës në këtë sferë;

Pjesa II ju kushtohet arritjeve të BEsë në sferat e njëjta; dhe

Pjesa III e përmbledh kornizën e sotme ligjore të drejtave njerëzore dhe dokumentet politike për veprim të Republikës së Maqedonisë; kjo e fundit gjithashtu i përvijon detyrat e Maqedonisë sipas ligjit ndërkombëtar në sferat e më larta.

Megjithatë, duhet përmendur se ky botim nuk e zëvendëson atë që është cekur në botimin paraprak lidhur me këtë temë, të botuar nga projekti përkatës i Institutit Lludivig Bolltman, por më mirë thënë, ka për qëllim që ta freskojë dhe/ose rishqyrtojë atë, duke e kompletuar kornizën evropiane për të drejtat njerëzore të anti-varfërisë dhe ç'kyçjes sociale (siqë është reflektuar në arritjet përkatëse të KiE dhe BEsë).

## TABELA E PËRMBAJTJES

	<b>PJESA E PARË: KORNIZA LIGJORE DHE POLITIKE E KËSHILLIT TË EVROPËS PËR ANTI-VARFËRI DHE KOHEZION SOCIAL</b>	<b>7</b>
1.1	Mbrojtja e të drejtave socio-ekonomike përmes Konventës evropiane për të drejta njerëzore (KEDNJ): Tendencat dhe zhvillimet në Gjyqin evropian për të drejta njerëzore	7
1.2	Instrumentet ligjore (vendoshmëria e standardeve) të KiE në sferën sociale	8
1.2.1	Karta sociale evropiane	8
1.2.1.1	Protokolli shtesë i Kartës sociale evropiane	9
1.2.1.2	Protokolli amendues i Kartës sociale evropiane	9
1.2.2	Karta sociale evropiane (e revizionuar)	9
1.2.3	Protokolli shtesë i cili mundëson një Sistem të ankesave kolektive	11
1.3	Instrumentet ligjore të Këshillit të Evropës lidhur me politikat e sigurimit social	11
1.4.	Politikat e Këshillit të Evropës për çështje tjera të ndërlidhura	12
1.4.1	Politikat banuese të KiE	12
1.4.2	Politikat invalidore të KiE	12
1.4.3	Politikat e KiE lidhur me fëmijët dhe familjen	13
1.4.4	Politikat e KiE lidhur me romët	13
	<b>PJESA E DYTË: KORNIZA LIGJORE DHE POLITIKE E BEsë NË FUSHËN E ANTI-VARFËRISË DHE PËRFSHIRJES SOCIALE</b>	<b>14</b>
2	Vlera shtuese e Traktatit të Lisbonit të BEsë në sferën e anti-varfërisë dhe përfshirjes sociale	14
2.1	Nenet kryesore të Traktatit të Lisbonit të BEsë për punësim, politikë sociale dhe shëndetësi publike	15
2.1.1	Baza ligjore e BEsë për punësim	15
2.1.2	Baza ligjore e politikës sociale të BEsë	16
2.1.3	Baza ligjore e BEsë lidhur me politikat e shëndetit publik	17
2.2	Karta e të Drejtave fundamentale e BEsë	18
2.3	Metoda e hapur e koordinimit (MHK)	19
2.3.1	Objektivat e përbashkëta të MHK	19
2.3.2	Treguesit e përbashkët të MHK	20
2.3.3	Raporte kombëtare për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale	20
2.3.4	Raportet e përbashkëta të MHK	21
2.3.5	MHK Programi veprues i komunitetit	21
2.3.6	Vlerësimi i ndikimit dhe përforcimi i MHK	21
2.4	Agjenda sociale e revizionuar e BEsë	21
2.5	EVROPA 2020- Një strategji evropiane për zhvillim të mençur, qëndrueshëm dhe përfshirës	21
2.6	Acquis të BEsë të përzgjedhura në sferat relevante për anti-varfërinë dhe përfshirjen sociale	22
2.6.1	Mbrojtja e të drejtave të punonjësve	22
2.6.1.1	Rregulloret e BEsë për shëndetësi dhe siguri në punë	23
2.6.2	Acquis e BEsë në sferën e sigurimit social	23
2.6.3	Politikat e BEsë në sferat e shëndetësisë publike	23
2.6.3.1	Politikat e shëndetësisë mentale të shteteve anëtare të BEsë	24
2.6.4	Siguria e pacientit dhe parandalimi i infeksioneve që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor	24
2.6.5	Politikat e BEsë lidhur me çështjet e invaliditetit	24
2.6.6	Politikat e BEsë lidhur me personat e moshuar	25
2.6.7	Politikat e BEsë për barazinë mes burrave dhe grave	26
2.6.8	Politikat e BEsë lidhur me varfërinë femërore	26
2.6.9	Politikat e BEsë të ndërlidhura me romët	27
2.6.10	Forma të tjera të ç'kyçjes sociale në nivel të BEsë	27
2.7	Roli i praktikës ligjore të Gjykatës evropiane për drejtësi në sferat e anti-varfërisë dhe përfshirjes sociale	28
2.8	Kontributi i BEsë në OZHM të KB	29



## **PJESA E TRETË: KORNIZA LIGJORE DHE POLITIKE MAQEDONASE NË SFERËN E ANTI-VARFËRISË DHE PËRFSHIRJES SOCIAL**

**30**

3.1	Shqyrtim i neneve të përzgjedhura kushtetuese	31
3.2	Korniza ligjore dhe politike maqedonase në sferat e anti-varfërisë dhe përfshirjes sociale	33
3.2.1	Korniza ligjore dhe politike e punës	33
3.2.2	Korniza ligjore dhe politike për mbrojtje sociale	34
3.2.3	Korniza ligjore dhe politike për mbrojtje shëndetësore dhe sigurim shëndetësor	35
3.2.4	Legjisllacioni i sigurimin pensional dhe invalidor	35
3.2.5	Korniza ligjore dhe politike lidhur me çështjet gjinore	36
3.2.6	Korniza ligjore dhe politike e banimit	37
3.2.7	Korniza ligjore dhe politike lidhur me invaliditetin	37
3.3	Korniza ligjore dhe politike lidhur me mbrojtjen fëmijore	37
3.4	Korniza ligjore dhe politike për mbrojtjen e grave	38
3.5	Ligje të tjera të përzgjedhura në sferat e anti-varfërisë dhe ç'kyçjes sociale	38
3.5.1	Legjisllacioni i anti-diskriminimit	38
3.5.2	Dhënie e ndihmës juridike falas	39
3.6	Korniza ligjore dhe politike për mbrojtjen e kategorive tjera të personave të prekshëm	39
3.6.1	Të huajt dhe refugjatët	39
3.6.2	Mbrojtja e romëve	40
3.6.3	Mbrojtja e personave të moshuar	40
3.6.4	Korniza për pakicat kombëtare	40
3.7	Roli i zhvillimit regjional në anti-varfëri dhe ç'kyçje sociale	41
3.8	Korniza e ndërlidhur me komunikimin elektronik	41
3.9	Mbikqyrja e obligimeve të Maqedonisë lidhur me ligjin ndërkombëtar për të drejtat njerëzore	42
3.9.1	Mbikqyrja e obligimeve të Maqedonisë lidhur me instrumentet e përzgjedhura ligjore të KB	42
3.9.2	Mbikqyrja e obligimeve të Maqedonisë lidhur me instrumentet ligjore të ONP	43
3.9.3	Mbikqyrja e obligimeve të Maqedonisë lidhur me Kartën sociale evropiane të KiE	43
3.9.4	Obligimet e Maqedonisë lidhur me statusin e kandidatit për anëtarësim në BE	43

**Shtojca 1:** Lista e instrumenteve ligjore të ONP të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë **46**

**Shtojca 2:** Lista e instrumenteve të përzgjedhura ligjore të Këshillit të Evropës dhe statusi i tyre ratifikues në Republikën e Maqedonisë **50**

**Shtojca 3:**Lista e marrëveshjeve bilaterale të Maqedonisë në sferën e sigurimit social **52**

**Bibliografi e përzgjedhur** **53**

## LISTA E SHURTESAVE

**KDF** - Konventa për të drejtat femënore  
**KiE** - Këshilli i Evropës  
**KDESK** - Komiteti për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore  
**KEDNG** - Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave  
**KEDNJ** - Konventa evropiane për të drejta njerëzore  
**GJEDNJ** - Gjykata evropiane për të drejta njerëzore  
**KEDS** - Komiteti evropian për të drejta sociale  
**KERJ** - Komisioni evropian kundër racizmit dhe jotolerancës  
**BE** - Bashkimi Evropian  
**STE** - Seria e traktateve evropiane  
**ONP** - Organizata ndërkombëtare e punës  
**OZHM** - Objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit  
**MHK** - Metoda e hapur e koordinimit  
**KSR** - Karta sociale evropiane (e revizionuar)  
**TFBE** - Traktati për funksionimin e Bashkimit Evropian  
**KB** - Kombet e Bashkuara

## 1. KËSHILLI I EVROPËS: KORNIZA LIGJORE DHE POLITIKE PËR ANTI-VARFËRI DHE KOHEZION SOCIAL

### 1.1 Mbrojtja e të drejtave socio-ekonomike përmes KEDNJ: tendencat dhe zhvillimet në GJEDNJ

Në trajtimin e çështjeve komplekse, së pari duhet të theksohet se në përjashtim të Protokolit të parë (Nenet 1 dhe 2 të cilat përcaktojnë të drejtën e pronës dhe të drejtën e arsimit), KEDNJ gati plotësisht fokusohet në kanunin tradicional të të drejtave civile dhe politike.

Në shikim të parë shumë pak thotë për mbrojtjen e lirive të tjera nga dëshira dhe koproacia, ose promovimin e progresit social dhe standardit më të mirë jetësor në aspekt të lirive më të gjëra.

Megjithatë, që nga rasti Airey kundër Irlandës, GJEDNJ pranoi se ka përputhje në mes të drejtave civile dhe politike brenda KEDNJ, një pamje e cila ka vazhduar që të shqyrtohet.

Edhe pse të vetëdëshëm për kufizimet e intervenimit të tij legjitim në resursin kombëtar i cili e përcakton politikën, GJEDNJ ka vazhduar që ti shtojë themelet për një trup të jurisprudences së të drejtave socio-ekonomike, përmes interpretimi shtues të kanunit tradicional të të drejtave civile dhe politike dhe zhvillimit të detyrave pozitive shtetërore në nenet 2, 3 dhe 8 dhe nenet 6 dhe 14 të KEDNJ.

#### Protokolii i parë i KEDNJ

##### Neni 1

Çdo person fizik ose juridik e ka të drejtën e gëzimit paqësor të pronave të tij. Asnjëri nuk do të privohet nga pronat e tij, vetëm në rast të interesit publik dhe nënshtrimit të kushteve të parashtruara me ligj dhe nga parimet e përgjithshme të ligjit ndërkombëtar. Sidoqoftë, nenet paraprirëse në asnjë mënyrë nuk do ta dëmtojnë të drejtën e shtetit për ti zbatuar ligjet e tilla atëherë kur ka nevojë të kontrollohet përdorimi i pronës, në pajtim me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave ose kontributeve tjera ose ndëshkimeve.

##### Neni 2

Asnjërit personi nuk do ti mohohet e drejta e arsimit. Në zbatimin e çfarë do funksioni të cilin e ndërmerr lidhur me arsimin dhe mësimdhënien, shteti do ti respektojë të drejtat e prindërve, për të siguruar një arsimim dhe mësimdhënie në pajtim me religjionet dhe bindjet e tyre filozofike.

Ka shumë raste të GJEDNJ, të cilat mund ta ilustrojnë potencialin e saj për ti mbrojtur të drejtat ekonomike dhe sociale (siqë janë përmbledhur në instrumente tjera ndërkombëtare juridike, duke përfshirë Konventën për të drejtat femërore të KB (KDF).

**Nenet 3** dhe 8 të KEDNJ, dëshmojnë se është bërë progres drejt një jurisprudence parimore të detyrimeve pozitive, e cila do ti sigurojë nevojat bazike njerëzore të individëve të varur dhe të prekshëm në një gamë kontekstesh, edhe pse kufizimet e përgjegjësisë shtetërore mbesin ende fluide dhe të kontestuara. Në këtë aspekt, vlen që të theksohen zhvillimet më të reja në nenin 14 – jurisprudenca e ndërlidhur, në veçanti siqë është manifestuar në rastin e "D.H. kundër Republikës së Çekisë" (Aplikacioni numër 57325/00, 13 nëntor 2007), që është një sinjal për zhvendosjen nga një qasje të ngushtë formale, në një e cila i trajton çështjet e diskriminimit.

Instrumenti i parë juridik i Kie i cili merret ekskluzivisht me çështjet sociale është Karta sociale evropiane e 1961 (STE Nr. 035). Në sferën e të drejtave ekonomike dhe sociale është homologe me



## 1.2 Instrumentet ligjore të KIE në sferën sociale (vendosmëria e standardeve)

### 1.2.1 Karta sociale evropiane

Në **Pjesën e II** përcaktohet se:

“Palët kontraktuese, siqë është prezantuar në pjesën e III, ju nënshtrohen detyrimeve të përvijuara në artikujt e ardhshëm:

- **Neni 1** e drejta e punës;
- **Neni 2** për të drejtën e kushteve të drejta të punës;
- **Neni 3** për të drejtën e kushteve të sigurta dhe të shëndosha në punë;
- **Neni 4** për të drejtën e pagës së ndershme;
- **Neni 5** për të drejtën e organizimit;
- **Neni 6** për të drejtën e marrëveshjes kolektive;
- **Neni 7** për të drejtën e fëmijëve dhe personave të rinj në mbrojtje;
- **Neni 8** për të drejtën e grave të punësuar në mbrojtje;
- **Neni 9** për të drejtën e orientimit profesional;
- **Neni 10** për të drejtën e trajnimit profesional;
- **Neni 11** për të drejtën e mbrojtjes së shëndetit;
- **Neni 12** për të drejtën e sigurimit social;
- **Neni 13** për të drejtën e ndihmës sociale dhe mjekësore;
- **Neni 14** për të drejtën e përfitimit nga shërbimet e mirëqenies sociale;
- **Neni 15** për të drejtën e personave me hendikep fizik dhe mental në trajnim profesional, rehabilitim dhe pjesëmarrje;

Konventën evropiane për të drejtat njerëzore. Pjesët më relevante të Kartës janë pjesa e I, e II dhe e III.

### Pjesa e I e Kartës:

“Palët kontraktuese pranojnë si qëllim të politikës së tyre, përdorimin e të gjitha masave të përshtatshme, me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, për të krijuar kushte me të cilat të drejtat dhe parimet e ardhshme mund efektivisht të realizohen: secili do ta ketë mundësinë që të sigurojë jetesën nëpërmjet një profesioni të zgjedhur lirshëm; të gjithë punëtorët e kanë të drejtën e kushteve të sigurta dhe të shëndosha; të gjithë punëtorët kanë të drejtë që të marrin pagë të mjaftueshme për një standard të denjshëm jetësorë për veten dhe familjet e tyre; të gjithë punëtorët dhe punëdhënësit e kanë të drejtën e lirisë për tu bashkuar në organizata kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e interesave të tyre ekonomike dhe sociale; të gjithë punonjësit dhe punëdhënësit kanë të drejtë që të bëjnë marrëveshje kolektive; fëmijët dhe personat e rinj e kanë të drejtën e një mbrojtje speciale nga rreziqet fizike dhe morale të cilave u janë të ekspozuar; gratë e punësuar, në raste të shtatëzansisë si dhe përshtatshëm edhe gratë tjera të punësuar kanë të drejtë në një mbrojtje të posaçme në punën e tyre; secili ka të drejtë në paisje të përshtatshme për orientim profesional për ti ndihmuar atij për të zgjedhur një punë në pajtim me aftësitë dhe interesat e tij personale; secili ka të drejtë në paisje të përshtatshme për trajnim profesional; secili ka të drejtë të përfitojë nga të gjitha masat të cilat e mundësojnë atë që ta gëzojë standardin më të lartë të shëndetit i cili mund të arrihet; të gjithë të punësuarit dhe të varurit prej tij e kanë të drejtën e sigurimit social; secili pa resurse të përshtatshme ka të drejtën e ndihmës sociale dhe mjekësore; secili e ka të drejtën për të përfituar nga shërbimet e mirëqenies sociale; personat me invaliditet kanë të drejtë në trajnim profesional, rehabilitim dhe pjesëmarrje, pavarësisht të origjinës dhe natyrës së invaliditetit të tyre; familja si njësi kryesore e shoqërisë e ka të drejtën e një mbrojtje të përshtatshme sociale, juridike dhe ekonomike për ta siguruar zhvillimin e plotë të saj; nënat dhe fëmijët, pavarësisht të statusit të tyre martesor dhe lidhjeve familjare e kanë të drejtën e mbrojtjes së përshtatshme sociale dhe ekonomike; qytetarët e cilës do pale kontraktuese e kanë të drejtën e angazhimit në secilin punësim profitabil në territorin e secilit të shteteve tjera, barabart me shtetasit e atij shteti, subjekt i restriksioneve të bazuara për shkaqe ekonomike dhe sociale; punëtorët migrantë të cilët janë shtetas të një pale kontraktuese dhe familjet e tyre e kanë të drejtën e mbrojtjes dhe ndihmës në territorin e secilës pale tjetër kontraktuese”.

Pjesa III e Kartës përmban 20 Nene, e cila (mes tjerave) përcakton se:

“Secila nga palët kontraktuese duhet ta marrë parasyshtë Pjesën e I të kësaj karte, si një deklaratë për qëllimet të cilat do ti synojë përmes të gjitha masave të përshtatshme, siqë është cekur në paragrafin hyrës të asaj pjese; për ta llogaritur veten të nënshtrouar nga më së paku pesë nenet e ardhshëm të pjesës së II të kësaj karte: Neni 1, 5, 6, 12, 13, 16 dhe 19; në plotësim të neneve të cilat janë të përzgjedhura nga vetë shteti, në pajtim me nën-paragrafet paraprirëse dhe të jetë përgjegjëse përpara një numri të tillë të neneve ose paragrafeve të numruara në pjesën e II të kartës, duke u kujdesur që numri total i neneve ose paragrafeve të numruara,

### 1.2.1.1 Protokollin shtesë i Kartës sociale evropiane (STE Nr. 128)

të cilave u nënshtrohet, mos jetë më i vogël se 10 nene ose 45 paragrafe të numruara....

Secila palë kontraktuese do të mirëmbajë një sistem të inspektimit të punës në përputhje me gjendjet kombëtare”.

Protokollin shtesë i 1998 (STE Nr. 128) i zgjeron të drejtat sociale dhe ekonomike, të garantuara me Kartën sociale evropiane të 1961 (STE Nr. 035), duke i shtuar të drejtat e ardhshme: e drejta e punëtorëve në mundësi të barabarta dhe trajtim të barabartë lidhur me çështjet e punësimit dhe profesionit, pa diskriminim në bazë të gjinisë; e drejta e punëtorëve për tu informuar dhe konsultuar përbrenda ndërmarrjeve; e drejta e punëtorëve të marrin pjesë në përcaktimin dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe mjedisit të punës në ndërmarrje; e drejta e personave të moshuar në mbrojtje sociale.

### 1.2.1.2 Protokollin amendues i Kartës sociale evropiane (STE Nr. 142)

Ky protokoll u hap për nënshkrim më 1991 dhe do të hyj në fuqi atëherë kur do të ratifikohet nga të gjitha palët e Kartës (STE Nr. 35). Megjithatë, Komiteti i ministrave më 11 dhjetor 1991, miratoi vendimin e ardhshëm lidhur me zbatimin e tij: “Deputetët ... 4., kërkuan që palët shtetërore dhe trupat mbikqyrëse të parashohin disa masa të caktuara, të dhëna në këtë protokoll, në një shkallë të lejueshme nga vetë teksti i kartës, përpara se i njëjti të hyj në fuqi”.

### Protokollin amendues konsiderueshëm e përmirëson maqinerinë kontrolluese të kartës (STE Nr. 035 dhe 163 siqë janë përvijuar më poshtë).

### 1.2.2 Karta sociale evropiane (e revizionuar) (STE Nr. 163)

Karta sociale evropiane (e revizionuar - KSR) e 1996, i përfshin në një instrument të gjitha të drejtat e garantuara nga Karta e 1961 dhe protokollet shtesë të saj të 1988 (STE Nr. 128).

### Mbikqyrja e zbatimit të Kartës sociale evropiane

Pas ratifikimit të këtij instrumenti, palët kontraktuese shtetërore duhet të dorëzojnë raporte në Këshillin e Evropës për atë se si e kanë zbatuar Kartën. Këto raporte janë publike dhe partnerët social mund ti vëzhgojnë ato. Komiteti evropian për të drejta sociale (KEDS) është ai i cili ka detyrë për të vlerësuar se nëse shtetet i kanë respektuar detyrimet e tyre.

Ky komitet përbëhet prej nëntë ekspertëve të pavarur dhe të paanshëm. Konkludimet e KEDS i transmetohen Komitetit shtetëror, i cili përbëhet prej përfaqësuesve shtetëror. Në këtë komitet, shtetet e përfaqësuara sigurohen që secila prej tyre ti ndërmarrë masat e nevojshme, për të krijuar një situatë e cila është në pajtim me Kartën. Në rastet më serioze, Komiteti i ministrave, trupi vendim-marrës në Këshillin e Evropës, u bën rekomandime shteteve që ato ta ndryshojnë legjislacionin, rregulloret ose praktikën e cila nuk është në përputhje me detyrimet e Kartës.

E merr parasyshë evoluimin i cili ka ndodhur në Evropë prej kur Karta origjinale është miratuar në 1961 dhe përfshin një sërë të drejtave të reja (siqë është mbrojtja nga varfëria dhe ç'kyçja sociale, e drejta e banimit, e drejta e mbrojtjes në rast të përfundimit të punësimit), si dhe ka bërë një sërë amandmanesh, duke përfshirë edhe përforsimin e parimit të jodiskriminimit, përmirësim të barazisë gjinore në të gjitha sferat të përfshira nga traktati, mbrojtje më e mirë e amësisë dhe mbrojtje sociale e nënave, mbrojtje më e mirë sociale, juridike dhe ekonomike e fëmijëve të punësuar dhe mbrojtje më e mirë e personave me invaliditet.

Ky instrument është projektuar në një mënyrë që të jetë autonom, mirëpo me maqinerinë e njëjtë mbikqyrëse si edhe në Kartën. Nuk hyn në konflikt me Kartën, por ka për qëllim që gradualisht ta zëvendësojë atë<sup>1</sup>.

Për të përfunduar në kontekstin e më lartë duhet të përmendet edhe Neni C, i cili merret me mbikqyrjen e zbatimit të detyrimeve të përmbytura në këtë Kartë; i cili thotë se: “zbatimi i detyrimeve ligjore të përmbytura në Kartën do të jetë i parashtruar në mbikqyrjen e njëjtë si edhe Karta Sociale Evropiane”, siqë edhe është përvijuar më poshtë.

1. Kjo rregullohet nga Neni B i Kartës sociale të revizionuar, i cili merret me lidhjet mes Kartës sociale evropiane dhe Protokollit shtesë të 1988.

Në kontekstin e më lartë, ai i cili është në veçanti i rëndësishëm është sistemi i ri i themeluar lidhur me prezantimin e raporteve për zbatimin e Kartës sociale evropiane. Sipas shtetit të ri:

“Pritet që shtetet të prezantojnë raport në nivel vjetor për një pjesë të neneve të Kartës (qoftë ajo e vitit 1961 ose Karta e revizionuar e 1996), ku nenet janë të ndara në katër grupe tematike. Në këtë mënyrë, secili nen i Kartës duhet të paraqitet një here në çdo katër vite. Katër grupet e neneve janë të hartura siqë vijon:

<b>Grupi 1 Punësim, trajnim dhe mundësi të barabarta</b>	
- Neni 1	- Neni 18
- Neni 9	- Neni 20
- Neni 10	- Neni 24
- Neni 15	- Neni 25

<b>Grupi 2 Shëndetësi, sigurim social dhe mbrojtje sociale</b>	
- Neni 3	- Neni 14
- Neni 11	- Neni 23
- Neni 12	- Neni 30
- Neni 13	

<b>Grupi 3 Të drejtat e punës</b>	
- Neni 2	- Neni 22
- Neni 4	- Neni 26
- Neni 5	- Neni 28
- Neni 6	- Neni 29
- Neni 21	

<b>Grupi 4 Fëmijë, familje, migrantë</b>	
- Neni 7	- Neni 19
- Neni 8	- Neni 27
- Neni 16	- Neni 31
- Neni 17	

Raportet duhet të prezantohen më 31 tetor të çdo viti. Komiteti evropian i të drejtave sociale i boton konkludimet e tij përpara përfundimit të vitit pasues. Sistemi hyri në fuqi që nga 2007. Shtetet të cilat para pak kohe e kanë ratifikuar Kartën sociale të 1961 tani nuk duhet të dërgojnë raporte të plota, si dhe më nuk ka raporte mbi të gjitha nenet jothelbësore për shtetet të cilat së shpejti e kanë ratifikuar Kartën sociale të 1996.

*Në përmbyllje, në veçanti duhet të merret parasyshë Neni D (i KSR), i cili i trajton “ankesat kolektive”.*

*Siqë përcaktohet nga ky nen: “Nenet e protokollit shtesë të Kartës sociale evropiane, të cilat mundësojnë një sistem të ankesave kolektive, do të vlejnjë për detyrimet (të cilat burojnë nga kjo kartë) e shteteve të cilat e kanë ratifikuar protokollin e përmendur.*

*Çdonjë shtet i cili nuk i nënshtrohet Protokollit shtesë të Kartës sociale evropiane, i cili e rregullon sistemin kolektiv të ankesave, mundet gjatë depozitimit të instrumenteve të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit të kësaj karte, ose në çdo kohë tjetër, të deklarojë përmes një lajmërimi të drejtuar tek Sekretari gjeneral i Këshillit të Evropës se e pranon mbikqyrjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Karte, duke e ndjekur procedurën e cila është dhënë në protokollin e përmendur”.*

### 1.2.3 Protokoli shtesë i cili mundëson një Sistem të ankesave kolektive (STKE 158)

Qëllimi i këtij protokoli është që ta përmirësojë efikasitetin e maqinerisë mbikqyrëse në të lartpërmendurën kartë sociale, duke mundësuar që ankesat kolektive të cilat pohojnë dhunime të Kartës, të zgjidhen, në plotësim të procedurës aktuale për kontrollimin e raporteve qeveritare.

Entitetet të cilat kanë mundësi që të dorëzojnë ankesa kolektive janë: organizata ndërkombëtare të punëtorëve dhe sindikata të cilat marrin pjesë në punën e Komitetit qeveritar i cili e ndjek nenin 27, paragrafin 2 të Kartës; organizata tjera joqeveritare ndërkombëtare me status këshillues në Këshillin e Evropës dhe të cilat paraqiten në një listë speciale e cila është krijuar për këtë qëllim nga Komiteti qeveritar; organizata kombëtare të punëtorëve dhe sindikata nga palët kontraktuese.

Në plotësim, secili shtet i cili është palë kontraktuese mundet, me një deklaratë deri tek Sekretari gjeneral, ti autorizojë organizatat joqeveritare kombëtare që të inicojnë ankesa.

### 1.3 Instrumentet ligjore të Këshillit të Evropës lidhur me politikat e sigurimit social

#### Instrumentet bazike të KIE që përcaktojnë standardet në këtë sferë:

- Kodi evropian i sigurimit social dhe Protokoli i tij, dhe
- Kodi evropian i sigurimit social i revizionuar.

Këto instrumente të specializuara të sigurimit social krijojnë një komponentë thelbësore për mbrojtjen e të drejtave njerëzore përmes Këshillit të Evropës.

#### Instrumentet koordinuese të Këshillit të Evropës, të qëlluara për koordinimin e përkujdesjes së sigurimit social:

- Marrëveshja e brenshme evropiane për skemat e sigurimit social lidhur me moshën e vjetër, invaliditetin dhe të mbijetuarit (STE Nr. 012), të plotësuar me Protokollin (STE Nr. 012A)
- Marrëveshja e brenshme evropiane për sigurimin social ndryshe nga skemat për moshën e vjetër, invaliditet dhe të mbijetuarit (STE Nr. 013), të plotësuar me Protokollin (STE Nr. 013A)
- Konventa evropiane për asistencë sociale dhe mjekësore (STE Nr.014, të plotësuar me Protokollin STE Nr.014A)
- Konventa evropiane për sigurim social (STE Nr.078)
- Protokollin (STKE Nr. 078A)

Karta sociale evropiane e rregullon “Të drejtën e sigurimit social”; shtetet të cilat e kanë ratifikuar Kartën sociale evropiane të revizionuar dhe të cilat e kanë pranuar Nenin 12, paragrafin 2, janë të detyruara që ta mirëmbajnë sistemin e sigurimit social në një nivel të kënaqshëm, së paku të barabartë me atë që është e nevojshme për ratifikimin e Kodit evropian të sigurimit social.

Prandaj, promovimi i Kodit evropian për sigurim social, shihet për të qenë si një nga detyrat kryesore të Këshillit të Evropës në qëllimin për të siguruar vlera të përbashkëta në sferën e kohezionit social në shtetet anëtare të tij.

Kodi dhe Protokoli i tij nuk e kërkojnë standardizimin e sistemeve kombëtare të sigurimit social; ato vetëm sqarojnë se çfarë duhet të arrihet, duke i lënë liri çdo shteti për të përcaktuar se si do arrihet kjo; ka nëntë çështje (gjithashtu të njohura si “rreziqe sociale”) dhe ato janë: kujdes mjekësor, beneficion për smundje, beneficion për papunësi, beneficion për personat në moshë, beneficion për lëndim në punë, beneficion për familje, beneficion për amësi, beneficion për invaliditet, beneficion për të mbijetuarit.

Sa i takon Kodit të revizionuar, duhet të nënvizohet se ai i reflekton disa nga zhvillimet në filozofinë e sigurimit social gjatë njëzet e dy viteve të fundit, gjegjësisht në mes hyrjes në fuqi të Kodit dhe finalizimit të Kodit të revizionuar. Në mënyrë më të rëndësishme, njëjt edhe si Kodi, Kodi i revizionuar veçon nëntë çështje duke e lejuar secilin shtet ti përzgjedhë rreziqet sociale të cilat do ti trajtojë. Megjithatë, për dallim të Kodit, Kodi i revizionuar të gjitha çështjeve ju jep rëndësi të barabartë. Mundëson fleksibilitet të nevojshëm për tu ballafaquar me sfidat e sodit, siqë është popullsia në pleqërim dhe kostot e rritura për kujdes mjekësor si dhe sfidat e të nesërmes, pavarësisht nga ajo se çfarë mund të jenë ato<sup>2</sup>.

2. Kini ndërmend se deri sot, Kodi i revizionuar nuk është ratifikuar nga asnjëri shtet-anëtar i Këshillit të Evropës (qershor 2010); kështu që ende nuk ka hyrë në fuqi.

## 1.4. Politikat e Këshillit të Evropës për çështje tjera të ndërlidhura

### 1.4.1 Politikat banuese të Këshillit të Evropës

Një numër i rregullave të KEDNJ japin mbrojtje të elementeve kryesore lidhur me të drejtën e banimit. Në këtë aspekt, duhet të theksohet se (mes tjerave), sipas praktikës ligjore të GJEDNJ, “shkatërrimi i qëllimshëm i pronës sipas disa kushteve mund të llogaritet si trajtim johuman dhe degradues”. Në plotësim të kësaj, GJEDNJ në Nenin 8 ka krijuar konceptin e “obligimeve pozitive” të jurisprudencës relevante, sipas të cilave shteti kontraktues mund të mos e kufizojë intervenimin e tij me atë që është paraparë në Nenin 8, por gjithashtu mundet të ketë një obligim pozitiv për ta mbrojtur përmbushjen e atyre të drejtave dhe ta sigurojë respektimin e atyre të drejtave në ligjin vendor. Gjithashtu, mbrojtjet e disponueshme në Nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ, të cilat garantojnë realizimin paqësor të pronave të një personi, gjithashtu janë interpretuar për ta përfshirë mbrojtjen e të drejtave banuese.

Paralelisht me këtë duhet të merret në konsiderim se jurisprudenca zgjeruese e DEKS, përfshirë edhe atë e cila merret me të drejtat banuese, është një pako e të drejtave tej asaj të thjeshtë pasjes së një shtëpie: “E drejta e banimit lejon përmbushjen e shumë të drejtave tjera – civile dhe politike, si dhe ekonomike, sociale dhe kulturore. Është gjithashtu në interes qendror për familjen”

### 1.4.2 Politikat invalidore të Këshillit të Evropës

Ka një numër të rekomandimeve specifike të KiE të cilat e trajtojnë këtë çështje, përfshirë (mes tjerave):

- Rekomandimi i markimit i 1992 Nr. R (92) 6 për një politikë koherente për personat me invaliditet,
- Karta e 1995 për vlerësimin e profesionalitetit të personave me invaliditet (Rezoluta Res AP (95) 3),
- Deklarata ministërore e Malagës për personat me invaliditet —Përparimi drejtë pjesëmarrjes së plotë si qytetarë (maj 2003),
- Plani veprues për invaliditetin i KiE 2006-2015.

Politikat banuese të Këshillit të Evropës janë më gjithëpërfshirshëm të reflektuar në të fundit Raport lidhur me këtë çështje, të përpiluar nga Grupi i specialistëve për politika banuese për kohezion social (KS-PB).

Siqë theksohet në këtë raport, “është Karta sociale evropiane e revizionuar, ajo e cila u dha një theks të posaçëm problemeve të banimit të grupeve sociale të prekshme, të cilat u përforcuan nga strategjia për kohezion social e revizionuar e KE”.

Qëllimi i Raportit ishte që të kontribuojë drejt përpjekjeve të drejtuara drejt përmirësimit të qasjes në banim për grupet sociale të prekshme në Evropë, e cila më ilustrueshëm u konfirmua nga Udhëzimet për qasjen në banim për grupet e prekshme, të përpiluara nga KS-PB.

Udhëzimet i përcaktojnë parakushtet kyçe për një politikë banuese efektive për grupet e prekshme dhe numrojnë mjetet specifike potenciale për përmirësimin e banimit për grupet e prekshme në diskutim.

Në kontekstin e më lartë, duhet të merret parasyshë roli zmadhues i praktikës ligjore të GJEDNJ dhe atij i cili është zhvilluar nën të lartpërmendurën Kartë sociale evropiane të revizionuar (p.sh. Komiteti evropian për të drejta sociale – KEDS) dhe mekanizmi i ankesave kolektive të ndërlidhur me të.

Teksti kryesor juridik i KE në këtë sferë është Marrëveshja e pjesërishtme në fushën sociale dhe të shëndetësisë publike, palët kontraktuese e të cilës janë shtetet-anëtare të ardhshme: Austria, Belgjika, Qiproja, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Portugalia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra dhe Mbretëria e Bashkuar.

Sa i takon Planin veprues për invaliditetin të KE, duhet të nënvizohet se ka për qëllim që të shërbejë si mjet praktik për të krijuar dhe zbatuar strategji të afta, të cilat do të sjellin deri tek pjesëmarrja e plotë e personave me invaliditetin në shoqëri dhe së fundi të mbizotërojë çështja e invaliditetit përgjat gjitha sferave politike të shteteve anëtare<sup>3</sup>. Si përfundim, duhet të merret parasyshë praktika ligjore e GJEDNJ si dhe KEDS, të dyja nga të cilat kanë rol dhe ndikim vendimtar në zhvillimin dhe promovimin e çështjes së invaliditetit – duke i përfshirë edhe të drejtat njerzore të ndërlidhura me këtë çështje.

3. Në këtë aspekt, duhet të përmendet Forumi koordinues evropian për planin veprues për invaliditetin të KiE 2006-2015 (CAHPAH). Nga kjo perspektivë, e lartpërmendura Marrëveshje e pjesërishtme (me një numër të kufizuar të shteteve anëtare) tani është zhvendosur në “një model i bazuar në të drejtat sociale dhe njërëzore”, duke rezultuar në krijimin e kësaj platforme bashkëpunuese ndërqeveritare për çështjet e invaliditetit për të gjitha shtetet anëtare të KiE.

### 1.4.3 Politikat e Këshillit të Evropës lidhur me fëmijët dhe familjen

*Në plotësim, ajo e thënë paraprakisht kompletohet nga Karta sociale evropiane e revizionuar, që është traktati kryesor evropian i cili i siguron gjithashtu edhe të drejtat fëmijore.*

*Më tej, çështja e më lartë gjithashtu trajtohet nga një numër i madh i rekomandimeve të KiE përfshirë (mes tjerave) përgjegjësitë prindërore – Rekomandimi Nr. R (84) 4 dhe përkrahja e prindërimit pozitiv – Rekomandimi Rec (2006) 19.*

*Për të konkluduar në kontekstin e më lartë, duhet të theksohet se Programi i KiE "Ndërtimi i një Evrope për dhe me fëmijë" (2006-2009), i cili ka çuar në miratimin e një dokumenti relevant, "Strategjia për ndërtimin e një Evrope për dhe me fëmijët 2009-2011" (2008), ka për qëllim që ta përkrahë zbatimin e standardeve për të drejtat njerzore të KiE dhe ato ndërkombëtare, përfshirë edhe Konventën për të drejta fëmijore të KB.*

### 1.4.4 Politikat e KiE lidhur me romët

- Rekomandimi Rec (2005) 4 për Përmirësimin e kushteve banuese të romëve dhe udhëtarëve në Evropë,
- Rekomandimi Nr. R (2000) 4 për arsimimin e fëmijëve rom/magjyp në Evropë
- Rekomandimi Rec (2001) 17 për përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe punësimin e romëve/magjypëve dhe udhëtarëve në Evropë.

▶ Duke shikuar nga perspektiva e tërësisë së konventave të KiE, duhet të theksohet se ka një numër të madh të instrumenteve të KiE të cilat merren me çështje specifike të ndërlidhura me fëmijët, siqë janë: Konventa evropiane për statusin ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martesës (STE Nr. 085); Konventa evropiane për zbatimin e të drejtave fëmijore (STE Nr. 160); Konventa mbi kontaktin lidhur me fëmijët (STE Nr. 192); Konventa evropiane për birësimin e fëmijëve (STE Nr. 058); Konventa evropiane për birësimin e fëmijëve (e revizionuar), (STKE Nr. 202), dhe Konventa për riatdhesimin e të mitruve (STE Nr. 071, e cila ende s'ka hyrë në fuqi).

Me rëndësi të madhe për këtë fushë tematike janë nenet e KEDNJ, të cilat mund të përdoren edhe për mbrojtjen e të drejtave fëmijore dhe atyre të familjes. Gjegjësisht, një numër i neneve të saj janë tepër relevante për familjen dhe fëmijët, siqë është e drejta e respektimit të privatësisë së jetës familjare, e drejta e martesës dhe krijimit të familjes, e drejta e qasjes në gjyqe, e drejta e prindërve për ta siguruar arsimimin e fëmijëve të tyre në pajtim me bindjet e tyre. Rrjedhimisht, ka një numër të madh të rasteve të GJEDNJ, të cilat kanë të bëjnë me çështjet familjare.

▶ KiE nuk ka konventë të posaçme për romët, mirëpo të gjitha instrumentet kryesore ligjore të lartpërmendura të KiE janë tepër të rëndësishme edhe për popullatën rome. Kjo në veçanti e përfshin KEDNJ dhe të ndërlidhurën praktikë ligjore të GJEDNJ, si edhe Kartën sociale evropiane të revizionuar (KSER) dhe mekanizmat e saj mbikqyrëse të ligjit civil.

Në këtë kontekst, në veçanti duhet të merret parasyshë puna që bëhet nga Komisioni evropian kundër racizmit dhe jotolerancës (KERJ) të KiE, raportet mbikqyrëse të cilit gjithashtu përfshijnë (mes tjerave) popullatën rome – problemet e ndërlidhura me to në shtetet anëtare.<sup>4</sup>

## SHËNIM PËRMBYLLËS

Lidhur me pikat kryesore të përvijuara në nën-sekcionin e pjesës së parë të këtij botimi, duhet gjithashtu të përmendet edhe e fundit e ashtuquajtur Deklaratë e Moskës "Investimi në kohezionin social – investim në stabilitet dhe mirëqenie shoqërore", të miratuar (në Moskë 26-27 shkurt, 2009) në Konferencën e ministrave të përgjegjshëm për kohezion social të KiE.

Në reafirmimin (mes tjerave) e rolit të qasjes së bazuar në të drejtat; e cila qasje thërret për masa politike, sociale dhe ekonomike, të cilat mundësojnë qasje efektive në të drejtat e tyre për të gjithë, posaçërisht për secilin i cili jeton në rrezik të varfërisë dhe ç'kycjes sociale; kjo Deklaratë e reafirmon nevojën për promovim të drejtave sociale të cilat e marrin sigurimin social dhe mbrojtjen sociale për të qenë themelet e kohezionit social.

Deklarata e promovon ratifikimin e instrumenteve relevante të KiE, duke përfshirë Kartën sociale evropiane dhe Kartën sociale evropiane të revizionuar, Kodin evropian për sigurim social dhe Protokollin e tij dhe Konventën evropiane për sigurim social.

Në këtë kontekst, si pasojë nga analizimi i rolit të KiE në të gjitha sferat e lartpërmendura, duhet të merren parasyshë të gjitha konventat tjera relevante të KiE dhe (rrjedhimisht) numri rritës i konventave specifike – raportet e ndërlidhura mbikqyrëse, si edhe raportet dhe rekomandimet e miratuara nga Komiteti i ministrave të KiE, Parlamentit dhe të Kongresit të autoriteteve lokale dhe regionale<sup>5</sup>.

Kjo gjithashtu e përfshin edhe punën e cila ndërmerret nga trupat e tjera të KiE, duke përfshirë Komisionerin për të drejta njerzore, Komisioni evropian kundër racizmit dhe jotolerancës (KERJ), dhe të ngjajshme.

Si përmbyllje, nuk mund të mos përmendet se kontributi i KiE, sa u takon Objektivave të zhvillimit të mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara, mund qartësisht të shihet në aspekt të së lartpërmendurit Plan vepues i Varshavës, i cili gjithashtu i përfshin relacionet bilaterale mes KiE dhe organizatat tjera ndërqeveritare, duke përfshirë edhe OKB, BE dhe OSBE.

Me një fjalë, vetë zbatimin i të gjitha dokumenteve ligjore dhe ato për veprim politik të KiE nga shtetet anëtare të saj, është de facto një kontribut i drejtëpërdrejtë në zbatimin e Objektivave të zhvillimit të mijëvjeçarit të KB.

4. Puna e KERJ bazohet në rekomandimet e saja për politika të përgjithshme, si dhe në të gjitha instrumentet ligjore të Këshillit të Evropës.

5. Në këtë aspekt, duhet të merren parasyshë të gjitha instrumentet ligjore dhe të tjera të KiE të cilat merren me këto çështje (mes tjerave): "politika shëndetësore, promovimi dhe zhvillimi", "transplantacioni", masat e politikës shëndetësore në favor të disa grupeve të prekshme të shoqërisë siqë janë: personat kronikisht të sëmurë, personat e moshuar, popullata e margjinalizuar; familjet me një prind të vetëm; dialogu ndër-kulturor, të rinjtë, migrantët; të gjithë nga të cilët janë në disponim në ueb faqen e KiE-së. Në këtë aspekt duhet të merret parasyshë praktika ligjore e KiE-së, ajo e cila merret me "çështjet e ndërlidhura me punësimin dhe mbrojtjen e punëtorëve".



## KORNIZA LIGJORE DHE POLITIKE E BASHKIMIT EVROPIAN NË SFERËN E ANTI-VARFËRISË DHE PËRFSHIRJES SOCIALE

### HYRJE

Konceptet e anti-varfërisë dhe ç'kyçjes sociale janë qartësisht të reflektuara në nivel të Bashkimit Evropian (BE). Ishte në Samitin e Lisbonit në vitin 2000, kur shtetet anëtare e zotuan veten për të bërë progres drejt eliminimit të varfërisë në Evropë deri më 2010.

Më e rëndësishme është se mu në këtë Samit, u soll vendim që shtetet anëtare ti koordinojnë politikat e tyre për tejkalim të varfërisë dhe ç'kyçjes sociale në bazë të së ashtuquajturës "Metodë e hapur e koordinimit" (MHK).

Në plotësim, sa i takon këtij aspekti, duhet gjithashtu të shtohet numri zmadhues i instrumenteve ligjore dhe politike të BEsë, të miratuara nga të gjitha trupat kyçe të BEsë, si dhe në veçanti kontributi i ri i cili më së vonti ishte i dhënë nga Traktati i Lisbonit të BEsë.

Zotimi i BEsë në të lartpërmendurën kontekst, më së vonti është reflektuar përmes nisjes zyrtare (janar 2010) të Vitit evropian kundër varfërisë dhe ç'kyçjes sociale, nën sloganin "Stop varfërisë tani!".

## 2. Vlera shtuese e Traktatit të Lisbonit të BEsë në sferën e anti-varfërisë dhe përfshirjes sociale

Përpara se të trajtohet kjo çështje komplekse, së pari duhet të merren në konsiderim (në përgjithësi) tiparet specifike të BEsë si një organizatë ndërqeveritare sui generis, struktura e saj organizuese dhe relacionet me shtetet anëtare të saj, të cilat (në të njëjtën kohë) janë po ashtu edhe shtete anëtare të Këshillit të Evropës.

Duke e parë nga ky këndvështrim, duhet të ceket se Traktati i Lisbonit të BEsë nuk jep kurrëfar kompetenca të reja për BEnë në sferën e çështjeve sociale, punësimit dhe mundësive të barabarta, por më mirë thënë i konsolidon kompetencat ekzistuese; politikat sociale në shumicë, ende qëndrojnë nën zotërimin e kompetencave të shtetit.

Mirëpo, Traktati i Lisbonit ka hapur mundësi për zhvillimin e mëtutjeshëm strategjik të Evropës sociale.

Së pari, bëhet fjalë për një grup të vlerave të garantuara me Traktatin e Lisbonit, në të cilin në plotësim të atyre në traktatet e mëparshme (siqë është liria, demokracia, qeverisja e të drejtës dhe të drejtat njerëzore), shtohen edhe të drejtat njerëzore dhe barazia si vlera të Unionit. Gjithashtu, e rikujton kontributin e Unionit në paqe, siguri, zhvillim të qëndrueshëm, tregti të lirë dhe të ndershme dhe solidaritet, si dhe në eliminimin e varfërisë dhe mbrojtjen e të drejtave njerëzore.

Së dyti, e lartpërmendura plotësohet me qëllimet e Unionit; Traktati i Lisbonit qartësisht i përcakton objektivat sociale dhe objektivat ekonomike si të barabarta mes veti.

Në linjë me këtë qasje, një protokoll për shërbimet e interesit të përgjithshëm i është shtuar si shtojcë Traktatit, i cili protokoll e nënvizon rëndësinë e shërbimeve publike për një Union socialisht të qëndrueshëm dhe e reafirmon përgjegjësinë e shteteve anëtare për krijimin dhe organizimin e të njejtave.

Traktati e shton "barazinë mes burrave dhe grave, solidaritetin mes gjeneratave dhe mbrojtjen e të drejtave femërore" në objektivat sociale të Unionit.

Së treti, (gjë shumë e rëndësishme) Traktati i Lisbonit pranon se Karta e të drejtave fundamentale të BEsë e ka vlerën e njejtë ligjore si edhe traktatet.

E katërta, këtu është i rëndësishëm që të përmendet dialogu social: dialogu i tillë mes përfaqësuesve të sindikatave dhe organizatave të punëtorëve në nivel evropian, është një nga themelet e modelit social evropian.

Në këtë kontekst, duhet të shtohet neni i ri horizontal "social", i cili kërkon që kërkesat sociale të merren parasysh në politikën e Unionit. Këto kërkesa janë "të ndërlidhura me promovimin e nivelit të lartë të punësimit, garancionin e mbrojtjes sociale adekuate, luftën kundër ç'kyçjes sociale, dhe nivelin më të lartë të arsimit, trajnimit dhe mbrojtjes së shëndetit njerëzor".

Traktati i Lisbonit, gjithashtu e konfirmon rolin e rëndësishëm të partnerëve social dhe përparimin e dialogut social. Për të përmbledhur duhet thënë se Traktati i Lisbonit ofron një mundësi të re strategjike për zhvillimin dhe përforcimin e mëtutjeshëm të dimensionit social në nivel të BE-së. BE-ja i koordinon dhe inkurajon qeveritë kombëtare për ta tejkaluar varfërinë dhe ç'kyçjen sociale, ti reformojnë sistemet e tyre të mirëqenies duke mësuar nga njëri tjetri dhe të identifikojnë se cilat politika funksionojnë më së miri, duke mësuar nga njëri tjetri.

Në këtë kontekst, shtetet anëtare të BE-së punojnë së bashku duke përdorur një kornizë për bashkëpunim politik të quajtur Metoda e hapur e koordinimit.

## 2.1 Nenet kryesore të Traktatit të Lisbonit të BE-së për punësim, politikë sociale dhe shëndetësi publike

### 2.1.1 Baza ligjore e BE-së për punësim

Kjo çështje trajtohet nga Titulli IX mbi punësimin e TFBE, i cili i përmban nenet e ardhshme relevante, të cilat e japin bazën ligjore për veprimin e vetë Unionit dhe shteteve anëtare të tij në këtë sferë:

**\*Neni 145** përcakton se "shtetet anëtare, në pajtim me këtë titull, do të punojnë drejt krijimit të një strategjie të koordinuar për punësim dhe në veçanti për promovimin e një force punëtore të aftë, të trajnuar dhe të përshtatshme dhe tregje pune përgjegjëse drejt ndryshimit ekonomik me shpresë për të arritur objektivat e definuara në Nenin 3 të Traktatit të Bashkimit Evropian";

**\*Neni 146**, sipas të cilit: "Shtetet anëtare përmes politikave të tyre të punësimit, do të kontribuojnë drejt arritjes së objektivave të referuara në Nenin 145, në një mënyrë e cila është konsistente me udhëzimet e gjëra të politikave ekonomike të shteteve anëtare dhe të Unionit, në pajtim me Nenin 121 (2). Shtetet anëtare, duke i konsideruar politikën kombëtare të ndërlidhura me menaxhimin dhe punën, do ta konsiderojnë promovimin e punësimit si një çështje të brengës së përbashkët dhe do ti koordinojnë veprimet e tyre në këtë drejtim me Këshillin, në pajtim me rregulloret e Neni 148";

**\*Neni 147** përcakton se "Unioni do të kontribuojë për një nivel më të lartë të punësimit duke inkurajuar bashkëpunimin mes shteteve anëtare, duke përkrahur dhe, nëse është e domosdoshme, komplementuar veprimet e tyre. Duke e bërë këtë, do të respektohen kompetencat e shteteve anëtare. Objektiva e nivelit të lartë të punësimit do të merret në konsiderim gjatë formulimit dhe zbatimit të politikave dhe veprimeve të Unionit";

**\*Neni 148**, përcakton se "Bashkimi Evropian çdo vit do ta vlerësojë gjendjen e punësimit në Union dhe do të miratojë konkludime për të, në bazë të një raporti vjetor të përbashkët nga Këshilli dhe Komisioni. Në bazë të konkludimeve të Këshillit Evropian, Këshilli në formë të propozimit nga Komisioni dhe pas konsultimit me Parlamentin Evropian, Komitetin ekonomik dhe social, Komitetin e regjioneve, dhe Komitetin e punësimit, të përmendura në Nenin 150, çdo vit do të përpilojë udhëzime të cilat shtetet anëtare do të marrin parasysh në politikën e tyre për punësim. Këto udhëzime do të jenë konsistente me udhëzimet e përgjithshme të miratuara në bazë të Neni 121(2)".

**\*Neni 149**, sipas të cilit, "Parlamenti Evropian dhe Këshilli, të cilët veprojnë sipas procedurës legjislativë të zakonshme dhe pas konsultimit me Komitetin ekonomik dhe social dhe Komitetin e regjioneve, mund të miratojnë masa nxitëse, të dizenuara për ta inkurajuar bashkëpunimin mes shteteve anëtare dhe për ta përkrahur veprimin e tyre në sferën e punësimit, përmes iniciativave të qëlluara për shkëmbim të informatave dhe praktikave të mira, duke dhënë analiza komparative dhe këshilla, si dhe promovimin e qasjeve novative dhe vlerësimin e eksperiencave, në veçanti përmes pilot projekteve. Këto masa nuk përfshijnë harmonizim të ligjeve dhe rregullave të shteteve anëtare".

### 2.1.2 Baza ligjore e politikës sociale të BEsë

Kjo çështje trajtohet nga Titulli X i Traktatit të Lisbonit, i cili i përfshin (mes tjerave), nenet e ardhshme të cilat e mundësojnë bazën ligjore për veprimin e vetë Unionit dhe shteteve anëtare të tij në këtë sferë:

**Neni 151**, i cili thotë: "Unioni dhe shtetet anëtare të tij, duke i pasur ndërmend të drejtat sociale thelbësore, siqë janë vendosur në Kartën sociale evropiane të nënshkruar në Turin më 21 tetor 1961 dhe në Kartën e komuniteteve të 1989 lidhur me të drejtat fundamentele sociale të punëtorëve, do ti kenë si objektiva të tyre promovimin e punësimit dhe kushtet e përmirësuar të jetesës dhe të punës, dhe do ta mundësojnë harmonizimin e tyre përmes mirëmbajtjes së përmirësimit, mbrojtjes sociale të përshtatshme, dialogut mes menaxhmentit dhe punës, zhvillimit të resurseve njerëzore dhe duke e pasur si qëllim punësimin më të madh të qëndrueshëm dhe tejkalimin e ç'kyçjes. Në këtë rast, Unioni dhe shtetet anëtare do të zbatojnë masa të cilat i marrin parasyshë format e llojllojshme të praktikave kombëtare, në veçanti në fushën e marrëdhënieve kontraktuese dhe nevojës për ta mirëmbajtur konkurrencën e ekonomisë së Unionit. Ato besojnë se një zhvillim i tillë do të pasojë jo vetëm nga funksionimi i tregut të brendshëm, i cili do ta favorizojë harmonizimin e sistemeve sociale, mirëpo gjithashtu nga procedurat e përvijuara në Traktatin dhe nga përfshirja e rregullovet të përvijuara nga ligji, rregulloret ose nga veprimi administrativ"<sup>6</sup>.

\***Neni 152** sipas të cilit "Unioni e njeht dhe promovon rolin e partnerëve social përbrenda tij, duke e marrë parasyshë llojllojshmërinë e sistemeve kombëtare. Do ta lehtësojë dialogun mes partnerëve social duke respektuar autonominë e tyre". Siqë më tej përcaktohet nga ky Nen: "Samiti trepalësh social për rritje dhe punësim do të kontribuojë në dialogun social";

\***Neni 153**, i cili e mundëson Unionin për ti përkrahur dhe plotësuar aktivitetet e shteteve anëtare në sferat e ardhshme:

- (a) përmirësim të mjedisit në punë për mbrojtje të shëndetit dhe sigurisë së punëtorit;
- (b) kushtet punuese;
- (c) siguria sociale dhe mbrojtja sociale e punëtorëve;
- (ç) mbrojtja e punëtorëve në rast të pushimit të kontratës së tyre;
- (d) informimi dhe konsultimi i punëtorëve; (dh) përfaqësimi dhe mbrojtja kolektive e interesave të punëtorëve dhe punëdhënësve, duke përfshirë edhe ko-determinimin i cili është subjekt i paragrafit 5 të këtij neni;
- (e) kushte për punësim për shtetasit e shteteve të treta, të cilët legalisht banojnë në territorin e Unionit;
- (ë) integrimi i personave të ç'kyçur nga tregu i punës, pa paragjykim në Nenin 166; (f) barazia mes burrave dhe grave në aspekt të mundësive të punësimit dhe trajtimit në punë;
- (g) tejkalimi i ç'kyçjes sociale;
- (gj) modernizimi i sistemeve të mbrojtjes sociale pa paragjykim për pikën (c);

\***Neni 154**, i cili përcakton se "detyra e Komisionit është që ta promovojë konsultimin e menaxhimit dhe tregut në nivel të Unionit dhe të ndërmarrë çdo masë relevante për ta lehtësuar dialogun e tyre, duke siguruar përkrahje të balancuar për të gjitha palët";

\***Neni 155**, i cili përcakton (mes tjerave) shumë rëndësishëm se: "Nëse menaxhmenti dhe tregu duan, dialogu mes tyre në nivel të Unionit mund të çojë deri tek marrëdhëniet kontraktuese, duke përfshirë edhe nënshkrimin e një marrëveshje";

\***Neni 156**, i cili thotë se "në drejtim të realizimit të objektivave të Nenit 151 dhe pa paragjykim lidhur me rregullat e tjera të Traktateve, Komisioni do ta inkurajojë bashkëpunimin mes shteteve anëtare dhe do ta lehtësojë koordinimin e veprimit të tyre në të gjitha fushat e politikës sociale nën këtë Kapitull, në veçanti për çështjet e ndërlydhura me: punësim; ligjin e punës dhe kushtet e punës; trajnimin profesionalizues bazik dhe të avancuar; sigurimin social; parandalimin e aksidenteve dhe sëmundjeve; higjiena në punë; e drejta e asociimit dhe marrëveshjes kolektive mes punëdhënësve dhe punëtorëve";

\***Neni 157**, i cili përcakton se "çdo shtet anëtar duhet ta sigurojë zbatimin e parimit të pagës së barabartë për burrat dhe gratë për një punë të njejtë të vlerës së njejtë. Më tej thotë (në paragrafin 2) se "Parlamenti dhe Këshilli Evropian, duke vepruar në pajtim me procedurën e zakonshme legjislativë, dhe pas konsultimit me Komitetin ekonomik dhe social, do të miratojnë masa për ta siguruar zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë mes burrave dhe grave, në çështjet e ndërlydhura me punësimin dhe profesionin, duke përfshirë parimin e pagës së barabartë për punën e njejtë të vlerës së njejtë";

6. Në kontekstin e më lartë, duhet të merret parasyshë se Karta e bashkësisë e të drejtave sociale fundamentale të punëtorëve është miratuar më 9 dhjetor 1989, nga një deklaratë e të gjitha shteteve anëtare, me përjashtim të Mbretërisë së Bashkuar. Karta, de facto i ka themeluar parimet kryesore për krijimin e Ligjit evropian të punës dhe e ka formuar zhvillimin e të tashmit Model social evropian.

\***Neni 158**, sipas të cilit “shtetet anëtare do të përpiqen për ta mirëmbajtur barazpeshën ekzistuese mes skemave për pushim vjetor të paguar”;

\***Neni 159**, e autorizon Komisionin të përvijoj çdo vit raport për progresin drejt realizimit të objektivave të Nenit 151, duke përfshirë gjendjen demografike të Unionit;

\***Neni 160**, i cili e autorizon Këshillin, duke vepruar me shumicë të thjeshtë të votave të Parlamentit, për të krijuar një Komitet për mbrojtje sociale me status këshillues, i cili do të promovojë bashkëpunim në politikat e mbrojtjes sociale mes shteteve anëtare dhe Komisionit.

## SHËNIM:

Vetëm në kontekst të neneve të lartpërmendura, mund të kuptohet roli dhe përfshirja e partnerëve social në nivel evropian, të organizuar rreth tre llojeve të ndryshme të aktiviteteve:

Konsultime trepalëshe të partnerëve social, të cilat i përfshijnë aktivitetet e komiteteve këshilluese dhe konsultimet zyrtare në frymën e të lartpërmendurit Nen 153, të Traktatit për funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) dhe Dialogu social evropian, i cili është emri për punën dypalëshe të partnerëve social, (në kontekst të konsultimeve zyrtare të Komisionit bazuar në të lartpërmendurat Nene 153 dhe 154, të Traktatit për funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE).

Sa i takon konsultimit trepalësh, duhet të shënohet se ka një të ashtuquajtur Samit social trepalësh, i përbërë nga përfaqësues të prezidencës së Këshillit, dy prezidencat e ardhshme, Komisionit dhe nga partnerët social. Sferat të cilat trajtohen nga konsultimi trepalësh përfshijnë dialogun makro-ekonomik, punësimin, mbrojtjen sociale, arsimin dhe trajnimin.

Sa i takon Dialogut social evropian, duhet të shënohet se elementi thelbësor i Modelit social evropian është përfshirja e diskutimeve, negociatave dhe veprimeve të përbashkëta të ndërmarra nga partnerët social evropian<sup>7</sup>. Në këtë aspekt, duhet të përmendet se kriteret për përfaqësimin e organizatave janë përcaktuar në Komunikimin sa i takon zbatimit të Marrëveshjes për politikë sociale (COM (93) 600 të Komisionit<sup>8</sup>.

Dialogu social evropian mund të jetë ndërsektoral dhe sektoral: ai ndërsektoral e përfshin të gjithë ekonominë dhe tregun e punës dhe qëllimi i tij është që ta promovojë dialogun mes sindikatave dhe organizatave të punëdhënësve në sferat kyçe, të përbashkëta për të gjitha sferat e punësimit dhe çështjeve sociale.

Partnerët social kanë prodhuar një numër të dallueshëm të marrëveshjeve (të ashtuquajtura korniza) ndërsektorale, të cilat janë krijuar përmes direktivave ose përmes rrugës autonome.

Dialogu social evropian sektoral është një instrument i politikës sociale dhe marrëdhëniesve industriale të BE-së në nivel sektoral. Përbëhet prej negociatave mes sindikatave dhe organizatave të punëdhënësve të BE-së të një sektori specifik të ekonomisë.

omitetet e dialogut social sektoral mund të nisin veprime të përbashkëta, të miratojnë udhëzime dhe të nënshkruajnë marrëveshje, duke kontribuar drejtëpërdrejt në krijimin e legjislativës dhe politikave të punës në BE.

Konteksti më i lartë është më relevant për kuptimin e Këshillëve evropiane të punës, të cilat janë krijuar që t’ju japin përfaqësuesve të punëtorëve në kompanitë e mëdha shumëkombëtare, në të gjitha shtetet evropiane, një linjë të drejtëpërdrejtë të komunikimit me menaxhmentin kryesor<sup>9</sup>.

Për të përfunduar, duhet vetëm të përmendet edhe nocioni i përgjegjësisë korporative sociale (PKS), i cili përkrahë në Komunikatën e Komisionit (e 22 marsit 2006) për Zbatimin e partneritetit për zhvillim dhe punë: të bëhet Evropa një shtyllë e shkëlqyeshmërisë së përgjegjësisë korporative sociale.

### 2.1.3 Bazat ligjore të unionit evropian për politikën e shëndetit publik

Rregullat kryesore të çështjes paraprake përcaktohen në Titullin XIV (Shëndetësi publike) të TFBE, të cilat përfshijnë (gjë shumë e rëndësishme) Nenin 168 i cili ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes njerëzore, në krijimin dhe

7. Në kontekstin e më lartë, duhet të nënvizohet se ‘partnerët social’ është term i cili gjerësisht përdoret në Evropë për t’ju referuar përfaqësuesve të menaxhmentit dhe punës, p.sh. organizatave të punëdhënësve dhe sindikatave.

3. Kini ndërmend se Komisioni rregullisht boton ‘listë të organizatave partnere sociale evropiane’ të cilat sipas mendimit të Komisionit i përmbushin këto kriteret.

9. Baza origjinale ligjore për këto këshille është dhënë nga Direktiva (94/45/EC) e 22 shtatorit 1994, e cila është revizionuar nga Direktiva 2009/38/EC e Këshillit dhe Parlamentit të BE lidhur me krijimin e Këshillit të punëve evropiane ose një procedurë në nivel të ndërmarrjeve të komunitetit dhe grupeve të ndërmarrjeve në nivel të komunitetit, për qëllime të informimit dhe konsultimit të punonjësve.

zbatimin e të gjitha politikave dhe aktiviteteve të Unionit.

Siqë përcaktohet më tej nga ky Nen: “Veprimi i Unionit, i cili do të plotësojë politikat kombëtare, është i drejtuar drejtë përmirësimit të shëndetësisë, parandalimin e sëmundjeve të përgjithshme dhe sëmundjeve ngjitëse dhe për ti paraparë burimet për rrezik të shëndetit fizik dhe mental. Veprimet e tilla do ta përfshijnë luftën kundër flamave kryesore shëndetësore, duke promovuar hulumtimin për zbulim të shkaqeve të tyre, transmetimin dhe parandalimin e tyre, si dhe informimin dhe edukimin shëndetësor, dhe vëzhgimin e paralajmërimeve të hershme dhe tejkalimin e kërcnimeve serioze tej-kufitare për shëndetin”.

## 2.2 Karta e të drejtave fundamentale të BEsë

*Për dallim të KEDNJ të Këshillit të Evropës, Karta e BEsë i përcakton jo vetëm të drejtat dhe liritë thelbësore, por gjithashtu edhe shumë të drejta specifike sociale.*

*Të drejtat specifike të kësaj Karte i përfshijnë të ardhshmet:*

- Neni 1 për dinjitetin njerzor;
- Neni 2 për të drejtën e jetës;
- Neni 3 për të drejtën e integritetit të personit;
- Neni 4 për ndalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit johuman ose degradues;
- Neni 5 për ndalimin e robërisë dhe punës së detyruar;
- Neni 6 për të drejtën e lirisë dhe sigurimit;
- Neni 7 për respektin e privatësisë dhe jetës familjare;
- Neni 8 për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Neni 9 për të drejtën e martesës dhe të drejtën për të formuar familje;
- Neni 10 për lirinë e mendimit, vetëdijes dhe religjionit;
- Neni 11 për lirinë e shprehjes dhe informimit;
- Neni 12 për lirinë e mbledhjes dhe bashkëshoqërimit;
- Neni 13 për lirinë e artit dhe shkencës;
- Neni 14 për të drejtën e arsimit;
- Neni 15 për lirinë e zgjedhjes së profesionit dhe të drejtës për tu angazhuar në punë;
- Neni 16 për lirinë në drejtimin e biznesit;
- Neni 17 për të drejtën e pronës;
- Neni 18 për të drejtën e azilit;
- Neni 19 për të drejtën në rast të zhvendosjes, dëbimit ose ekstradimit;
- Neni 20 për barazinë përpara ligjit;
- Neni 21 për jodiskriminimin;
- Neni 22 për llojllojshmërinë kulturore, religjioze dhe gjuhësore;
- Neni 23 për barazinë mes burrave dhe grave;
- Neni 24 për të drejtat feminare;
- Neni 25 për të drejtat e të moshuarve;
- Neni 26 për integrimin e personave me invaliditet;
- Neni 27 për të drejtat e punëtorit në informim dhe konsultim përbrenda ndërmarrjeve;
- Neni 28 për të drejtën e marrëveshjes dhe veprimit kolektiv;
- Neni 29 për të drejtën e qasjes në shërbime;
- Neni 30 për mbrojtjen në rast të largimit të padrejtë;
- Neni 31 për kushtet e ndershme dhe të drejta pune;
- Neni 32 për ndalimin e punës feminare dhe mbrojtjen e personave të rinj në punë;
- Neni 33 për familjen dhe jetën profesionale;
- Neni 34 për sigurimin social dhe asistencën sociale;
- Neni 35 për kujdesin shëndetësor;
- Neni 36 për qasjen në shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik;
- Neni 37 për mbrojtjen mjedisore;
- Neni 38 për mbrojtjen e konsumatorit.

Të drejtat e më larta specifike kompletohen nga ato të përmbytura në Kapitullin V (të titulluara si “të drejtat qytetare” dhe në Kapitullin VI (të titulluar si “Drejtësi”).

Në këtë kontekst, duhet në veçanti të theksohet relevanca specifike e Neni 51 të Kartës, i cili përcakton (mes tjerave) se “rregullat e Kartës ju adresohen institucioneve dhe organeve të Unionit për shkak të vlerësimit të parimit të subsidiaritetit

dhe shteteve anëtare vetëm kur ato e zbatojnë ligjin e Unionit". Ky nen më tej thotë (gjë shumë e rëndësishme) se, "Karta nuk krijon kurrëfar fuqie të re ose detyrim për Komunitetin ose për Unionin, as po modifikon fuqitë dhe detyrat e definuara nga Traktatet".

Kështu që, për dallim të KEDNJ të KiE, duhet të theksohet se kjo Kartë e BEsë nuk është drejtëpërdrejtë e zbatueshme më veti, por vetëm gjatë zbatimit të ligjit respektiv të BEsë dhe këto nene nuk përfshijnë mbrojtje të drejtëpërdrejtë gjyqësore për individët.

Kjo është ajo se përse ajo nuk duhet të ngatërrohet me sistemin gjyqësor të bazuar në KEDNJ, por është plotësuere dhe paraqet një instrument sui generis, për tu parë vetëm në kontekst më të gjërë ligjor të BEsë.

Kjo bëhet më e qartë kur theksohet se aktualisht nuk ka kurrëfar gjyqi të posaçëm të BEsë, i cili vendos ekskluzivisht për mbrojtjen e të drejtave njerëzore, por është vetëm Gjykata evropiane e drejtësisë, si gjykata më e lartë në Bashkimin Evropian që merret me çështjet e ligjit të Bashkimit Evropian.

Në kontekstin e më lartë, duhet të merret parasysh roli i Agjencisë për të drejtat fundamentale të Bashkimit Evropian, e cila është trup këshillues i Bashkimit Evropian<sup>10</sup>.

### 2.3 Metoda e hapur e koordinimi (MHK)

Metoda e hapur e koordinimit (MHK) është një mjet relativisht i ri i qeverisjes në BE, e cili bazohet në bashkëpunimin vullnetar të shteteve anëtare të tij.

Mundëson një kornizë për koordinim politik, pa mos e përdorur "ligjin e ngurtë", siqë janë rregulloret ose direktivat. Në këtë proces, shtetet anëtare pajtohen për një cikël të veprimeve, të cilat i përkrahin objektivat bashkarisht të përcaktuara.

Procesi ciklik përfshin 5 komponenta kryesore, edhe atë:

- i). dakordimi i objektivave të përbashkëta në nivel të BEsë;
- ii). krijimi i treguesve të përbashkët për të matur progresin drejtë objektivave, si dhe për krahasim; të cilat janë krijuar sipas nevojave të shteteve anëtare dhe sektorëve të përfshira, si mjete për ti krahasuar praktikatat e mira;
- iii). krijimi i raporteve kombëtare për strategjitë e mbrojtjes sociale dhe përfshirjes sociale, të cilat i përkthejnë këto objektiva në politika në nivel kombëtar;
- iv). një program i përbashkët për veprim, i cili e mbështet dhe përforcon procesin, dhe v). vlerësimi i progresit dhe rezultatit përmes raporteve evropiane (p.sh. raporte të përbashkëta nga Këshilli dhe Komisioni).

Me fjalë tjera, në përgjithësi MHK funksionon në faza:

Faza e parë - këshilli i ministrave pajtohet mbi qëllimet e politikës;

Faza e dytë - shtetet anëtare i përkthejnë udhëzimet në politika kombëtare dhe regjionale dhe

Faza e tretë - miratohen bençmarke dhe tregues specifik për ti matur praktikatat më të mira.

Në fund bëhet vëzhgim dhe vlerësim i rezultateve.

#### 2.3.1 Objektivat e përbashkëta të MHK

Këto objektiva të përbashkëta janë përvijuar në mënyrë gjithëpërfshirëse në Shtojcën I të Komunikatës së Komisionit (2008) në "Një përkushtim i ripërtirë për një Evropë sociale: Përforsimi i Metodës së hapur të koordinimit për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale".

Siqë është përcaktuar në këtë instrument, objektivat kryqëzuese të MHK për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale duhet të promovojnë:

- (a). kohezion social, barazi mes burrave dhe grave dhe mundësi të barabarta për të gjithë përmes sistemeve të mbrojtjes sociale dhe politikave për përfshirje sociale të përshtatshme, të qasëshme, financiarisht të qëndrueshme dhe efikase;
- (b). bashkëveprim efektiv dhe i ndërmjetshëm mes objektivave të Lisbonit dhe Strategjisë për zhvillim të qëndrueshëm të BEsë, për rritje më të madhe ekonomike, më shumë punë dhe më të mira, dhe kohezion social më i madh, dhe
- (c). qeverisje e mirë, transparencë dhe përfshirja e të gjitha palëve në dizajnimin, zbatimin dhe vëzhgimin e politikave.

Në plotësim, Komunikata e më lartë përcakton objektiva specifike të cilat duhet të ndërmerren në segmente të ndryshme

10. Në këtë kontekst, duhet të merret parasysh sfida më e madhe dhe më komplekse përbrenda sistemit gjyqësor mbrojtës evropian së të drejtave njerëzore: pranimi i BEsë në sistemin e bazuar në KEDNJ të Këshillit të Evropës, gjë e cila hap një sërë të çështjeve, të cilat duhet veçmas dhe gjithëpërfshirshëm të trajtohen.



në punë, dhe janë të shoqëruara nga rekomandime për masa specifike që kanë të bëjnë me ta. Objektivat përfshijnë: ndikim vendimtar për tejkalimin e varfërisë dhe ç'kyçjes sociale; pensione adekuate dhe të qëndrueshme si dhe të qasëshme; kujdes shëndetësor i kualitetit të lartë dhe i qëndrueshëm, si dhe afatgjatë. Kjo gjithashtu përfshin edhe objektivat e "përfshirjes sociale aktive për të gjithë", e cila do të sigurohet përmes promovimit të pjesëmarrjes në tregun e punës dhe duke e luftuar varfërinë dhe ç'kyçjen mes njerëzve dhe grupeve më të margjinalizuara.

### 2.3.2 Treguesit e përbashkët të ndërlidhur me MHK

Definimi i objektive të përbashkëta, në aspekt të mbrojtjes sociale dhe përfshirjes sociale, kërkon definimin e treguesve të përbashkët për ti krahasuar praktikat më të mira dhe për të matur progresi drejt këtyre objektive të përbashkëta.

Si edhe objektivat e përbashkëta, ashtu edhe treguesit e përbashkët kryqëzues, aktualisht janë të përvijuar në Shtojcën 2, në të lartpërmendurën Komunikatë të Komisionit "Një zotim i ripërtirë për një Evropë sociale: Përforcimi i Metodës së hapur të koordinimit për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale" (2008).

Sipas këtij instrumenti, treguesit e përbashkët të ndërlidhur me MHK i përfshijnë të ardhshmet: shkalla e atyre në rrezik të varfërisë (gjithsej, fëmijë dhe të moshuar) + vlera ilustrative pragore – BE; zbrastira e mesit relativ të rrezikut të varfërisë; pabarazia e shpërndarjes së ta ardhurave (S80/S20) – BE; jetë më e gjatë e shëndetëshme – NAT; braktisës të shkollës fillore – BE, njerëz të papunë – BE; shpenzime totale publike të projektuara – NAT (pensione, kujdesi shëndetësor, kujdesi afatgjatë, arsim dhe transfere papunësie); të ardhura relative mesatare për personat e moshura – BE; raporti i zëvendësimit të agregatit – BE, nevoja e papërmbyshur për kujdes mjekësor të vetraportuar – NAT + përdorimi i kujdesit – NAT; shkalla e atyre në rrezik të varfërisë e ngulitur në një moment të fiksuar të kohës – BE; shkalla e punësimit e punëtorëve më në moshë – BE; rreziku nga varfëria e atyre në punë – BE (individë të cilët janë klasifikuar si të punësuar dhe të cilët janë në rrezik nga varfëria); shkalla e aktivitetit – BE (pjesa e personave të punësuar dhe të papunësuar në popullatën e përgjithshme të moshës punuese 15-64 vjeç); disrepanca regjionale – koeficienti i luhatjes së shkallave të punësimit – NAT, dhe shpenzimi total shëndetësor për kokë – NAT.

Si të tilla, treguesit e përbashkët të lartpërmendur nuk janë politika të përbashkëta. Korniza e gjërë metodologjike përbëhet prej një liste të treguesve primar dhe sekundar, për një portfol të përgjithshëm si dhe tre degët (përfshirje sociale, pension, shëndetësi dhe kujdes afatgjatë).

Treguesit primarë janë një version i zvogluar i treguesve udhëheqës, të cilët mundësojnë një depërtim më të thellë përbenda natyrës së problemit. Këto tregues përdoren për raportet kombëtare për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale dhe raportet kombëtare specifike lidhur me degët e ndryshme (përfshirje sociale, pensione, shëndetësi dhe kujdes afatgjatë), si edhe për raportin e përbashkët të prezantuar nga Komisioni dhe Këshilli Evropian<sup>11</sup>.

### 2.3.3 Raporte kombëtare për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale

Përpilimi i raporteve kombëtare për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale, është një nga fazat kyçe të aktiviteteve ciklore të lartpërmendurës MHK, në linjë me objektivat e përbashkëta paraprakisht të përshkruara dhe duke i përdorur më lartë të cekurat tregues bashkarisht të miratuar. Kështu që, duke e ndjekur thjeshtëzimin e Metodës së hapur të koordinimit për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale, shtetet anëtare pritët që ti përkthejnë objektivat e përbashkëta në plane të tyre kombëtare, për secilën nga tre fushat dhe atë të: përfshirjes sociale, pensione, shëndetësisë dhe kujdesit afatgjatë. Këto plane, të cilat mbulojnë një periudhë tre vjeçare, i dorëzohen Komisionit në formë të raportit kombëtar për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale. Si nga vetë fillimi, në përpilimin e planeve të tyre shtetet anëtare udhëzohen nga një format model të përgatitur nga Komisioni.

Në këtë aspekt, duhet të referohet Shënimi udhëzues për përgatitjen e raportit të Strategjisë kombëtare për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale (MHK MSPS) 2008-2010, prapavija dhe qëllimet e të cilit janë qartësisht të paraqitura në hyrjen e Shënimit. Shtetet anëtare thirren që ta përdorin kornizën e përbashkët të përvijuar në të për përkrahje dhe udhëzim, me qëllim që ta përforcojnë efikasitetin e Metodës së hapur, si një mjet për shkëmbim dhe mësim të ndërmjetshëm<sup>12</sup>.

11. Në kontekstin paraprak, kini ndërmend se ka një të ashtuquajtur Nën-grup i treguesve (NGT) të Komitetit për mbrojtje sociale (KMS), i cili është përgjegjës për formulimin dhe definimin e treguesve që do të përdoren për vëzhgimin e progresit të shtetit drejtë objektive bashkarisht të pajtuara të MHK. Në këtë kontekst, duhet ta shihni Raportin veprues të GTS 2009, të botuar në janar të vitit 2010, i cili mesjerave përmban një listë të treguesve në sferën e përfshirjes sociale.

### 2.3.4 Raportet e përbashkëta të MHK

Një karakteristikë tjetër kryesore e Metodës së hapur të koordinimit (MHK) është analiza dhe vlerësimi i përbashkët i Komisionit dhe Këshillit Evropian lidhur me raportet kombëtare për strategjitë për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale të dorëzuara nga shtetet anëtare.

Me një fjalë, raportet e përbashkëta e vlerësojnë progresin e bërë në zbatimin e MHK, përcaktojnë prioritetet kryesore dhe identifikojnë praktika të mira dhe qasje novative të interesit të përbashkët për shtetet anëtare. Gjendet aktuale të zhvillimeve të ndërlidhura me MHK, janë ilustruar në të fundit raporte të përbashkëta për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale të viteve 2009 dhe 2010.

### 2.3.5 MHK Programi veprues i Komunitetit

Bashkëpunimi i shteteve anëtare për ta tejkaluar varfërinë dhe ç'kyçjen sociale, aktualisht përkrahët përmes të riut të ashtuquajtur PROGRES program 2007-2013, qëllimi i përgjithshëm i të cilit është që financiarisht ta përkrahë zbatimin e objektivave të BE-së në punësim, çështje sociale dhe mundësi të barabarta, gjëra të cilat janë instaluar në Agjendën sociale.

### 2.3.6 Vlerësimi i ndikimit dhe përforcimi i MHK

Këto çështje janë për së afërmi të ndërlidhura njëra me tjetrën dhe në këtë aspekt duhet të konsultohet Dokumenti punues i Komisionit, i cili e shoqëron Komunikatën e Komisioni "Një zotim i ripërtirë për një Evropë sociale: Përforcimi i Metodës së hapur për koordinim për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale", i cili mes të tjerave e përcakton të ardhshmen: "Vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve të MHK sociale nga aktorët e ndryshëm të përfshirë në proces, ka qenë në përgjithësi pozitiv. Metoda ka përkrahur mësim të ndërmjetshëm, ka promovuar përfshirjen e palëve, ka rritur vetëdijen për karakterin shumëdimensional të ç'kyçjes dhe varfërisë.....; Megjithatë, treguesit e rezultateve qartësisht tregojnë për kontribut jo të mjaftueshëm në objektivat e përbashkëta sociale dhe në bazë të konsultimeve të palëve dhe ekspertëve të ndryshëm, përfundohet se ka dobësi në MHK sociale".

Në drejtim të kësaj, ky dokument përcakton një numër të zhvillimeve institucionale dhe politike, të gjitha nga të cilat e justifikojnë nevojën për një përforcim domethënës të MHK sociale. Në këtë aspekt, (gjë shumë e rëndësishme) dokumenti identifikon tre opsione për politika.

Për të konkluduar, duhet ti bëhet referencë të lartpërmendurës Komunikatë të Komisionit "Një zotim i ripërtirë për një Evropë sociale: Përforcimi i Metodës së hapur për koordinim për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale", e cila ka përcaktuar një numër të sferave ku metoda mund të përmirësohet, përforcohet ose më tej të zhvillohet.

## 2.4 Agjenda sociale e revizionuar e BE-së

Agjenda sociale e revizionuar e BE-së, e cila formalisht është inkorporuar në Komunikatën e Komisionit për Agjendë sociale të revizionuar: mundësi, qasje dhe solidaritet në shekullin 21 në Evropë (2008), mundet të kuptohet dhe identifikohet vetëm në bazë të prapavijës së më lartë. Agjenda sociale e revizionuar është ndërtuar rreth tre qëllimeve: mundësive, qasjes dhe solidaritetit; të para si tre qëllime të ndërlidhura, me vlerë të barabartë. Në këtë drejtim, komunikata përcakton veprimet të cilat duhet të ndërmerren lidhur me sferat e kyçe, ku veprimi i BE-së më ka demonstruar vlerë të qartë shtuese dhe respekt të plotë për parimet e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit: fëmijë dhe të rinj; investimi në njerëz, më shumë punë dhe më të mira, aftësi të reja; lëvizshmëri; jetë më e gjatë dhe më e shëndoshë; tejkalmimi i varfërisë dhe ç'kyçjes sociale; lufta kundër diskriminimit.

Komunikata gjithashtu i adresohet edhe Metodës së hapur të koordinimit, dialogut social dhe të çështjeve të ngajshme.

## 2.5 EVROPA 2020 - Një strategji evropiane për zhvillim të mençur, të qëndrueshëm dhe përfshirës

Kjo është një nga zhvillimet më të hershme dhe më të rëndësishme, dretëpërdrejtë dhe shumë relevante për të gjitha çështjet e përvijuara nga nën-sekcionet paraprake të kësaj pjesë të botimit.

Strategjia, origjinalisht bazohet në Komunikatën e Komisionit "Evropa 2020 - Një Strategji për zhvillim të mençur, të qëndrueshëm dhe përfshirës", e cila më vonë (17 qershor 2010) është miratuar nga Këshilli Evropian: "Strategjia e re për punë dhe zhvillim të mençur, të qëndrueshëm dhe përfshirës, përfaqëson një kornizë koherente që Unioni ti mobilizojë të

gjitha instrumentet dhe politikat e tij dhe që shtetet anëtare të ndërmarrin aktivitete të përforcuara dhe të koordinuara”.

Në këtë aspekt, duhet të nënvizohet se Këshilli Evropian i ka konfirmuar pesë pikat kryesuese (siqë janë të bashkangjitura në dokumentin paraprakisht të përmendur, nga të cilat përbëhen objektivat e bashkëndara dhe të cilat e udhëzojnë veprimin e shteteve anëtare dhe të Unionit sa i takon promovimit të punësimit, përmirësimit të kushteve për novacion, hulumtim dhe zhvillim, përmirësime të objektivave për ndryshimet klimatike dhe energjetike dhe përmirësim të përfshirjes përmes uljes së varfërisë.

Udhërrëfyesit vazhdojnë që të jenë bazë për shumë rekomandime specifike të cilat Këshilli mund t’jua referojë shteteve anëtare. Në këtë kontekst, në veçanti duhet të merret parasyshë iniciativa kryesuese e BEsë “Platforma evropiane kundër varfërisë”, e cila ndërlikohet me iniciativën e BEsë, “Agjendë për aftësi dhe punë të reja”.

## 2.6 Acquis të BEsë të përzgjedhura në sferat relevante për anti-varfrinë dhe përfshirjen sociale

### 2.6.1 Mbrojtja e të drejtave të punonjësve

Sa u takon instrumenteve detyruese ligjore të BEsë për shtetet anëtare në këtë sferë, dhe në plotësim të rregulloreve të së lartpërmendurës Kartë e të drejtave fundamentale të BEsë, duhet të merren parasyshë (mes tjerave) instrumentet e ardhshme të BEsë:

- Direktiva e Këshillit 98/59/EC mbi përfafërimin e ligjeve të shteteve anëtare lidhur me tepricat kolektive;
- Direktiva e Këshillit 80/987/EEC mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare lidhur me mbrojtjen e punonjësve në rast të falimentimit të punëdhënësit të tyre si dhe propozimi për një Direktivë të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për mbrojtjen e punonjësve në rast të falimentimit të punëdhënësit të tyre [COM(2006) 657];
- Direktiva e Këshillit 2001/23/EC mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare lidhur me ruajtjen e të drejtave të punonjësve në rast të transferimit të ndërmarrjeve, bizneseve ose pjesë të ndërmarrjeve ose bizneseve ;
- Direktiva e Këshillit 91/533/EEC për detyrën e punëdhënësit për ti informuar punëtorët për kushtet e vlefshme në kontratë ose marrëdhëniet e punësimit;<sup>13</sup>
- Direktiva 96/71/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian lidhur me informimin e punëtorëve lidhur me kornizat e dhënies së shërbimeve ;
- Direktiva e Këshillit 75/117/EEC e 10 shkurtit lidhur me zbatimin e parimit të pagës së njëjtë për burrat dhe gratë;
- Direktiva 2000/78/EC e 27 nëntorit 2000, e cila themelon një kornizë të përgjithshme për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion;
- Direktiva 2003/88/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e 4 nëntorit 2003, që ka të bëjë me disa aspekte të organizimit të orarit të punës;
- Direktiva e Këshillit 96/34/EC e 3 qershorit 1996 lidhur me marrëveshjen kornizë për pushimin prindëror të përcaktuar nga UNICE, CEEP dhe ETUC; Direktiva e Këshillit 97/81/EC e 15 dhjetorit 1997 lidhur me Marrëveshjen kornizë për punën me gjysëm orar pune të përcaktuar nga UNICE, CEEP dhe ETUC; Direktiva e Këshillit 99/70/EC e 28 qershorit 1999, lidhur me marrëveshjen kornizë me afat të fiksuar nga ETUC, UNICE dhe CEEP;
- Direktiva 2008/104/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e 19 nëntorit 2008, për punën e përkohëshme;
- Marrëveshje kornizë për telepunën e cila është në interes të veçantë, për shkak se është marrëveshja e parë evropiane e krijuar nga vetë partnerët sociale.

13. Shihni gjithashtu Komunikatën e Komisionit mbi rivlerësimin e kornizës sociale rregulluese për më shumë vende punë dhe punë më të mira në BE [COM (2007) 591] dhe Raportin e tij mbi Direktivën e Këshillit 2001/23/EC.

14. Ju lutemi gjithashtu shihni edhe Komunikatën e Komisionit lidhur me informimin e punëtorëve në suazat e dhënies së shërbimeve: maksimizim të përfitimeve dhe potencialit të tyre duke e garantuar mbrojtjen e punëtorëve [COM(2007) 304], Komunikata e tij – “Udhëzim për informimin e punëtorëve në suazat e dhënies së shërbimeve” [COM(2006) 159] dhe atë për zbatimin e Direktivës 96/71/EC në shtetet anëtare [COM(2003) 458].

### 2.6.1.1 Rregulloret e BEsë për shëndetësi dhe siguri në punë

Direktivën e Këshillit 89/391/EEC e 12 qershorit 1989 lidhur me vendosjen e masave për të inkurajuar përmirësime në sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në punë, e cila vlen për të gjitha sektoret e veprimt, edhe ato publike edhe private, me përjashtim të disa aktiviteteve specifike në shërbimet e mbrojtjes publike dhe civile.

Përbushet nga një sërë e instrumenteve tjera të BEsë lidhur me çështjen e njejtë, të gjitha nga të cilat janë detalisht të përmendura në Direktivën 2007/30/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 20 qershorit 2007, i cili e amendon të lartpërmendurën Direktivë (si dhe ato parapraket, p.sh. Direktivat e saj individuale dhe Direktivat e Këshillit 83/477/EEC, 91/383/EEC, 92/29/EEC dhe 94/33/EC). Ato kanë për qëllim që ti thjeshtëzojnë dhe racionalizojnë raportet mbi zbatimin praktik, me afat përfundimtar për zhvendosjen e tyre në shtetet anëtare, më 31.12.2012. Në këtë kontekst, duhet të merret parasyshë Komunikata e Komisionit (e 21 shkurtit 2007), e titulluar "Përmirësimi i kualitetit dhe produktivitetit në punë: Strategjia e Komunitetit 2007-2012 mbi shëndetin dhe sigurinë në punë".

## SHËNIM

Në kontekstin e më lartë, duhet të merret parasyshë se një shqyrtim i politikave dhe praktikave të fundit të shteteve anëtare të BEsë, në sferën e integritimit social dhe përfshirjes në tregun e punës, mund të gjendet në Raportin e përbashkët mbi mbrojtjen sociale dhe përfshirjen sociale të vitit 2008, si dhe 2009. Në plotësim, në këtë aspekt, gjithashtu vlen të përmendet Anketa e dytë evropiane mbi kualitetin e jetesës, jetën familjare dhe punën (2009), e cila jep një pikëpamje të gjerë të realiteteve të ndryshme sociale në 27 shtetet anëtare, Norvegji dhe shtetet kandidatë siqë janë Kroacia, Republika e Maqedonisë dhe Turqija.

### 2.6.2 Acquis e BEsë në sferën e sigurimit social

Gjatë trajtimit të kësaj çështje komplekse, së pari duhet të shqyrtohet Rregullorja e Këshillit (EEC) Nr. 1408/71, lidhur me aplikimin e skemave për sigurim social të personave të punësuar, personave të vetëpunësuar dhe anëtarëve të familjeve të tyre, të cilët lëvizin përbrenda Komunitetit".

Kjo rregullore shoqërohet nga Rregullorja për zbatim (EEC) Nr. 574/72, e cila e përfshin zbatimin praktik të saj. Nga pamja e perspektivës së më hershme, duhet të ceket se rregullorja e më lartë kompletëhet nga Rregullorja (EC) Nr. 592/2008 e Parlamentit dhe Këshillit të Evropës e 17 qershorit 2008, e cila e amendon Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr. 1408/71 mbi aplikimin e skemave të sigurimit social për personat e moshuar, personat e vetëpunësuar dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët lëvizin përbrenda Komunitetit.

Në këtë pikë duhet gjithashtu të përmenden rregulloret e BEsë mbi koordinimin e sigurimit social, të cilat duhet vazhdimisht të freskohen dhe të zgjerohen, në aspekt të përshtatjes së tyre me zhvillimet sociale dhe ligjore. Siqë shihet nga perspektiva e më hershme, ato përfshijnë Rregulloren (EC) Nr. 883/2004, të përmirësuar nga Rregullorja Nr. 988/2009 dhe Rregullorja zbatuese Nr. 987/2009, ose 'koordinim i modernizuar i sigurimit social të BEsë'. Me një fjalë, ato e thjeshtëzojnë dhe avancojnë ligjin e BEsë, duke i përmirësuar të drejtat e personave të përfshirë. Me 'modernizimin e koordinimit të sigurimit social të BEsë', fokusi i të cilave rregulla është zhvendosur nga lehtësimi i lëvizshmërisë së punëtorëve, në zbatimin e të drejtave të qytetarëve, pavarësisht nga ajo se nëse ato janë të punësuar apo jo. Pakoja e re legjislativë paraprake është në fuqi që nga 1 maj 2010.

Në bazë të kësaj, duhet të theksohet se rregulloret e BEsë për koordinim të sigurimit social nuk i përmbledhin sistemet kombëtare të sigurimit social në një sistem të vetëm evropian; ato sigurojnë që aplikimi i legjislacioneve të ndryshme kombëtare, të mos ndikojë dëmshëm mbi personat të cilët praktikojnë të drejtën e tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar brenda shteteve anëtare.

Në këtë kontekst dhe sa u takon shtetasve të shteteve jo anëtare të BEsë, duhet të shënohet se më 01 qershor 2003, Rregullorja 859/2003 i zgjeroi rregullat e koordinimit të sigurimit social për shtetasit e shteteve jo anëtare të BEsë ("shtetet e treta"), të cilët legalisht banojnë në BE dhe në vendet ndër-kufitare.

Në këtë aspekt, duhet të merret parasyshë se Rregulloret 1408/71 dhe 574/72 vazhdojnë që të vlejnjë për ta, deri atëherë kur Këshilli i Ministrave do të miratojë marrëveshje për zgjerimin e rregulloreve.

### 2.6.3 Politikat e BEsë në sferat e shëndetësisë publike

Sfera e shëndetësisë është përgjegjësi e shteteve anëtare. Roli i Bashkimit Evropian (BE), siqë është përcaktuar në traktatet evropiane, është që të ndërmarrë masa për ta plotësuar punën e shteteve anëtare, duke dhënë një vlerë shtuese evropiane, në veçanti sa u takon kërcnimeve më të mëdha shëndetësore, çështje të cilat kanë ndikim ndër-kufitar ose ndërkombëtar

dhe pyetje të ndërlidhura me lëvizjen e lirë të mirave, shërbimeve dhe njerëzve, si dhe uljes së pabarazive shëndetësore. Në këtë kontekst, në veçanti duhet të përmendet strategjia e re shëndetësore, e Komisionit të Evropës, "Së bashku për shëndetësi: Një qasje strategjike e BEsë 2008-2013", e cila ka për qëllim që të mundësojë për herë të parë një kornizë strategjike ndër-harkore, e cila i mat çështjet kyçe në shëndetësi, si dhe në të gjitha politikatat dhe çështjet globale shëndetësore<sup>15</sup>.

Në plotësim sa i takon kësaj çështjeje duhet të merret parasyshë i më hershmi Konkludim i Këshillit të BEsë "Barazi dhe shëndetësi në të gjitha politikatat: solidaritet në shëndetësi"<sup>16</sup>, i cili krijon një kornizë për veprim nga Komisioni dhe shtetet anëtare.

## SHËNIM

Në kontekstin e më lartë, duhet të merret parasyshë se një shqyrtim i më të hershmes politikë dhe praktikë e kujdesit shëndetësor dhe pabarazive të ndërlidhura me shëndetësinë të shteteve anëtare të BEsë, mund të gjendet në *Raportet e përbashkëta për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale të 2008, si dhe të 2009*.

### 2.6.3.1 Politikatat e shëndetësisë mentale të shteteve anëtare të BEsë

si takon çështjes lidhur me politikën e shëndetësisë mentale në nivel të BEsë, duhet të theksohet se shumë shtete të BEsë kanë krijuar strategji për zbatimin e politikave të reja, siqë është përmirësimi i qasjes në shërbimet sociale dhe proceset de-institucionalizuese për të kaluar nga spitalet e mëdha psikiatrike në ato më të vogla, si dhe struktura më të personalizuar dhe më të përshtatshme për ti adresuar nevojat specifike.

Megjithatë, aspektet e shëndetit mental reflektohen në shumicën e raporteve strategjike kombëtare për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale 2008-2010 (RSK), vetëm në një mënyrë shumë të kufizuar ose aspak nuk trajtohen.

Shumica e shteteve i përmendin politikatat shëndetësore, përfshirjen dhe mbrojtjen sociale në përgjithësi, mirëpo shumë pak i ndërlidhin ato me shëndetin mental dhe aspak nuk japin referencë të drejtpërdrejtë në aspektet e shëndetit mental. Shëndeti mental ndikohen në mënyrë indirekte, nga përmirësimi i shëndetësisë mentale dhe mirëqenies përmes masave socio-politike të përgjithshme. Marrë në përgjithësi, financimi i politikave dhe projekteve të ndërlidhura me shëndetin mental është i varfër në shumicën e shteteve. Programet për promovim dhe preventive të shëndetit mental mungojnë në shumicën e RSKve.

Një pengesë e përgjithshme për ti trajtuar problemet e shëndetit mental shpesh është mungesa e të dhënave të disponueshme për ta analizuar situatën në një shtet, gjë e cila disa herë e bën të vështirë definimin e synimeve konkrete<sup>17</sup>.

### 2.6.4 Siguria e pacientit dhe parandalimi i infeksioneve që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor

Kjo çështje komplekse trajtohet nga Rekomandimi i Këshillit 2009/C 151/01 i datës 9 qershor 2009 mbi sigurinë e pacientit, përfshirë edhe preventivën dhe kontrollin e infeksioneve lidhur me kujdesin shëndetësor. Duhet gjithashtu të shtohet çështja e kujdesit shëndetësor tej-kufitar, lidhur me të drejtat e pacientit, e cila rregullohet nga Direktiva e Parlamentit dhe Këshillit Evropian mbi aplikimin e të drejtave të pacientit në kujdesin shëndetësor tej-kufitar (2009), si dhe Karta e sigurimit shëndetësor (EEC) Nr 1408/71.

### 2.6.5 Politikatat e BEsë lidhur me çështjet e invaliditetit

Qasje e BEsë në invaliditet bazohet në Nenet 2, 10 dhe 19 të Traktatit për funksionimin e BEsë dhe Kartën e të drejtave fundamentale e BEsë, e cila e reafirmon të drejtën e jodiskriminimit dhe parimin e integritetit të personave me invaliditet (Nen. 26).

15. Në këtë kontekst duhet të përmendet se ka sistem informues shëndetësor të Komunitetit, i cili jep mekanizma për ta përkrahur zhvillimin e politikës shëndetësore. Ju lutemi shini Strategjinë për treguesit shëndetësor të Komunitetit Evropian (TSHKE), të qasëshme në: [http://ec.europa.eu/health/ph\\_information/dissemination/echi/echi\\_en.htm](http://ec.europa.eu/health/ph_information/dissemination/echi/echi_en.htm) .  
[http://ec.europa.eu/health/ph\\_information/dissemination/echi/echi\\_en.htm](http://ec.europa.eu/health/ph_information/dissemination/echi/echi_en.htm) .

16.Doc. 9947/10, qershor 2010

17. Në kontekstin e më lartë dyhet të theksohet se të dhëna pozitive dhe praktika të mira në këtë sferë, mund të gjenden në dokumentin "Shëndetësia mentale në raportet strategjike kombëtare për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale 2008-2010", të disponueshme në: [www.mhe-sme.org](http://www.mhe-sme.org)

Sa u takon dokumenteve kryesore për veprim politik të BEsë në këtë aspekt, duhet të përmendet "Plani veprues evropian mbi mundësitë e barabarta për personat me invaliditet (2004-2010)", i cili ka për qëllim që të krijojë një qasje të qëndrueshme dhe operacionale për çështjet e invaliditetit në Evropën e zgjeruar, që do të thotë zbatim të plotë të Direktivës për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion. Në këtë aspekt, duhet ta rikujtojmë Direktivën 89/654/EC lidhur me sigurinë minimale dhe nevojat shëndetësore në vendin e punës, si dhe veprimet specifike të BEsë lidhur me vendin për parkim të personave me invaliditet (Rekomadimi i Këshillit 98/376/EC i datës 4 qershor 1998)<sup>18</sup>.

Nëse shihet nga perspektiva e më hershme, duhet në veçanti të përmendet Rezoluta e Këshillit të BEsë "Kornizë e re evropiane për invaliditet" (2010), Rregullorja Nr. 1107/2006/EC, lidhur me të drejtat e personave me invaliditet dhe personave me lëvizshmëri të zvogluar gjatë udhëtimit në ajër dhe Rregullorja Nr. 1371/2007/EC, për të drejtat dhe detyrat e udhëtarëve të hekurudhave, e cila i adreson nevojat e personave me lëvizshmëri të zvogluar, përfshirë edhe teknologjitë komunikuese dhe informuese.

Për të përfunduar, duhet të shënohet se raportet e përbashkëta të MHK, gjithashtu i trajtojnë çështjet e invaliditetit<sup>19</sup>.

### 2.6.6 Politikat e BEsë lidhur me personat e moshuar

Relevanca e zhvillimit të kësaj çështjeje qartësisht reflektohet në Nenin 25 të Kartës së të drejtave fundamentale të BEsë, i cili nen merret me të drejtat e të moshuarve. Kjo çështje është gjithashtu subjekt i Komunikatës së Komisionit, më 29 prill 2009 – e cila merret me ndikimin e popullsisë në plakje në BE (2009 Raporti i plakjes).

Është shumë i rëndësishëm fakti se kjo çështje është në interes të sistemeve të pensioneve në BE, të cilat janë të relevancës kryesore për të.

Gjegjësisht, kjo është një nga sferat ku Evropa e sodit ballafaqohet me një nga sfidat më të mëdha: për të siguruar sisteme adekuata dhe financiarisht të mbijetueshme për popullsinë e saj e cila është në plakje; përdërisa numri i personave të moshës punëtore me shpejtësi po bie dhe numri i pensionerëve me shpejtësi po rritet.

Në kontekstin paraprak, vlen të përmendet i fundi, EPC-SPC Raporti i përbashkët mbi pensionet (2010), i cili e përvijon në mënyrë detale kornizën aktuale evropiane në përkrahje të reformave kombëtare pensionale; i cili gjithashtu e përfshin edhe Metodën e hapur të koordinimit (SPSI) dhe Objektivat e Laekenit.

Të gjitha çështjet në sferën e reformave të pensionit janë ilustruar në Letrën e gjelbërt të Komisionit "Drejtë një sistemi pensionesh evropian adekuat, të qëndrueshëm dhe të sigurtë" (qershor 2010), e cila është bazuar (mes tjerave) në raportet e përbashkëta të lidhura me të.

Kjo Letër e gjelbërt, i përshkruan veprimet e mëturshme politike të cilat duhet të ndërmerren nga BEja dhe shtetet anëtare të saj në disa fronte, përfshirë: adresimi i zbratirave të përshtatshmërisë; mbyllja e zbratirave të qëndrueshmërisë; zgjerimi i jetës punuese, kryesisht përmes rritjes së moshave për pensionim dhe pensionimit efektiv; heqja e pengesave për lëvizshmërinë brenda dhe mes shteteve anëtare; dhe përforcimi i sigurisë në suazat e pensioneve.

Në këtë kontekst duhet t'ju bëhet referencë një sërë të konkludimeve specifike për "Sisteme të qëndrueshme të sigurisë sociale të pensioneve adekuata, të cilat krijojnë pensione adekuata dhe i realizojnë objektivat e përfshirjes sociale" (2010), të cilat kanë të bëjnë me çështjen specifike të pensioneve minimale ose me rregulloret e të ardhurave minimale, si dhe me konkludimet e Këshillit për "Plakjen aktive".

Për të përfunduar duhet gjithashtu të përmendet edhe Letra e gjelbërt për lëvizshmërinë urbane (2007), e ndjekur nga Plani veprues i Komisionit për lëvizshmërinë urbane në 2009 dhe "2010 - Plani veprues novativ mbi informimin dhe teknologjitë komunikuese dhe plakjen".

### SHËNIM:

Në kontekstin e më lartë duhet të theksohet se një shqyrtim i detajuar i politikave më aktuale lidhur me personat e moshuar të shteteve anëtare të BEsë, mund të gjendet në Raportin e përbashkët për mbrojtje sociale dhe përfshirje

18. Në plotësim duhet të rikujtohet veprimi i Komisionit në sferën e politikës konkurruese, me miratimin (nëntor, 2002) e Rregullores mbi ndihmën shtetërore për punësimin, e cila i mundëson shtetet anëtare (mes tjerave) të financojnë deri më 60% të shpenzime vjetore për rroga dhe kontribute për sigurim social, atëherë kur kompanitë rekrutojnë punëtorë me invaliditet.

19. Në kontekstin e më lartë, rezultate pozitive dhe shembuj të praktikave të mira në sferën e shëndetësisë mentale mund të gjenden në [www.mhe-sme.org](http://www.mhe-sme.org)



sociale të 2009 dhe 2010.

Në plotësim dhe për hir të fitimit të pikturës më të mirë për praktikën më aktuale dhe vijuese të shteteve anëtare të BEsë lidhur me çështjen më lartë, duhet të merren në konsiderim projektet specifike të financuara nga BE<sup>20</sup>.

### 2.6.7 Politikat e BEsë për barazinë mes burrave dhe grave

Gjerësisht njihet se BEja ka bërë një progres të madh në realizimin e barazisë gjinore, në falemnderim të legjislationit të saj për trajtim të barabartë, mbizotërim gjinor, masave specifike për avancimin e grave, programeve vepruese, dialogut social dhe dialogut me shoqërinë civile.

Në plotësim të instrumenteve specifike të BEsë, të përmendura në nën-sekcionet paraprahe të kësaj pjese të botimit, duhet të theksohet se korniza ligjore thelbësore e kësaj çështje është aktualisht e inkuorporuar në të lartpërmendurën Kartë e të drejtave fundamentale të BEsë, gjegjësisht, Neni 20 mbi Barazinë përpara ligjit, Neni 23 mbi Barazinë mes burrave dhe grave.

Në këtë kontekst, duhet të shtohet Harta udhëzuese për barazi mes grave dhe burrave (2006-2010), e cila i përvijon sferat specifike prioritare dhe për secilën sferë identifikon objektiva dhe veprime kyçe, të cilat duhet ta lehtësojnë zbatimin e tyre.

Harta udhëzuese duhet të shihet në relacion të afërt me ndonjë instrument tjetër të BEsë, përfshirë të lartpërmendurën Komunikatë 'Një agjendë e ripërtrirë sociale: mundësi, qasje dhe solidaritet në Evropën e shekullit 21' të shoqëruar nga Komunikata për 'Jodiskriminim dhe mundësi të barabarta: Një zotim i ripërtrirë', si dhe Pakti evropian për barazi gjinore; të gjitha nga të cilat bëjnë referencë specifike tek tre të mirënjohurat direktiva të BEsë në këtë sferë, të cilat janë më të miratuara për ti dhënë efekt Neni 13 TEC: Direktiva e Këshillit 2000/43/EC e datës 9 qershor 2000, e cila e zbaton parimin e trajtimit të barbartë mes personave pa dallim të origjinës racore ose etnike; 2000/78/EC e datës 27 nëntor 2000, mbi krijimin e kornizës së përgjithshme për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion; dhe 2004/113/EC e datës 13 dhjetor 2004, mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barbartë mes burrave dhe grave në qasjen dhe furnizimin e të mirave dhe shërbimeve.

Për të përfunduar duhet të theksohet raporti vjetor i Komisionit për barazinë mes grave dhe burrave, i cili e analizon evoluimin e treguesve kyç në sferën e barazisë, përfshirë në të edhe një shtojcë të detajuar statistike. Kjo qartësisht ilustron në Komunikatën e saj "Raporti në afat të mesëm për progresin e udhëzimeve për barazinë mes grave dhe burrave (2006-2010)".

### 2.6.8 Politikat e BEsë lidhur me varfërinë fëmijore

Zotimi i BEsë për zbatimin e politikës fëmijore është përforcuar në vitet e fundit me prezantimin e një sere të masave të cilat adresojnë mbrojtjen fëmijore, varfërinë dhe ç'kujçjen sociale, si dhe diskriminimin e bazuar në moshë.

Një hap i rëndësishëm në këtë drejtim është ndërmarrë nga Komisioni Evropian në 2006, përmes Komunikatës së tij "Drejtë një strategjie mbi të drejtat fëmijore", e cila paraqet një qasje koherente, përfillëse në zhvillimin, aplikimin, vëzhgimin dhe shqyrtimin e ligjit dhe politikës së BEsë, me ndikim mbi fëmijët.

Kjo strategji bazohet në një sërë të objektivave specifike përfshirë edhe nisjen e Planit veprues për fëmijët në bashkëpunimin zhvillimor, krijimi i një forumi evropian për të drejtat fëmijore, etj.

Në plotësim të paraprahes Komunikatë, duhet të shtohet se në Raportet kombëtare 2006-2008 për strategjitë për mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale, qeveritë e shteteve anëtare të BEsë, janë zotuar të krijojnë një qasje strategjike, të integruar dhe afatgjate për parandalim dhe adresim të varfërisë dhe ç'kujçjes sociale mes fëmijëve; kjo u plotësua (në janar 2008) me raportin "Varfëria dhe mirëqenia fëmijore" të miratuar nga Komiteti për mbrojtje sociale i BEsë.

Raporti i *Agjencisë së BEsë për të drejta fundamentale (i 2009)*<sup>21</sup>, përmban tregues specifik të cilët e masin mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave fëmijore. Përfaqëson një manual mjetesh për ta vlerësuar ndikimin e ligjit dhe politikës së BEsë mbi statusin e fëmijëve dhe eksperiencën në sferat e ndryshme; treguesit e prezantuar në raport gjithashtu kanë për qëllim që ta nënvizojnë zbrastirën ekzistuese në rregulloret dhe të dhënat aktuale të BEsë.

Në këtë kontekst, gjithashtu duhet të merren në konsiderim dokumentet e ardhshme: "Udhëzimet e BEsë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave fëmijore" (të 2007) të Këshillit, si dhe Dokumenti punues i personelit të Komisionit i cili e

20. Për më tepër informata lidhur me projektet më aktuale në sferën e më lartë, shihni në "Plakja e mirë në Evropë: instrumente dhe mjete në disponim të aktorëve lokal dhe regjional", tetor 2009.

21. "Krijimi i treguesve për mbrojtjen, respektin dhe promovimin e të drejtave fëmijore në Bashkimin Evropian", mars 2009, të disponueshme në: [www.fra.europa.eu](http://www.fra.europa.eu)

shoqëron Komunikatën e Komisionit – Drejtë një strategji të BEsë për të drejtat femërore – vlerësim i ndikimit, i 2006, i cili qartësisht i referohet nevojës për formulim të një pako të treguesve për ta shqyrtuar ndikimin e aktiviteteve ligjore dhe politike të BEsë mbi fëmijët<sup>22</sup>.

## SHËNIM

Në kontekstin e më lartë duhet të merret parasysh se politikat dhe praktikave të fundit të shteteve anëtare, sa u takon familjeve me fëmijë dhe varfërisë femërore, përfshihen nga të fundit Raporte të përbashkëta të MHK<sup>23</sup>.

### 2.6.9 Politikat e BEsë lidhur me romët

Politikat e BEsë në çështjet që kanë të bëjnë me romët reflektohen në një sërë dokumentesh, përfshirë edhe konkludimet e Këshillit të Evropës, në dhjetor 2007 dhe qershor 2008, konkludimet e Këshillit për çështjet të përgjithshme në dhjetor 2008, si dhe Rezoluta e Parlamentit Evropian në mars 2009 për gjendjen sociale të romëve dhe qasjen e tyre të përmirësuar në tregun e punës në BEsë.

Dokumenti punues i personelit të Komisionit, i cili e shoqëron të lartpërmendurën Komunikatë për "Jodiskriminim dhe mundësi të barbarta: Një zotim i ripërtirë", merret me çështjen e instrumenteve dhe politikave të Komunitetit për përfshirje të romëve (2008).

E më larta kompletohet nga Platforma evropiane për përfshirje të romëve, arritja e të cilës ka për qëllim që ta stimulojë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e eksperiencës me politika dhe praktika të suksesshme përfshirëse për romët.

Në këtë aspekt, duhet të rikujtohet se në takimin e parë të saj (Pragë, 24 prill 2009), u identifikua një pako e 10 Parimeve bazike të zakonshme për ta adresuar efektivisht përfshirjen e romëve.

Këto parime të zakonshme kanë për qëllim që ti udhëzojnë institucionet e BEsë dhe shtetet anëtare, kandidatët dhe shtetet potenciale për kandidatët gjatë dizenjimit dhe zbatimit të politikave ose aktiviteteve të tyre të reja në këtë kontekst.

### 2.6.10 Forma të tjera të ç'kyçjes sociale në nivel të BEsë

Në plotësim të formave të lartpërmendura të ç'kyçjes sociale vlen të përmenden edhe forma të tjera të ç'kyçjes sociale në nivel evropian, përfshirë këtu pastrehimin, atë të ndërlidhur me migrantët dhe ç'kyçjen financiare.

Sa i takon pastrehimit, duhet ti bëhet referencë më të hershmit Raport të përbashkët të MHK (2010), i cili (mes tjerave) thotë: "2009 ishte viti fokus i pastrehimit dhe ç'kyçjes banuese, përbrenda MHK sociale. Puna në këtë kontekst, zbuloi se mungesa e banimit adekuat është një problem i cili gjatë ekziston në shumicën e shteteve evropiane".

Sa i takon ç'kyçjes sociale lidhur me migrantët, gjerësisht është pranuar se bashkëpunimi evropian sa u takon këtyre çështjeve është ballafaquar me shumë vështirësi, që nga Traktati i Amsterdimit të BEsë e deri më sot. Problem i posaçëm në këtë aspekt është (mes tjerave) gjendja aktuale e migrantëve jo të dokumentuar në BE dhe qasja e tyre në të drejtat sociale dhe ekonomike.

Duke e parë nga perspektiva e më hershme, duhet të përmendet Letra e gjelbërt për një qasje të BEsë në menaxhimin e migrimit ekonomik (2004) dhe i ashtuquajturit Program i Hagës (i cili e përcakton agjendën për politikat imigruese dhe azil për periudhën 2005-2010).

Kjo e fundit e përfshin "Planin politik për migrim legal" të Komisionit, duke prezantuar një listë të veprimeve dhe iniciativave legislative të qëlluara për tu miratuar deri në fund të 2009, duke respektuar "zhvillimin koherent të politikës ligjore të BEsë lidhur me migrimin", Paktin evropian për imigrim dhe azil (2008), i cili nuk është dokument ligjorësisht i detyrueshëm, Direktiva e BEsë për "Kartën e kaltërt për imigrantët shumë të kualifikuar" (2009) dhe të ashtuquajturën "Direktivë kthyesë" e BEsë (2008)<sup>24</sup>.

Në plotësim, kjo temë komplekse gjithashtu trajtohet nga shumë dokumente të tjera ligjore dhe politike të BEsë, përfshirë (mes tjerave) të ardhshmet Direktiva të Këshillit: 2003/86/EC mbi reunifikimin e familjes; 2003/109/EC mbi statusin për

22. Në këtë kontekst, kini ndërmend se Komisioni Evropian ka nisur (në qershor 2010) një konsultim publik për një strategji të re të BEsë për të drejtat femërore, me qëllim që ti përmirësojë ato dhe të gjejë veprime të reja potenciale për rinisjen e strategjisë së 2006 për periudhën 2011-2014.

23. Për informata lishur me shembuj të praktikave të mira në luftën kundër varfërisë femërore ju lutemi shihni në: <http://www.againstchildpoverty.com/employment/education/health/housing-casestudies.php>

24. Direktiva 2008/115/EC për standardet dhe procedurat e përbashkëta në shtetet anëtare për kthimin e shtetasve të shteteve të treta të cilët ilegalisht banojnë, të botuar në Gazetën Zyrtare (L 348 më 24.12.2008). Afati i fundit për miratim nga ana e shteteve anëtare është 24.10.2010.

qëndrim afatgjatë për shtetasit e shteteve të treta të cilët legalisht kanë banuar për pesë vite në territorin e një shteti anëtar; 2004/114 mbi kushtet për pranimin e shtetasve të shteteve të treta për qëllime të studimit, shkëmbimeve të nxënësve, trajnim ose shërbim vullnetarë të papaguar; 2005/71 për lehtësimin e pranimin të hulumtuesve në BE. Kontributi më i ri sa i takon asaj më lartë, në nivel të BEsë, është dhënë nga i ashtuquajturin Program i Stokholmit (2009), i cili mundëson një kornizë për veprimin e BEsë lidhur me çështjet e nënshtetësisë, drejtësisë, sigurisë, azilit dhe imigrimit për pesë vitet e ardhshme (2010-2014)<sup>25</sup>.

Sa i takon gjendjes më aktuale të migrantëve në BE, duhet të merret parasysh analiza e bërë (qershor 2010) nga *“Caritas Europa”*<sup>26</sup>, e cila duhet të shihet në aspekt të Raportit të përbashkët të MHK 2009, i cili gjithashtu përmban rezultate dhe konkludime të ngjajshme, si dhe konkludimi i ngjajshëm për punën dhe varfërinë (i 2009)<sup>27</sup> i Komitetit evropian ekonomik dhe social.

Sa i takon çështjes së *“ç’kyçjes financiare”*, duhet të theksohet se piktura e parë gjithëpërfshirëse, e natyrës dhe gjerësisë së ç’kyçjes financiare në Evropë është dhënë nga hulumtimi i fundit i titulluar *“Mësimi i ndërmjetshëm për ç’kyçjen financiare”* (2008).

Kjo çështje gjithashtu trajtohet nga i fundit Raport i përbashkët i MHK, i cili në këtë aspekt në veçanti thekson (mes tjerave) se *“adresimi i ç’kyçjes financiare është vital në çdo strategji kundër varfërisë, dhe kriza e aktualizon këtë çështje edhe më shumë.”*<sup>28</sup>

Raporti gjithashtu e trajton edhe çështjen e disavantazheve arsimore.

## SHËNIM

Sa u takon të gjitha nën-sekcioneve të kësaj pjese të botimit, duhet në veçanti të theksohet se është koncepti i *“përfshirjes aktive”*, nën të cilin mund të fitohet një pikturë më e qartë e çështjeve të trajtuara paraprakisht. Kjo më së miri është ilustruar në të lartpërmendurin Raport të përbashkët të MHK 2009<sup>29</sup>.

### 2.7 Roli i praktikës ligjore të Gjykatës evropiane të drejtësisë në sferat e anti-varfërisë dhe përfshirjes sociale

Relevanca e kësaj çështje bazohet dhe buron nga misioni respektiv i Gjykatës evropiane të drejtësisë (GJED), si gjykata më e lartë në BE sa u takon çështjeve ligjore të BEsë.

Gjegjësisht, që nga themelimi i GJED në 1952, misioni i saj ka qenë që ta sigurojë *“vëzhgimin e ligjit lidhur me interpretimin dhe aplikimin e Traktateve”*. Si pjesë e këtij misioni, GJED: e shqyrton legalitetin e akteve të institucioneve të BEsë, sigurohet se shtetet anëtare i zbatojnë detyrat në pajtim me Traktatet dhe e interpreton ligjin e BEsë në kërkesë të gjyqeve dhe tribunaleve kombëtare.

Me siguri se e më larta bëhet më e qartë vetëm atëherë kur të gjitha nenet e Traktatit të Lisbonit do të merren parasysh, duke përfshirë edhe Nenin 258 (veç Nenit 226) të Traktatit mbi funksionimin e BEsë, sipas të cilit, *“Gjykata e drejtësisë mundet të bëjë vlerësim të asaj se nëse një shtet anëtar i ka përmbushur detyrat e tij sipas ligjit të Komunitetit”*. Kjo mund të inicohet nga Komisioni – siqë zakonisht është edhe praktika – ose nga një shtet anëtar tjetër- edhe pse lloji i fundit është shumë i rrallë. Nëse Gjykata përcakton se një detyrë nuk është përmbushur, shtetet anëtare në pyetje duhet ti japin fund shkeljes.

Nëse, pasi që procedura të jenë inicuar nga Komisioni, Gjykata e drejtësië vërteton se shteti anëtar në pyetje ende nuk ka vepruar sipas udhëzimit të saj, mundet në kërkesë të Komisionit, të imponojë mbi shtetin anëtar një dënim financiar fiks ose periodik.

Për hir të qëllimit të ilustrimit të shkurtër të asaj thënë paraprakisht, mjafton të përmendet se Komisioni me 14 maj 2009, e ka nxjerrë Poloninë përpara Gjykatës evropiane të drejtësisë (GJED), për mosrespektimin e rregullave të BEsë të cilat

25. Në këtë kontekst, duhet të rikujtohet se kur e shohim statusin ratifikues të konventave më të rëndësishme ndërkombëtare në sferat e më larta, shihet se shtetet anëtare të BEsë nuk kanë shumë sukses; asnjëra nga shtetet anëtare të BEsë nuk ka ratifikuar (për shembull) Konventën për punëtorët migrantë të KB. Sa u takon konventave të ONP rezultatet janë vetëm pak më të mira.

26. *“Varfëria në Evropë: Kufijtë e padukshëm – një barrierë për përfshirjen”*, dokument nga Caritas për varfërinë në Evropë më vitin 2010. Ky dokument është pjesë e fushatës Zero varfëri; [www.zeropoverty.org](http://www.zeropoverty.org).

27. b KEES, Mendim mbi punën dhe varfërinë: Drejtë qasje së nevojshme holistike, SOC/336, 30 shtator 2009.

28. Për infomata lidhur me praktikën më aktuale të shteteve anëtare të BEsë në këtë sferë shihni në: <http://www.fininc.eu/knowledge-and-data/best-practices,en,48,96,2.html>.

29. Për më tepër informata lidhur me format e lartpërmendura të ç’kyçjes sociale në nivel të BEsë, ju lutemi gjithashtu shihni edhe Hulumtimin e dytë evropian për kualitetin e jetës, jetën familjare dhe punën (të botuar në 2010).

parandalojnë diskriminimin gjinor në qasjen dhe furnizimin e të mirave dhe shërbimeve (Direktiva 2004/113/EC). Në këtë kontekst duhet të nënvizohet se shumë të drejtave socio-ekonomike, të inkuorporuara në Kartën e të drejtave fundamentale të BEsë, u janë dhënë mirënjohje nga GJED edhe përpara se Karta të bëhet pjesë integruese e Traktatit të Lisbonit të BEsë.

Kështu që, GJED de facto ishte organi i parë i BEsë, i cili e theksoi nevojën për mbrojtjen e të drejtave njerëzore për individin duke përcaktuar standarde për mbrojtjen dhe është, në një pjesë të madhe, përgjegjëse për përfshirjen e të drejtave socio-ekonomike në agjendën e Komunitetit; GJED përmes praktikës së saj ligjore krijoi një "teori të drejtave sociale", e cila i përcakton kufizimet e integritit ekonomik evropian shumë më tepër se sa që propozon legjislacioni i KE i cili është në fuqi.

GJED ka sjellë vendime për shumë raste, për shembull, lidhur me aranzhmanet e politikës sociale të shteteve anëtare të BEsë lidhur me lëvizjen e lirë, etj.

## **2.8 Kontributi i BEsë në OZHM të KB**

Zotimi i madh i BEsë në OZHM, më së shpejti u reafirmua nga Konkludimet e Këshillit për Objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit (14 qershor 2010), në relacion të vijuesit Takim i lartë parlamentar i KB lidhur me Objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit.

Në këtë aspekt, duhet të theksohet se ishte Komunikata e Komisionit "Plani veprues 12 pikësh i BEsë në përkrahje të Objektivave të zhvillimit të mijëvjeçarit", ai i cili ka dhënë udhëzim esencial për pozitën paraprake të BEsë.

Ky Plan veprues është miratuar nga Këshilli më qershor të 2010, i cili duke e ilustruar vetë veprimin e BEsë, e përshkruan vitin 2010 si vit kyç për veprim dhe përgjegjësi për përsheptim të progresit sa u takon OZHM.

### KORNIZA LIGJORE DHE POLITIKE MAQEDONASE NË SFERAT E ANTI-VARFËRISË DHE PËRF-SHIRJES SOCIALE

#### HYRJE

Siqë është theksuar në hyrjen e këtij botimi, lufta kundër varfërisë dhe ç'kyçjes sociale, është vendosur lartë në agjendën e Republikës së Maqedonisë, posaçërisht gjatë disa viteve të fundit.

Sa i takon bazës ligjore për veprimin kombëtar në sferat e më larta, duhet të theksohet se ajo kyçe gjendet në rregullat e Kushtetutës së Republikë së Maqedonisë, si dhe në numrin e madh të ligjeve, të cilat i trajton çështjet specifike në të gjitha sferat relevante, të shoqëruara nga numri rritës i programeve dhe dokumenteve politike strategjike. Ato synojnë trajtimin e çështjeve të indikuara më lartë dhe për ti udhëzuar përpjekjet shtetërore në këtë aspekt. Procesi në këtë drejtim njëkohësisht stimulohet dhe/ose përforcohet nga anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë në organizatat kryesore ndërkombëtare dhe ndërqeveritare, duke përfshirë edhe sistemin përkatës të Kombeve të Bashkuara, Organizatën ndërkombëtare të punës (ONP), Këshillin e Evropës (KiE) dhe Bashkimin Evropian (BE).

Në relacion të sistemit më të gjërë të KB, duhet të theksohet se Republika e Maqedonisë i ka ratifikuar shumicën e traktateve për të drejtat njerzore të KB, mirëpo ka ende një numër të instrumenteve relevante ligjore të cilat gjithashtu duhet të miratohen.

Gjendja e njejtë është edhe në relacion të anëtarësisë së shtetit në ONP.

Në kontekst të KiE, duhet të theksohet se shteti gjithashtu ka ratifikuar një numër të madh të instrumenteve ligjore të kësaj organizate me tema specifike të trajtimit, mirëpo ende nuk e ka ratifikuar (mes tjerave) Kartën sociale evropiane të revizionuar. Njëkohshëm, është kapaciteti i tij, i të qenit shtet kandidat për anëtarësim në BE, i cili do të përgatitet në bashkëpunim me BE-në. Mu këtu duhet të theksohet plotësueshmëria mes përpjekjeve vijuese të Maqedonisë, në realizimin e prioriteteve të saj ekonomike dhe sociale gjatë integritimit në BE dhe detyrat e saj të bazuara në anëtarësimin e plotë në KiE (sa i takon zbatimin të konventave të KiE...), si dhe sistemin e KB (sa u takon standardeve për të drejtat njerzore dhe realizimin e OZHM). Kjo e fundit, gjithashtu e përfshin anëtarësimin e shtetit në organizatat tjera, përfshirë ONP, UNICEF, UNESCO, OBSH etj. Kjo ka të bëjë me ndërlidhshmërinë shumë natyrale mes instrumenteve ligjore, të miratura individualisht nga ato organizata, si dhe (paralelisht) relacionet e afërta mes organizatave të njejtë.

Aktualiteti paraprak, i përpjekjeve të ndërlidhura me anti-varfërinë dhe ç'kyçjen sociale në Republikën e Maqedonisë, së fundi është reflektuar në aktualen Strategji kombëtare për ulje të varfërisë dhe ç'kyçjes sociale në Republikën e Maqedonisë (14.10.2010), e cila qartas e reflekton zotimin e madh të shtetit në aspektin e më lartë, si dhe lidhur me sfidat të ballafaquara nga shteti dhe shoqëria maqedonase.

Në kontekstin e më lartë, pjesa e tretë e këtij botimi jep një shqyrtim të neneve më relevant të përzgjedhura nga Kushtetuta maqedonase, të ndjekur nga një shqyrtim të shkurtër të legjislativës vendore dhe kornizës së veprimit politik lidhur me sferat e anti-varfërisë dhe ç'kyçjes sociale. Gjithashtu, përmban një shqyrtim të shkurtër të detyrave të shtetit, të cilat burojnë nga statusi i të qenit palë kontraktuese në instrumentet ligjore ndërkombëtare, të miratuara nga KB, ONP, KiE dhe BE.

### 3.1. SHQYRTIM I NENEVE TË PËRZGJEDHURA KUSHTETUESE

- **Neni 1:** Republika e Maqedonisë është një shtet sovran, i pavarur, demokratik dhe social;
- **Neni 8:** Vlerat fundamentale të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë janë: liritë dhe të drejtat themelore të njeriut e të shtetasit të pranuar me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë; të shprehurit e lirë të përkatësisë kombëtare; sundimi i së drejtës; ndarja e pushtetit shtetëror në atë ligdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor; liria e tregut dhe e ndërmarrësisë; humanizmi, drejtësia sociale dhe solidariteti; vetëqeverisja lokale; planifikim i përshtatshëm urban dhe rural për të promovuar një mjedis njerëzor të harmonizuar si dhe mbrojtje dhe zhvillim ekologjik; dhe respektimi i normave përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare. Në Republikën e Maqedonisë është e lirë çdo gjë që nuk është e ndaluar me Kushtetutë dhe me ligj;
- **Neni 9:** Shtetasit e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale, bindja politike dhe fetare, pozita pasurore dhe shoqërore. Shtetasit janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjit;
- **Neni 30:** Garantohet e drejta e pronësisë dhe e drejta e trashëgimisë. Pronësia krijon të drejta dhe detyrime dhe duhet të shërbejë për të mirën e individit dhe të bashkësisë. Askujt nuk mund t'i merret ose t'i kufizohet pronësia dhe të drejtat të cilat rrjedhin prej saj, përveçse kur kemi të bëjmë me interesin publik të caktuar me ligj. Në rast të ekspropriimit të pronësisë ose në rast të kufizimit të pronësisë, garantohet kompensimi i drejtë i cili nuk mund të jetë më i ulët nga vlera e tregut;
- **Neni 31:** Personi i huaj në Republikën e Maqedonisë mund të fitojë të drejtën e pronësisë nën kushtet e caktuara me ligj;
- **Neni 32:** Secili ka të drejtë në punë, zgjedhje të lirë të punës, mbrojtje gjatë punës dhe në sigurim material gjatë kohës të papunësisë së përkohshme. Secilit, nën kushte të barabarta, i është i arritshëm çdo vend pune. Secili i punësuar ka të drejtë në pagë adekuate. Secili i punësuar ka të drejtë në pushim të paguar ditor, javor dhe vjetor. Të punësuarit nuk mund të heqin dorë nga këto të drejta. Realizimi i të drejtave i të punësuarëve dhe pozita e tyre rregullohet me ligj dhe me kontrata kolektive;
- **Neni 33:** Secili është i obliguar të paguaj tatim dhe detyrime të tjera publike dhe të merr pjesë në mbulimin e shpenzimeve publike në mënyrën e caktuar me ligj;
- **Neni 34:** Shtetasit kanë të drejtë në siguri sociale dhe sigurim social të caktuar me ligj dhe me kontratë kolektive;
- **Neni 35:** Republika kujdeset për mbrojtjen sociale dhe sigurinë sociale të shtetasve në pajtim me parimin e drejtësisë sociale. Republika ua garanton të drejtën e ndihmës shtetasve të pafuqishëm dhe të paaftë për punë. Republika u siguron mbrojtje të veçantë invalidëve dhe kushte për inkuadrimin e tyre në jetën shoqërore;
- **Neni 36:** Republika u garanton të drejta të veçanta sociale luftëtarëve të Luftës antifashiste dhe të gjitha luftëtarëve nacional-çlirimtarë të Maqedonisë, invalidëve të luftës, të përndjekurëve dhe të burgosurëve për idetë e vetëqenies së popullit maqedonas dhe të shtetshmërisë së tij, si dhe anëtarëve të familjeve të tyre, të cilët nuk kanë mundësi për ekzistencë materiale dhe sociale. Të drejtat e veçanta rregullohen me ligj;
- **Neni 37:** Me qëllim të realizimit të të drejtave të tyre ekonomike dhe sociale, shtetasit kanë të drejtë të themelojnë sindikata. Sindikatat mund të themelojnë bashkimet e tyre dhe të anëtarësohen në organizatat sindikale ndërkombëtare. Me ligj mund të kufizohen kushtet për realizimin e të drejtës së organizimit sindikal në forcat e armatosura, në polici dhe në organet e administratës;
- **Neni 38:** Garantohet e drejta e grevës. Me ligj mund të kufizohen kushtet për realizimin e të drejtës së grevës në forcat e armatosura, në polici dhe në organet e administratës;
- **Neni 39:** Secilit i garantohet e drejta e mbrojtjes shëndetësore. Shtetasi ka të drejtë dhe detyrë që të ruajë dhe të përparojë shëndetin e tij dhe shëndetin e të tjerëve;
- **Neni 40:** Republika kujdeset dhe i siguron mbrojtje të veçantë familjes. Marrëdhëniet juridike në martesë,

familje dhe bashkësinë jashtëmartesore rregullohen me ligj. Prindërit kanë të drejtë dhe detyrë që të kujdesen për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve. Fëmijët janë të obliguar që të kujdesen për prindërit e moshuar dhe të pafuqishëm. Republika u siguron mbrojtje të veçantë fëmijëve pa prind dhe fëmijëve pa kujdes prindëror.

- **Neni 41:** Është e drejtë e njeriut që lirisht të vendos për lindjen e fëmijëve. Republika, me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe social harmonik, udhëheq një politikë humane të popullimit.
- **Neni 42:** Republika veçanërisht e mbron amësinë, fëmijët dhe personat e mitur. Personi më i ri se 15 vjeç nuk mund të punësohet. Personat e mitur dhe nënat kanë të drejtë në mbrojtje të veçantë në punë. Personat e mitur nuk guxojnë të punësohen në vendet e punës të cilat janë të dëmshme për shëndetin dhe moralin e tyre.
- **Neni 43:** Secili ka të drejtë për mjedis të shëndosh jetësor. Secili është i obliguar ta përparojë dhe ta mbrojë mjedisin jetësor dhe natyrën. Republika siguron kushte për realizimin e të drejtës së shtetasve për mjedis të shëndoshë jetësor;
- **Neni 44:** Secili ka të drejtë në arsimim. Arsimiti është i arritshëm për secilin nën kushte të barabarta. Arsimiti fillor është i detyrueshëm dhe pa pagesë;
- **Neni 45:** Shtetasit kanë të drejtë, nën kushtet e caktuara me ligj, të themelojnë institucione private të arsimit në të gjitha shkallët e arsimit, përveçse në arsimin fillor;
- **Neni 46:** Universitetit i garantohet autonomia. Kushtet për themelimin, ushtrimin dhe ndërprerjen e veprimtarisë së universitetit, rregullohen me ligj;
- **Neni 47:** Garantohet liria e krijimtarisë shkencore, artistike dhe llojeve të tjera të krijimtarisë. Garantohen të drejtat të cilat burojnë nga krijimtaria shkencore, artistike dhe nga lloji tjetër i krijimtarisë intelektuale. Republika nxitë, ndihmon dhe mbron zhvillimin e shkencës, artit dhe kulturës. Republika nxitë dhe ndihmon zhvillimin shkencor dhe teknologjik. Republika nxitë dhe ndihmon kulturën teknike dhe sportin;
- **Neni 55:** Garantohet liria e tregut dhe e ndërmarrësisë. Republika u siguron pozitë të barabartë juridike të gjitha subjekteve të tregut. Republika ndërmerr masa kundër pozitës monopoliste dhe sjelljes monopoliste në treg. Liria e tregut dhe e ndërmarrësisë mund të kufizohet me ligj vetëm me qëllim të mbrojtjes së Republikës, ruajtjes së natyrës, mjedisit jetësor ose shëndetit të njerëzve;
- **Neni 57:** Republika nxitë përparimin ekonomik dhe kujdeset për zhvillimin më të harmonizuar

hapësinor dhe regional, si dhe për zhvillimin më të shpejtë të rajoneve ekonomikisht jo mjaft të zhvilluara;

- **Neni 58:** Pronësia dhe puna janë bazë për qeverisje dhe pjesëmarrje në vendim-marrje. Pjesëmarrja në qeverisje dhe në vendim-marrje në institucionet dhe shërbimet publike rregullohet me ligj dhe në bazë të parimeve të profesionalitetit dhe të kompetencës.



## 3.2 Korniza ligjore dhe politike maqedonase në sferat e anti-varfërisë dhe përfshirjes sociale

### 3.2.1 Korniza ligjore dhe politike e punës

Mbrojtje e veçantë e dhënë me **Ligjin për marrëdhënie pune:**

- mbrojtja e punëtorëve në rast të shtatëzarisë dhe prindërimit;
- ndalohet kryerja e punës gjatë shtatëzarisë dhe pas lindjes;
- mbrojtja speciale gjatë shtatëzarisë; "e drejta e pushimit të paguar nga puna për shkak të shtatëzarisë, lindjes dhe prindërimit";
- e drejta e punëtores për tu kthyer në punën e saj pas pushimit të shtatëzarisë, lindjes ose prindërimit;
- e drejta e përdorimit të pushimit atëror ose kujdestarit të fëmijës;
- e drejta për orar të shkurtuar pune për prindërin e fëmijut me probleme në zhvillim dhe nevoja të posaçme edukuese;
- mbrojtja e punëtorëve nën moshën 18 vjeçare;
- mbrojtje e invalidëve me të drejtë për rehabilitim profesional;
- mbrojtje speciale e punëtorëve më të moshuar;
- zgjidhje paqësore e mosëmarrëveshjeve punuese individuale dhe kolektive;
- çështje të lidhura me "sindikatat dhe shoqatat e punëdhënësve"
- e drejta e punonjësit që lirisht të krijojë sindikatë dhe të anëtarsohet në ta sipas kushteve të përcaktuara nga statusi ose rregulla e asaj sindikate";
- marrëveshjet kolektive;
- të drejtat dhe detyrat gjatë grevës;
- e drejta e sindikatave dhe shoqatave të tyre për të bërë grevë për hir të mbrojtjes së të drejtave ekonomike dhe sociale të anëtarëve lidhur me marrëdhëniet e punës.

**Ligje të tjera lidhur me punën:**

- Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë
- Ligji mbi inspektionin e punës
- Ligji për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë
- Ligji për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve në punë
- Ligji për punën vullnetare
- Ligji për agjencitë për punësim të përkohshëm
- Ligji për punësimin e të huajve
- Ligji për punësimin e personave me invaliditet
- Ligji për mbrojtje sociale

**Ligji për marrëdhënie pune**, i rregullon marrëdhëniet e punës mes punonjësve dhe punëdhënësve, të cilat janë krijuar në bazë të nënshkrimit të një kontrate për punë.

Ky Ligj i rregullon të gjitha aspektet relevante të marrëdhënieve të punonjësve dhe punëdhënësve, të përfshirë në organet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale, institucione, kompani publike, fonde, byro, organizata dhe persona të tjerë juridik dhe fizik të cilët punësojnë punëtorë, vetëm në raste kur përcaktohet ndryshe nga ligji; detalisht i përcakton të gjitha detyrat dhe të drejtat specifike të punëdhënësve dhe punonjësve përmes nënshkrimit të kontratës së punës dhe në veçanti ato në relacion të performancës së punës. Ligji, gjithashtu (gjë shumë e rëndësishme) është baza ligjore kryesore për krijimin e "Këshillit ekonomik social".

Në kontekstin e më lartë dhe sa u takon të lartëpërmendurave "marrëveshje kolektive", duhet të merret në konsiderim se ka një marrëveshje kolektive të përgjithshme për sektorin privat në sferën e ekonomisë. Një kontratë e tillë ekziston edhe për sektorin publik, i cili ka të bëjë me autoritetet shtetërore dhe organet e tjera shtetërore, organet e njësjete të vetëqeverisjes lokale, institucionet, kompanitë publike, byrotë, agjencitë, fondet dhe entitetete tjera juridike të cilat kryejnë një aktivitet të interesit publik<sup>30</sup>. Të dy llojet e marrëveshjeve kolektive të përgjithshme, vlejnë drejtëpërdrejt dhe janë detyruese për punonjësit dhe punëdhënësit në të dy sektoret.

Këto marrëveshje i rregullojnë të drejtat dhe detyrat e të dyja palëve dhe mund gjithashtu, të përmbajnë rregulla ligjore të cilat i rregullojnë konkludimet, përmbajtjet dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, si dhe çështje të tjera lidhur me marrëdhëniet e punës<sup>31</sup>.

Në plotësim dhe sa i takon Këshillit ekonomik social të Republikës së Maqedonisë, duhet të shënohet se është krijuar përmes një kontrate mes Qeverisë dhe përfaqësuesve të unioneve të sindikatave dhe përfaqësuesve të shoqatave të punonjësve në territorin e Republikës së Maqedonisë, i cili i përcakton dhe realizon aktivitetet e harmonizuara në aspekt të mbrojtjes dhe promovimit të drejtave ekonomike dhe sociale, të cilat janë në interes të punëtorëve dhe punëdhënësve; ndërmarrjen e politikave të harmonizuara ekonomike, zhvillimore dhe sociale, të cilat stimulojnë dialog social dhe nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve kolektive, si dhe harmonizimi i tyre me masat e politikave ekonomike, zhvillimore dhe sociale".

30. Siqë është nënshkruar mes Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Konfederatës së sindikatave të pavarura, më 16 shkurt 2005, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", Nr. 62/05)

31. Në plotësim, aktualisht ka 17 marrëveshje kolektive për degë të ndryshme të cilat i përcaktojnë çështjet më kryesore lidhur me marrëdhëniet e punës.

### Ligji për mbrojtje sociale:

E përcakton mbrojtjen sociale si një sistem të masave, aktiviteteve dhe politikave të cilat kanë për qëllim që ti parandalojnë dhe tejkalojnë rreziqet kryesore sociale të ballafaquara nga qytetari gjatë jetës së tij/saj, ulje të varfërisë dhe ç'kycjes sociale dhe përfundimin e kapacitetit të qytetarit për vetëmbrojtje. Në këtë aspekt, e përcakton (për shembull) nocionin e rrezikut social i cili (mes tjerave) përfshin:

- Rreziqet e ndërlidhura me shëndetin,
- Rreziqet e ndërlidhura me plakjen,
- Rreziqet e ndërlidhura me familjet me një prind,
- Rreziqet e ndërlidhura me punësimin,
- Rreziqet e ndërlidhura me varfërinë dhe
- Rreziqet e tjera të ç'kycjes sociale.

Më tej detalisht i përcakton shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale të cilët (në plotësim të qytetarëve maqedonas) gjithashtu mund të jenë edhe të huaj, kërkues të azilit, refugjatë të miratuar dhe personat nën mbrojtje subsidiare, sipas kushteve dhe në mënyra të përcaktuara me ligj.

Sa i takon të më lartës me një fjalë, ky ligj gjithashtu përcakton konceptin tjetër relevant për mbrojtjen sociale, duke e rregulluar në detale mbrojtjen institucionale lidhur me të drejtat e tilla:

- E drejta e shërbimit social për shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale;
- E drejta e asistencës për një individë;
- Asistencë për familje;
- E drejta e kujdesit shtëpiak dhe asistencë për individin dhe familjen;
- E drejta në akomodim ditor dhe të përkohshëm si lloj i asistencës për individin dhe familjen;
- Akomodim në familje birësuese;
- Akomodim në shtëpi të vogël grupore dhe banim i pavarur me përkrahje;

Gjithashtu përcakton të drejtat e asistencës financiare të mbrojtjes sociale përfshirë këtu:

- Asistencë financiare sociale;
- Asistencë financiare permanente;
- Asistencë financiare për një person i cili deri në moshën 18 vjeçare ka pasur statusin e fëmijës pa prindër dhe kujdes prindëror;
- Ndihmë financiare për nënë e cila ka lindur fëmijën e katërt;
- Kompenzim financiar për asistencë dhe kujdes nga person tjetër;
- Asistencë financiare ad-hoc;
- Kompenzim i rrogës për orarin e shkurtuar pune për shkak të përkujdesjes për fëmijë me kufizime intelektuale ose fizike në zhvillim;
- Asistencë financiare për banim social.

### 3.2.2 Korniza ligjore dhe politike për mbrojtje sociale

Teksti kryesor ligjor nga sfera e mbrojtjes sociale është *Ligji për mbrojtje sociale*<sup>32</sup>. Për së afërmi i ndërlidhur me këtë ligj është Ligji për siguri dhe shëndetësi në punë, i cili i përcakton masat e sigurisë dhe shëndetit në punë, detyrat e punëdhënësit dhe të drejtat dhe detyrat e punonjësit në sferën e sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe masat preventive të ndërlidhura me të.

Për të përfunduar, duhet të theksohet se korniza e më lartë legjislative, plotësohet nga një sërë e dokumenteve politike specifike, përfshirë:

- Strategjia kombëtare për punësim -2010,
- Plani kombëtar veprues për punësim 2009-2010 dhe
- Plani operativ për politika aktive për punësim për vitin 2009 dhe 2010.

Këto dokumente drejtpërdrejt lidhen me Programin kombëtar për miratimin e ligjit të BEsë (të revizionuar më 2009) dhe Strategjinë kombëtare për ulje të varfërisë dhe ç'kycjes sociale në Republikën e Maqedonisë.

Teksti ligjor kyç në sferën e mbrojtjes sociale është Ligji për mbrojtje sociale, i cili e përcakton sistemin dhe organizimin e mbrojtjes sociale, të drejtat e ndërlidhura me mbrojtjen sociale, financimin dhe procedurën për ti realizuar të drejtat e mbrojtjes sociale.

Në kontekstin e më lartë, sa u takon dokumenteve kryesore strategjiko-politike, duhet të përmenden (mes tjerave):

- Programi kombëtar për realizim të mbrojtjes sociale për vitin 2010<sup>33</sup> dhe
- Strategjia kombëtare për de-institucionalizim të sistemit të mbrojtjes sociale në Republikën e Maqedonisë (2008-2018) të plotësuar me një Plan operativ për zbatimin e saj.

32. Siqë është botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", Nr. 79/2009.

33. Programi është i disponueshëm në ueb faqen e Ministrisë për punë dhe politikë sociale, [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

### 3.2.3 Korniza ligjore dhe politike për mbrojtje shëndetësore dhe sigurim shëndetësor

#### Ligjet lidhur me mbrojtjen shëndetësore dhe sigurimin shëndetësor:

- Ligji për sigurim shëndetësor
- Ligji për mbrojtje shëndetësore
- Ligji për sigurim pensional dhe për invalidor
- Ligji për sigurim pensional të detyrueshëm plotësisht të financuar
- Ligji për mundësi të barbarta mes grave dhe burrave
- Ligji për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve
- Ligji për regjistrimet në shëndetësi
- Ligji për mbrojtjen nga duhani
- Ligji për sigurinë në dhënien e gjakut
- Ligji për barna dhe paisje ndihmëse mjekësore
- Ligji për siguri të ushqimit dhe produkteve të cilat janë në kontakt me ushqimin
- Ligji për prekursor, etj.

#### Korniza e më lartë ligjore gjithashtu plotësohet nga një sërë e dokumenteve për veprim politik, përfshirë:

- Programin për sigurim të plotë shëndetësor dhe mbrojtje shëndetësore të qytetarëve të cilët nuk kanë sigurim shëndetësor për 2010 në Republikën e Maqedonisë,
- Strategjia shëndetësore e Republikës së Maqedonisë deri më vitin 2020,
- Strategjia kombëtare për përmirësimin e shëndetit mental në Republikën e Maqedonisë 2005-2012,
- Programi për mbrojtje shëndetësore të personave me pengesa mentale në Republikën e Maqedonisë për vitin 2010,
- Programi për mbrojtje aktive shëndetësore për nënat dhe fëmijët në 2010,
- Strategjia kombëtare për shëndetin e adoleshentëve 2008-2015,
- Strategjia për kontrollimin e tuberkulozës 2008-2012,
- Program për një shëndet për të gjithë dhe arsim permanent mjekësor për disa grupe të popullatës dhe disa sëmundjeve të qytetarëve të cilët nuk kanë sigurim shëndetësor për vitin 2009 në Republikën e Maqedonisë,
- Program për detektim, diagnozë dhe trajtim të hershëm të kancerit të gjirit,
- Strategjia për parandalim të sëmundjeve orale tek fëmijët prej 0-14 vjeç në Republikën e Maqedonisë,
- Program për mbrojtje shëndetësore të personave me sëmundje të varësisë.

Në plotësim të rregullave të lartpërmendura kushtetuese, teksti kryesor ligjor në sferat e më lartë e përfshin Ligjin për sigurim shëndetësor dhe Ligjin për mbrojtje shëndetësore.

Sa i takon Ligjit për sigurim shëndetësor, duhet të theksohet se ai e përcakton sigurimin shëndetësor të qytetarëve, të drejtat dhe obligimet nga sigurimi shëndetësor, si dhe mënyrën e zbatimit të sigurimit shëndetësor.

Sigurimi shëndetësor është i detyrueshëm dhe vullnetarë.

Sa i takon atij të detyrueshëm, Ligji detalisht i përvijon personat e siguruar dhe anëtarët e familjeve të tyre, duke i përcaktuar të drejtat specifike të shërbimeve bazike shëndetësore në mbrojtjen shëndetësore primare dhe mbrojtjen shëndetësore speciale-konsultative; gjithashtu i përcakton edhe shërbimet shëndetësore të cilat nuk mbulohen nga sigurimi shëndetësor i detyrueshëm, duke i përcaktuar të drejtat e kompensimeve financiare specifike, siqë është kompensimi i rrogës gjatë blokimit të përkohëshëm të aftësisë punuese për shkak të sëmundjes ose lëndimit, si dhe gjatë mungesës nga puna për shkak të shtatëzaniës, lindjes ose amësimit dhe të ngjajshme. Ligji gjithashtu hollësisht i rregullon të gjitha aspektet relevante të sigurimit shëndetësor vullnetarë.

Sa i takon Ligjit për mbrojtje shëndetësore, duhet të merret parasysh se për së afërmi është i ndërlidhur me ligjin e lartpërmendur, dhe parë nga ky aspekt, mund të theksohet (gjë tepër e rëndësishme) se me ndryshimet e fundit të këtij Ligji, të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë ju mundësohet një mbrojtje sociale me pako të plotë të shërbimeve sociale.

Më saktësisht, Qeveria, përmes Buxhetit në Fondin për sigurim shëndetësor, mundëson sigurim gjithashtu edhe për ato të cilët deri tani nuk kanë qenë të siguruar në asnjë bazë.

Akti për mbrojtje të kujdesit shëndetësor u amendua (mars 2004) për ta mundësuar privatizimin e disa sektoreve për kujdes shëndetësor dhe të sektorit të farmacisë dhe në fund, sipas amandmanit në vitin 2005, ky akt lejon privatizimin e kujdesit shëndetësor primar.

Në këtë aspekt, duhet të përmendet se si rezultat të ndryshimeve të këtij Ligji (nga 2009), institucionet ekzistuese për mbrojtje shëndetësore janë transformuar në institute publike shëndetësore të Republikës së Maqedonisë.

**Dokumente të tjera për veprim politik:**

- Plani veprues për ushqim dhe të ushqyerit (2009-2014),
- Strategjia për barna (2010),
- Strategjia për uljen e pasojave të dëmshme nga keqpërdorimi i alkoolit në Republikën e Maqedonisë,
- Plani kombëtar për zhvillim i Republikës së Maqedonisë (2008-2013),
- Strategjia kombëtare për HIV/AIDS 2007-2011,
- Plani veprues kombëtar për barazi gjinore 2007-2012,
- Planet operative për zbatimin e tij për vitet e periudhës 2008, 2009 dhe 2010,
- Strategjia kombëtare për zhvillim demografik të Republikës së Maqedonisë 2008-2015.

**3.2.4 Legjislacioni i sigurimit pensional dhe invalidor**

Të drejtat të cilat burojnë nga sigurimi pensional dhe invalidor i përfshijnë të ardhshmet:

- e drejta për pension pleqëror
- e drejta për pension invalidor
- e drejta për realokimi në tjetër vend pune të përshtatshëm
- e drejta për punësim adekuat
- e drejta për rikualifikim ose kualifikim më të lartë
- e drejta për kompenzim adekuat financiar
- e drejta për pension familjar
- e drejta për kompenzim mujor për dëm fizik dhe
- e drejta për shumë minimale të pensionit

**3.2.5 Korniza ligjore dhe politike lidhur me çështjet gjinore**

*Ligji për mundësi të barabarta mes grave dhe burrave, i përcakton masat bazike dhe të posaçme për krijimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, kompetencat, detyrat dhe obligimet e palëve përgjegjëse për të mundësuar mundësi të barabarta, procedurën për përcaktimin e trajtimit të pabarabartë mes grave dhe burrave dhe çështjet e ndërlidhura në këtë kontekst.*

Në plotësim të rregullave të më larta kushtetuese, teksti kryesor ligjor në këtë sferë është **Ligji për sigurim pensional dhe invalidor**, i cili e rregullon sigurimin e detyrueshëm pensional për punëtorët në marrëdhënie pune dhe personat fizik të cilët kryejnë aktivitet, bazat e sigurimit pensional të detyrueshëm të financuar nga shteti, si dhe kushtet e posaçme sipas të cilave disa kategori të personave të siguruar i realizojnë të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor.

Sa i takon pensionit për pleqëri, duhet të shënohet se kriteri bazik gjatë përcaktimit të kushteve për realizim të kësaj të drejte është modha dhe ekzistimi i periudhës minimale për pensionim, gjegjësisht: 64 vjet për burrat dhe 62 vjet për gratë dhe së paku 15 vjet vjetërsi pune të siguruar<sup>34</sup>.

Çdo person më i vjetër se 18 vjet mund të bëhet anëtarë i këtij sigurimi.

Këtu duhet të merret parasysh edhe ligji<sup>35</sup>, i cili e rregullon krijimin, operimin dhe zgjerimin e kompanive dhe fondeve pensionale, i përcakton rregullat e menaxhimit dhe mundëson një sistem mbikqyrës dhe rregullues lidhur me të gjitha entitetet e përfshira në administrimin e skemës së detyrueshme të pensionit privat.

Në plotësim të rregulloreve të më larta kushtetuese, si dhe ligjeve specifike, përfshirë edhe ato për punësim, shëndetësi, arsim dhe sfera të tjera (siqë janë përvijuar në nën-sekcionet paraprake të kësaj pjese të botimit), teksti kryesor ligjor për këtë çështje është Ligji për mundësi të barabarta mes grave dhe burrave.

Ka për qëllim që të promovojë parimin e krijimit të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në sferat e politikës, ekonomisë, shoqërisë, arsimit, si dhe në sferat tjera të jetës shoqërore.

34. Të botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", Nr. 7/08.

35. Të botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", Nr. 11/06 dhe 50 të datës 13.04.2010.

### 3.2.6 Korniza ligjore dhe politike e banimit

Objektiva kryesore e Strategjisë kombëtare për banim -2007-2012 është: të arrihet zhvillim afatgjatë i standardizuar dhe harmonizuar i banimit, në pajtim me standardet moderne të jetesës. Për ta arritur këtë, strategjia përcakton prioritetet dhe qëllime specifike. Mes tjerave merret me çështjen e banimit social dhe banimin e grupeve të prekshme të personave (fëmijë pa prindër ose kujdes prindëror, shfrytëzuesit e asistencës sociale dhe permanente, invalidët dhe personat që kanë nevojë nga asistenca dhe kujdesi i personave të tjerë, personat socialisht të rrezikuar të cilët i takojnë bashkësisë rome, prindërit e vetëm me fëmijë të mitur...) dhe në këtë aspekt, e shpreh nevojën (gjë e rëndësishme) për miratimin e ligjit të posaçëm për banimin social.

### 3.2.7 Korniza ligjore dhe politike e lidhur me invaliditetin

*Sa i takon kornizës së ndërlidhur me veprimin politik në këtë sferë duhet të përmendet:*

- Strategjia kombëtare për barazimin e të drejtave të personave me invaliditet 2010-2018 (e revizionuar),
- Strategjia kombëtare për punësim -2010,
- Plani veprues kombëtar për punësim 2009-2010,
- Plani operativ për politika aktive në punësim për vitin 2009 dhe 2010,
- Strategjia për ulje të varfërisë dhe ç'kycjes sociale,
- Programi kombëtar për zhvillim të arsimit në Republikën e Maqedonisë.

### 3.3. Korniza ligjore dhe politike lidhur me mbrojtjen fëmimore

#### Ligjet lidhur me mbrojtjen fëmimore

- Ligji për mbrojtje fëmimore
- Ligji për familje
- Ligji për mbrojtje sociale
- Ligji për arsim fillor
- Ligji për arsim të mesëm
- Ligji për drejtësinë për të miturit

Teksti kryesor ligjor në këtë sferë është Ligji për banim, i cili (në kontekstin e tij lidhur me objektivat kryesore të temës në pyetje) gjithashtu, parasheh mundësinë për dhënien me qira banesa shtetërore për personat socialisht të rrezikuar dhe të pastrehë, në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale.

Ky ligji de facto ka mundësuar bazën ligjore për miratimin e Strategjisë kombëtare për banim -2007-2012 dhe Planin operativ të saj.

Miratimi i mundshëm i këtij ligji të posaçëm është një nga synimet kryesore të përcaktuara në Planin operativ për zbatimin e Strategjisë banuese. Dokumentet paraprake janë për së afërmi të ndërlidhura me dokumentet strategjike, përfshirë edhe Strategjinë kombëtare për ulje të varfërisë, e cila (mes tjerave) përmban një numër të të dhënave statistike relevante dhe tregues specifik në këtë sferë, dhe në të njëjtën kohë i përcakton masat dhe rekomandimet specifike të ndërlidhura me të.

Në plotësim të rregulloreve dhe të drejtave kushtetuese të lartpërmendura, përfshirë edhe ato të marrëdhënieve punuese, sigurisë dhe shëndetit në punë, mbrojtjen sociale, mbrojtjen shëndetësore, të drejtat e pacientit, çështjet e ndërlidhura me banimin, (si dhe ato të përmendura në nën-sekcionin e ardhshëm mbi mbrojtjen e fëmijëve), korniza ligjore për çështjet e invaliditetit i përfshin ligjet e ardhshme specifike:

1. Ligji për punësimin e personave me invaliditet, i cili i rregullon kushtet e posaçme për punësimin dhe punën e personave me invaliditet dhe i përcakton (mes tjerave) masat specifike për përmirësimin e kushteve për punësim dhe punë të personave me invaliditet;
2. Ligji për sigurim pensional dhe invalidor;
3. Ligji mbi gjuhën e simboleve, qëllimi kryesor i të cilit është njohja e gjuhës së simboleve, si mjet i komunikimit mes personave të shurdhër dhe personave të tjerë fizik dhe juridik të cilët kanë nevojë për këtë lloj komunikimi.

E më larta gjithashtu e përfshin çështjen e arsimit të fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore, e cila rregullohet nga Ligji për arsim fillor, Ligji për arsim të mesëm, Ligji për arsim universitar, Ligji për arsimimin e të rriturve dhe Ligji për standardin e nxënësve dhe studentëve.

Në plotësim të rregullave të lartpërmendura kushtetuese, si dhe ligjeve specifike të më larta, përfshirë Ligjin për marrëdhënie pune dhe Ligjin për mbrojtje sociale, akti kryesor ligjor i cili merret me mbrojtjen e fëmijëve është Ligji për mbrojtjen fëmimore.

Ky ligji e rregullon sistemin, organizimin dhe mënyrën e sigurimit të mbrojtjes fëmimore.

Të drejtat fëmimore lidhur me mbrojtjen siqë përcaktohet nga ky ligj përfshijnë (mes tjerave): pagën fëmimore, shtesën speciale, asistencë për paisjet lidhur me foshnjë të sapo lindur dhe participim.

**Korniza ligjore paraprake plotësohet nga një numër i dokumenteve specifike politike për veprim siqë janë: action documents including:**

- Programi kombëtar për zhvillim të mbrojtjes femërore për vitin 2010;
- Program për trajtimin e problemeve të personave socialisht të ç'kycur; grupet synuese që përfshijnë përdoruesit e drogës dhe anëtarët e familjeve të tyre, fëmijët në rrugë dhe prindërit e tyre, viktimat e dhunës familjare dhe personat e pastrehë;
- Program për mbrojtje shëndetësore aktive të nënave dhe fëmijëve në Republikën e Maqedonisë në 2009;
- Strategji për zhvillim demografik në Republikën e Maqedonisë 2008-2015;
- Program kombëtar për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015;
- Protokoll shumëdisciplinor për trajtimin e fëmijëve në rrugë në Republikën e Maqedonisë.

**3.4 Korniza ligjore dhe politike për mbrojtjen e grave**

**Ligji për familjen:**

- Mbron amësinë,
- Performancën e të drejtës prindërore,
- Hyrjen në martesë,
- Të drejtat dhe detyrat e bashkëshortëve,
- Në veçanti trajton çështjen e dhunës familjare.

**Dokumente tjera:**

- Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna familjare 2008-2011,
- Protokoll i uniformuar për veprim në rast të dhunës familjare.

**3.5 Ligje tjera të përzgjedhura në sferat e anti-varfërisë dhe ç'kyçjes sociale**  
**3.5.1 Legjislacioni i anti-diskriminimit**

Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi:

*“mbrojtja nga dhe parandalimi i diskriminimit i intereson të gjitha personat fizik dhe juridik në procesin e realizimit të të drejtave dhe lirive të tyre të garantuara nga Kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë”;*

Ky Ligj duhet të zbatohet nga të gjithë autoritetet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale, personat juridik dhe fizik në sferat e marrëdhënieve të punës, arsim, shkencë dhe sport, sigurim social, përfshirë sferën e mbrojtjes sociale, sigurim shëndetësor dhe mbrojtje shëndetësore, gjyqësi

Në plotësim, ky Ligj parasheh forma të tjera të mbrojtjes femërore përfshirë edhe “kujdesjen për dhe rritjen e fëmijëve të moshës parashkollore, pushim dhe rekreim të fëmijëve dhe të ngjajshme.”

Plotësohet nga Ligji për familje i cili përcakton se, “Republika mundëson mbrojtje speciale për familjen, amësinë, fëmijët e mitur, fëmijët pa prindër dhe fëmijët pa kujdes prindëror”.....;

“Republika do të krijojë dhe sigurojë kushte shkencore, ekonomike dhe sociale për planifikimin e familjes dhe prindërimin e lirë dhe përgjegjës; për ta realizuar të drejtën e tyre për një prindërim të lirë dhe përgjegjës, prindërit janë të detyruar që të sigurojnë kushte optimale për rritjen dhe zhvillimin e shëndoshë të fëmijëve të tyre në familje dhe në shoqëri”.

Në linjë me këtë të fundit, ky Ligj i rregullon të gjitha çështjet relevante lidhur me të drejtat dhe detyrat e barabarta të prindërve kundrejt fëmijëve të tyre, marrëdhëniet e prindërve dhe fëmijëve dhe të drejtat dhe detyrat e tyre në këtë kontekst, ligjin për prindërim etj.

Në plotësim të rregullave të më larta kushtetuese dhe në veçanti të gjitha nën-sekcionet paraprake të kësaj pjese të botimit (posaçërisht lidhur me marrëdhëniet e punës, mbrojtjen sociale dhe shëndetësore dhe ato që kanë të bëjnë me barazinë gjinore), çështja e mbrojtjes së grave gjithashtu trajtohet nga i lartpërmenduri Ligj për familje.

Korniza ligjore paraprake plotësohet nga të gjitha dokumentet politike të lartpërmendura (siqë përmendet në nën-sekcionet paraprake të kësaj pjese të botimit, si dhe ato të përmendura më poshtë).

Në plotësim të rregullave të lartpërmendura kushtetuese dhe në veçanti sa u takon ligjeve të lartpërmendura në këtë aspekt, duhet të theksohet se të gjitha rregullat e posaçme anti-diskriminuese të më larta së shpejti janë përforcuar dhe grumbulluara nga Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi.

Ky Ligj ka për qëllim që ta parandalojë dhe të mbrojë nga diskriminimi, gjatë realizimit të të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ligjet dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare.

Për hir të realizimit të qëllimeve të lartpërmendura, ky Ligj parasheh krijimin e një Komisioni, dhe në këtë aspekt gjithashtu e rregullon procedurën për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi përpara këtij komisioni.

Në fund, e rregullon mbrojtjen gjyqësore në këtë kontekst.



dhe administratë, banim, qasje në të mira dhe shërbime, anëtarësim dhe veprim në sindikata etj.

### 3.5.2 Dhënia e ndihmës juridike falas

#### Ligji për ndihmë juridike falas:

E drejta e ndihmës juridike falas ju mundësohet të gjithë qytetarëve të Maqedonisë të cilët kanë banim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë, gjegjësisht, personat të cilët janë shfrytëzues të ndihmës sociale, shfrytëzuesit e të drejtës së kompenzimit për invaliditet, të cilët nuk kanë të ardhura tjera, siqë janë fitimet ose të ardhurat nga prona, shfrytëzuesit e pensionit minimal të cilët jetojnë në bashkësi familjare me dy ose më tepër persona të mirëmbajtur prej tyre, dhe familjet ose prindi i vetëm me një ose më tepër fëmijë të mitur të cilët kanë të drejtë të marrin kompenzim fëmisor, gjithashtu edhe persona të tjerë siqë është personi me të drejtë të pranuar të azilit, person i zhvendosur brenda vendit, i huaj, etj., në pajtim me këtë Ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ndërlidhura me të.

### 3.6 Korniza ligjore dhe politike për mbrojtjen e kategorive tjera të personave të prekshëm

#### 3.6.1 Të huajt dhe refugjatët

#### Korniza ligjore dhe politike për mbrojtjen e të huajve dhe refugjatëve:

- Ligji për të huajt
- Ligji për punësimin dhe punën e të huajve
- Ligji për mbrojtje azile dhe të përkohshme

Kjo kornizë ligjore e zgjeruar plotësohet nga Strategjia për integrim të refugjatëve dhe të huajve në Republikën e Maqedonisë 2008-2015, e cila është dokumenti strategjik për veprim politik më gjithëpërfshirës në sferën e më lartë.

Kjo është një nga mjetet shumë të rëndësishme për tejkalimin e ç'kryes sociale dhe në këtë aspekt teksti ligjor kryesor është **Ligji për ndihmë juridike falas**<sup>36</sup>.

E rregullon të drejtën e ndihmës juridike falas, procedurën për realizimin e kësaj të drejte, shfrytëzuesit e saj, kushtet dhe mënyrat për realizim e kësaj të drejte, dhënësit e kësaj ndihme dhe aspektet e ngjajshme.

E drejta e ndihmës juridike falas ju mundësohet personave të cilët për shkak të statusit të tyre material nuk do të mund ti gëzojnë të drejtat e garantuara me Kushtetutën dhe ligjin, pa mos e rrezikuar mirëmbajtjen e tyre dhe mirëmbajtjen e anëtarëve të familjeve të tyre me të cilët jetojnë së bashku në një shtëpi të përbashkët.

Në këtë kontekst gjithashtu duhet të shtohet **Ligji për Avokatin e Popullit**<sup>37</sup>, i cili i përcakton të gjitha aspektet e intencionit Avokat i Popullit, si organi i Republikës së Maqedonisë i cili i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve atëherë kur të drejtat e tyre janë shkelur.

Në plotësim të rregullave të më larta kushtetuese, si dhe ligjeve specifike të përvijuara në nën-sekcionin paraprak në këtë pjesë të botimit, korniza ligjore e ndërlidhur me të huajt e përfshin **Ligjin për të huajt**<sup>38</sup>, i cili ligj është teksti kryesor ligjor në këtë sferë.

Ky ligj i përcakton të gjitha të drejtat specifike për të huajt, lidhur me hyrjen dhe qëndrimin e tyre në shtet, në bazë të regjimeve të ndryshme të vizave; i rregullon të gjitha çështjet relevante për të huajt përfshirë edhe qëndrimin e përkohshëm të të huajve për qëllime të punësimit, punës dhe vetëpunësimit, qëndrim të përkohshëm për qëllime të ndjekjes shkollore, studimeve, specializimit, arsimit profesional ose trajnimeve praktike, skemave shkëmbyese, hulumtimit shkencor, trajtimit mjekësor, bashkimin me familjen, leje për qëndrim permanent dhe të ngjajshme.

Në vazhdim ky ligj plotësohet nga **Ligji për punësimin dhe punën e të huajve**<sup>39</sup>, i cili i rregullon kushtet dhe procedurën sipas të cilës të huajt mund të punësohen ose të punojnë në Republikën e Maqedonisë, nëse nuk përcaktohen ndryshe nga ndonjë marrëveshje ndërkombëtare.

Sa u takon refugjatëve në këtë aspekt, duhet të përmendet **Ligji për azil dhe mbrojtje të përkohshme**<sup>40</sup>, i cili detalisht i rregullon të gjitha të drejtat dhe detyrat relevante për të gjitha

36. Të botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", Nr. 161, i datës 20.12.2009.

37. Të botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", Nr. 60/2003.

38. Të botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", Nr. 35/2006, dhe ka hyrë në fuqi më 01.01.2008.

39. Të botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", Nr. 70/2007

40. Të botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", Nr. 19/2009,49/2003 and 66/2007.



### 3.6.2 Mbrojtja e romëve

#### Korniza ligjore dhe politike për mbrojtje të romëve:

Sa i takon mbrojtjes së romëve duhet të theksohet se nuk ka ligj të posaçëm i cili merret ekskluzivisht me këtë çështje, por vlen korniza ligjore e lartpërmendur lidhur me sferat të cilat trajtohen nga të gjitha nën-sekcionet paraprake dhe vijuese në këtë pjesë të botimit. Të gjitha nga dokumentet paraprakisht të përmendura, për së afërmi janë të lidhura me dokumentet e tjera strategjike të përvijuara në nën-sekcionet paraprake në këtë pjesë të botimit, për shkak se të gjitha prej tyre e marrin parasysh gjithashtu edhe gjendejn specifike të popullatës rome.

### 3.6.3 Mbrojtje e personave të moshuar

#### Korniza ligjore dhe politike për mbrojtjen e personave të moshuar:

Ligjet më të rëndësishme në interes të personave të moshuar janë Ligji për mbrojtje sociale dhe Ligji për sigurim pensional dhe invalidor, të cilat janë për së afërmi të ndërlidhura me ato të mbrojtjes shëndetësore, ligjin për familje, marrëdhënie pune, banim dhe të ngjajshme.

Kjo gjithashtu e përfshin Ligjin për arsimimin e personave të moshuar (2008).

### 3.6.4 Korniza për pakicat etnike

#### Korniza ligjore dhe politike lidhur me mbrojtjen e pakicave etnike:

- Ligji për përdorimin e gjuhës e cila flitet nga më së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në njësitë e vetëqeverisjes së saj;
- Ligji për Komitetin për marrëdhëniet mes komuniteteve;
- Ligji për promovimin dhe mbrojtjen e personave të cilët u takojnë komuniteteve që përfaqësojnë më pak se 20% të popullatës në Republikën e Maqedonisë ,
- Ligji për nëpunësit shtetëror.

kategoritë e personave të trajtuar nga ai, përfshirë edhe ato të refugjatëve të njohur dhe të tjerë<sup>41</sup>.

Ka një sërë të strategjive të posaçme dhe planeve vepruese të cilat kanë buruar nga Dekada e romëve, përfshirë:

- Strategjia e romëve e Republikës së Maqedonisë
- Plani veprues kombëtar për arsim (i plotësuar nga Plani operativ për arsim)
- Plani veprues kombëtar për shëndetësi (i plotësuar nga Plani operativ për shëndetësi)
- Plani veprues kombëtar për punësim (i plotësuar nga Plani operativ për punësim)
- Plani veprues kombëtar për banim (i plotësuar nga Plani operativ për banim)
- Plani veprues për gratë rome (i shoqëruar nga Korniza logjike për gratë rome dhe Plani operativ për vitin 2010)
- "Revizioni i planeve vepruese kombëtare të Dekadës për përfshirjen e romëve 2005-2010"
- Strategjia e romëve e Republikës së Maqedonisë 2009-2011,
- Plani operativ për programe dhe masa aktive për punësim për vitin 2010<sup>42</sup>.

Si në rastin e kategorive tjera, njëjtë edhe këtu nuk ka ligj të posaçëm vendor i cili merret në veçanti me këtë çështje. Kështu që, në plotësim të rregullave kushtetuese të më larta, në këtë aspekt duhet të merren në konsiderim të gjitha ligjet specifike të përvijuara në nën-sekcionet paraprake në këtë pjesë të botimi.

Korniza ligjore paraprake plotësohet nga miratimi i fundit i **Strategjisë kombëtare për personat e moshuar 2010-2012**, (qershor 2010), e cila strategji është dokumenti politik bazik i shtetit i cili i identifikon sferat prioritare në aspekt të përforcimit të kualitetit dhe kuanitetit të jetës së personave të moshuar. Strategjia përcakton masa specifike të qëlluara për ta përmirësuar sistemin e mbrojtjes sociale për personat e moshuar, krijim dhe përforcim të mbrojtjes shëndetësore të personave të moshuar, integrim të personave të moshuar në jetën shoqërore dhe në tregun e punës dhe të ngjajshme. Rrjedhimisht, ky dokument gjithashtu është për së afërmi i ndërlidhur me të gjitha dokumentet politike kombëtare të më larta

Në plotësim të rregullave të lartpërmendura kushtetuese, së pari duhet të përmendet Marrëveshja kornizë e Ohrit, e cila është garancion kryesor i të drejtave të bashkësive jo shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Sa u takon dokumenteve politike në kontekstin e më lartë, dhe në plotësim të gjitha atyre më të përmendura, të cilat janë drejtpërdrejtë relevante për këtë çështje, këtu duhet të merret parasyshë Strategjia për përfaqësim të barabartë të bashkësive

41. Kini parasyshë se korniza legjislativë më lartë plotësohet nga ligje të tjera vendore, përfshirë Ligjin për nënshtetësi, Ligjin për tubime publike, Ligjin për shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet, Ligji për pronësinë dhe të drejtat e tjera të lidhura me pronën dhe Ligji për mbrojtjen feminare.

42. Kini parasyshë se status quo situata aktuale e popullatës rome në shtet përshkruhet (mes tjerave) nga Raporti i Dekadës për përfshirje të romëve, të përgatitur nga Skuadra maqedonase për mbikqyrje të Dekadës (2010).

### 3.7 Roli i zhvillimit regjional në anti-varfëri dhe ç'kycje sociale

#### Rregullimi ligjor:

- Ligji për zhvillimet e harmonizuara regjionale
- Strategjia kombëtare për zhvillim regjional të Republikës së Maqedonisë
- Strategjia për ulje të varfërisë dhe ç'kycjes sociale

### 3.8 Korniza e ndërlidhur me komunikimin elektronik

#### Rregulli ligjor:

- Ligji për komunikim elektronik
- Dokumente politike në sferën e njejtë:**
- Strategjia kombëtare për e-Qeveri 2010-2012;
  - Programi Qeveritar (2006-2010);
  - Dokumenti politik kombëtar për një shoqëri informatike;
  - Strategjia kombëtare & plani veprues për zhvillim të shoqërisë informatike;
  - Strategjia kombëtare për zhvillimin e komunikimit elektronik me teknologjitë informuese (NSDECIT).

#### SHËNIM

Në kontekstin e këtij nën-sekcionit, si dhe për së afërmi të ndërlidhur me të, duhet të merren në konsiderim kategoritë e tjera të posaçme të personave të prekshëm, përfshirë këtu personat e zhvendosur brenda vendit, personat pa strehim, personat e papunësuar për shkak të falimentimit të kompanive, ç'kyçja e ndërlidhur me arsimin dhe transportin etj., të gjithë nga të cilët duhet të shihen në kontekst më të gjërë të çështjeve specifike të trajtuara në të gjithë sekcionin 3 të këtij botimi.

etnike në sektorin publik<sup>43</sup> dhe Strategjia për zhvillim të aktivitetit transmetues në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2007-2012 dhe Plani veprues për zbatimin e saj.

Për të përfunduar në kontekstin e më lartë në veçanti duhet të theksohet se, është Konventa kornizë për mbrojtje të pakicave kombëtare e Këshillit të Evropës, e cila është pjesë integruese e legjislacionit vendor në këtë sferë dhe e cila mundëson një kontribut të rëndësishëm në progresin e mëtutjeshëm të shtetit lidhur me këto çështje<sup>44</sup>.

Gjerësisht pranohet se kjo çështje është një nga aspektet kryesore të secilës politike për anti-varfëri dhe ç'kycje sociale. Parë nga ky këndvështrim, në rastin e Republikës së Maqedonisë, teksti kryesor ligjor është **Ligji për zhvillim regjional të harmonizuar**<sup>45</sup>.

Ky Ligj i rregullon qëllimet, parimet dhe bartësit e politikës për iniciimin e një zhvillim regjional të harmonizuar, planifikimin e zhvillimit regjional në Republikën e Maqedonisë, si edhe të gjitha çështjet relevante në këtë kontekst<sup>46</sup>. Ky ligj gjithashtu, ka qenë bazë për miratimin e *Strategjisë kombëtare për zhvillim regjional të Republikës së Maqedonisë*<sup>47</sup>, e cila është baza për veprim politik në këtë kontekst. Kjo strategji për së afërmi lidhet me të gjitha dokumentet strategjike të lartpërmendura, përfshirë Strategjinë për ulje të varfërisë dhe ç'kycjes sociale, e cila përmban një pjesë të posaçme e cila merret me komunitetet rurale në sferat që kanë të bëjnë me çështjet e banimit.

Teksti kryesor ligjor në këtë sferë është **Ligji për komunikim elektronik**<sup>48</sup>, i cili (mes tjerave) i rregullon kushtet dhe mënyrat e performimit të aktivitetit në sferën e komunikimit elektronik, përfshirë edhe qasjen në këto komunikime.

Është qëlluar për të mundësuar (mes tjerave) kushte për realizimin e nevojave për shërbime komunikuese, mbrojtje të interesave të shfrytëzuesve të këtyre shërbimeve dhe e përcakton zhvillimin ekonomik të shtetit.

43. Në këtë kontekst shënoni se Ligji për nëpunësit shtetëror, është ai i cili i themelon detyrat e organeve publike për ti zbatuar synimet e tyre vjetore të rekrutimit për komunitetet jo-shumicë.

44. Shihni Rezolutën për Maqedoninë, të Komitetit të ministrave të KiE (e cila përmban rekomandime specifike për Maqedoninë), të miratuar pas rrethit të dytë vëzhgues në vend. Një vëzhgim i cili është bërë në bazë të kësaj Konvente. Në këtë aspekt, gjithashtu shihni Raportin e tretë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, të përpiluar sipas kësaj Konvente dhe të përgatitur në linjë me drejtimet dhe rekomandimet paraprake të Komitetit të ministrave, 11 mars 2010, Ministria për punë të jashtme, www.mfa.gov

45. Të botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", Nr. 63/2007.

46. Kini parasyshtë se për qëllime të realizimit të objektivave kyçe të Ligjit, ka një Këshill të posaçëm për zhvillim regjional të harmonizuar të Republikës së Maqedonisë.

47. Të botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", Nr. 119 i datës 30.09.2009.

48. Të botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", Nr. 83/2010, 98/20008, 14/2007 dhe 13/2005. Dokumentet e përmendura më poshtë mund të gjenden në: www.mio.gov.mk

Këto çështje janë gjithashtu të përvijuara dhe/ose të prezantuara në dokumentet kombëtare strategjike të më larta, përfshirë edhe Strategjinë për ulje të varfërisë dhe ç'kyçjes sociale.

### 3.9. Mbikqyrja e obligimeve të Maqedonisë lidhur me ligjin ndërkombëtar për të drejta njerëzore

#### 3.9.1 Mbikqyrja e obligimeve të Maqedonisë lidhur me instrumentet e përzgjedhura ligjore të KB

- Komiteti për të drejta fëmijore (KDF) rekomandon (mes tjerave) që pala shtetërore të ratifikojë traktatet kryesore për të drejta njerëzore të Kombeve të Bashkuara, si dhe protokollet e atyre e të cilave nuk është ende pjesë, gjegjësisht: Konventën për të drejta e personave me invaliditet dhe protokollet opcionale të saj, Konventën ndërkombëtare për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja e detyrueshme, të cilën Republika e Maqedonisë e ka nënshkruar, si dhe Konventën ndërkombëtare për mbrojtjen e të gjithë punëtorëve migrant dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Kjo e fundit gjithashtu e përfshin Kartën për gjuhët regjionale ose të pakicave të KiE.
- Për dallim të instrumenteve ligjore të KB, duhet të theksohet se Republika e Maqedonisë ende nuk është palë kontraktuese e Konventës për mbrojtjen e të drejtave të gjithë punëtorëve migrant dhe anëtarëve të familjeve të tyre dhe Konventën për të drejta e personave me invaliditet.
- Për të përfunduar, në kontekst të anëtarësimit të Maqedonisë në KB, duhet në veçanti të merret në konsiderim zotimi i shtetit drejtë zbatimit të Objektiva të zhvillimit të mijëvjeçarit të KB (OZHM). Në këtë aspekt, siqë është cekur më poshtë, përpjekjet e shtetit s'janë asgjë përveç zbatim i instrumenteve ligjore të lartpërmendura (dhe të tjerat të KB), si dhe ato të miratuara nën anëtarësimin e saj në organizatat tjera ndërkombëtare (siqë është theksuar më lartë).

Ligji është baza ligjore e Agjencisë për komunikim elektronik, të krijuar (si organ i pavarur rregullativ) për qëllimet e këtij ligji.

Sa i takon sistemit të KB, duhet të rikujtohet se Republika e Maqedonisë është palë kontraktuese e instrumenteve të ardhshmeve (mes tjerave) për të drejta njerëzore:

- **Konventa ndërkombëtare për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore**<sup>49</sup>: Sa i takon këtij instrumenti të KB, dhe çdo pale shtetërore të ndërlidhur me të, Republika e Maqedonisë është gjithashtu e detyruar që rregullisht të dorëzojë raport Komitetit për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore (KDESK) lidhur me zbatimin e këtyre të drejtave.
- **Konventa për eliminimi e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave** dhe Protokolli opcional i kësaj Konvente (KEDNG Konventa)<sup>50</sup>, zbatimi i të cilës mbikqyret nga Komiteti për eliminimi e diskriminimit ndaj grave (KEDNG Komiteti). Raporti i fundit i KEDNG Komitetit për Maqedoninë u dorëzua më 2006. Republika e Maqedonisë ka miratuar edhe instrumente të tjera relevante të KB, të cilat janë ngushtë të lidhura me konventën paraprakë të KB. Kjo e fundit e përfshin (mes tjerave) Konventën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar të KB dhe Protokollin e saj për shtypje dhe sanksionim të trafikimit njerëzor, në veçanti të grave dhe fëmijëve, Konventa e KB për torturë, Konventa për eliminimi të diskriminimit racor etj.
- **Konventa për të drejta fëmijore**<sup>51</sup> dhe dy protokollet opcionale të Konventës, lidhur me *përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura*<sup>52</sup> dhe *për shitjen e fëmijëve, prostitucionin fëmijor dhe pornografi fëmijore*<sup>53</sup>. Zbatimi i këtyre instrumenteve nga palët e tyre kontraktuese vëzhgohet nga Komiteti për të drejta fëmijore (KDF), i cili kontrollon çdo raport dhe i'a shpreh brengat dhe rekomandimet e tij shtetit palë, në formë të "vëzhgime konkluduese". Komiteti e shqyrtoi raportin e dytë periodik të Maqedonisë më 27 maj 2010<sup>54</sup> dhe i miratoi *vëzhgimet konkluduese*<sup>55</sup>, të cilat përmbajnë një listë të gjatë të vërejtjeve specifike në sferën e mbrojtjes fëmijore në vend, si dhe rekomandime specifike të ndërlidhura me të.

49. Është ratifikuar nga Republika e Maqedonisë më 18.01.1994.

50. Republika e Maqedonisë e ratifikoi KEDNG më 18 janar, 1994; Protokollin opcional të Konventës së njejtë e ratifikoi më 17.10.2003; nuk ka bërë kurrëfar rezervimesh në këto traktate. UN Doc. CEDAW/C/MKD/CO/3, §11. <http://daccess-dds-ny.un.org/doc>

51. E ratifikuar nga Republika e Maqedonisë më 02.12.1993.

52. E ratifikuar nga Republika e Maqedonisë më 12.01.2004.

53. E ratifikuar nga Republika e Maqedonisë më 17.10.2003.

54. Shihni CRC/C/SR.1508, CRC/C/SR.1510 dhe CRC/C/SR.1 512;

55. CRC/C/MKD/CO/2

### 3.9.2 Mbikqyrja e obligimeve të Maqedonisë lidhur me instrumentet ligjore të ONP

Sa i takon ONP duhet të theksohet se Republika e Maqedonisë ka ratifikuar një numër të madh të instrumenteve ligjore të kësaj organizate.

Megjithatë, në këtë aspekt, është e rëndësishme që të merren në konsiderim komentet e ardhshme të bëra nga Komiteti i ekspertëve të ONP lidhur me aplikimin e konventave dhe rekomandimeve nga ana e Republikës së Maqedonisë. Gjegjësisht, raporti i tij (2010) thotë siqë vijon:

*"Dështim serioz sa i takon nënshtrimit. Komiteti me keqardhjen shënon se Qeveria nuk e ka dorëzuar informatën lidhur me nënshkrimin e autoriteteve kompetente sa u takon instrumenteve të miratuara në Konferencën e 12 sesioneve të mbajtura mes 1996 dhe 2007 (Sesioni 83, 84, 85, 86, 88, 89, 90, 91, 92, 94, 95 dhe 96). Komiteti e inkurajon Qeverinë që të ndërmarra masa pa vonesë për ti dorëzuar dokumentet në pritje deri tek autoritetet kompetente".*

Këto brenga janë të reflektuara dhe për së afërmi të ndërlidhura me obligimet e Maqedonisë lidhur me konventat e Këshillit të Evropës, në veçanti me Kartën sociale, siqë është cekur në nën-sekcionin vijues<sup>56</sup>.

### 3.9.3 Mbikqyrja e Maqedonisë lidhur me obligimet që burojnë nga Karta sociale evropiane të KiE

Për dallim të Kartës sociale evropiane (të revizionuar), Republika e Maqedonisë është palë kontraktuese e këtij dokumenti shumë të rëndësishëm ligjor të Këshillit të Evropës<sup>57</sup>.

Parë nga perspektiva e raportit të fundit mbikqyrës të Komitetit evropian për të drejta sociale (KEDS) lidhur me Maqedoninë, duhet të theksohet se ka të bëjë me zbatimin e neneve të Kartës të cilat i takojnë grupit tematik të "shëndetësisë, sigurimit social dhe mbrojtjes sociale, që janë Neni 3 për kushte të sigurta dhe të shëndosha pune, Neni 11 për të drejtën e mbrojtjes së shëndetit, Neni 12 për të drejtën e sigurimit social, Neni 13 për të drejtën e asistencës sociale dhe mjekësore, Neni 14 për të drejtën e beneficionit nga shërbimet e mirëqenies sociale dhe Neni 4 i Protokollit shtesë lidhur me të drejtën e personave të moshuar në mbrojtje sociale.

Në kontekstin e më lartë, konkludimet e Komitetit evropian të Kartës sociale lidhur me Maqedoninë kanë të bëjnë me 11 situata dhe përmbajnë 3 raste të zbatimit të rregullave (Neni 11&1, 13&2 dhe 13&3) dhe 2 raste të mosrespektimit të rregullave (Nenet 12&1 dhe 13&1)<sup>58</sup>.

Në këtë kontekst, duhet të theksohet se Komiteti e shqyrton respektimin e një numri të rekomandimeve të posaçme të KiE (siqë është përmendur në konkludimet e Komitetit), si dhe raportet e miratuara në përputhje me konventat e KiE të cilat i trajtojnë këto çështje, siqë është ajo e Komitetit evropian për parandalim të torturës dhe trajtimit johuman dhe degradues ose dënimit (CPT).

Për të përfunduar, duhet të shënohet se raporti i ardhshëm kombëtar i Maqedonisë do të merret me rregullat e neneve të miratuara të cilat i takojnë grupit të tretë tematik (p.sh. "Të drejtat e punës").

### 3.9.4 Obligimet e Maqedonisë lidhur me statusin e shtetit kandidat për anëtarësim në BE

Në këtë aspekt së pari duhet të theksohet se në bazë të kornizës të procesit zgjerues, çdo shtet kandidat ose kandidat potencial duhet të jetë i zotuar për ta pranuar acqui-n e Komunitetit në çdo sferë relevante, përfshirë edhe ato të ndërlidhura me anti-varfërinë dhe përfshirjen sociale.

Në rastin e Republikës së Maqedonisë duhet të rikujtohet se BEja i udhëzoi autoritetet maqedonase lidhur me prioritetet reformuese përmes Partneritetit qasës më shkurt 2008.

Ky instrument identifikon tetë prioritate kyçe për progres në procesin e pranimit të shtetit dhe progresi i këtyre prioriteteve reformuese inkurajohet dhe vëzhgohet përmes organeve të krijuara përmes Marrëveshjes për stabilizim dhe asocim (MSA).

Lidhur me marrëveshjen paraprake, Qeveria maqedonase ka miratuar të lartpërmendurin Program kombëtar për përputhjen e ligjit kombëtar me atë të BEsë dhe në këtë aspekt në veçanti, duhet të merret në konsiderim pjesa e tij lidhur me Kapitullin 02 (e cili merret me "Lëvizjen e lirë të punëtorëve"). Më saktësisht, ka të bëjë me dokumentet politike

56. Për hir të fitimit të pikurës më të mirë lidhur me vlerën e shtuar të ONP në sferat e trajtuara në këtë botim shihni shtojcën 1 (të bashkangjitur në këtë botim) e cila jep një Listë të instrumenteve ligjore të ONP të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë.

57. Karta sociale evropiane u ratifikua nga Republika e Maqedonisë më 31 mars 2005.

58. Konkludimet e Komitetit XIX-2 (2009), më janar 2010, janë shpallur në [www.coe.int/socialcharter](http://www.coe.int/socialcharter)

kryesore vendore të cilat e udhëheqin procesin e harmonizimit të legjislacionit maqedonas me atë të BEsë në sferat e punës, punësimit, përfshirjes sociale, mbrojtjes sociale, dialogut social, sigurisë dhe shëndetit në punë, anti-diskriminimin dhe trajtimin e barbartë të grave dhe burrave.

Lidhur me prapavijën e shkurtër më lartë, duhet të nënvizohet se për dallim të miratimit të instrumenteve kryesore ligjore të organizatave tjera ndërqeveritare të lartpërmendura (p.sh. KB, ONP, KiE etj.) nga ana e Republikës së Maqedonisë, miratimi i acquis së BEsë nuk bëhet përmes miratimit të ligjit të posaçëm vendor, por ai inkorporohet në rregullin individual kombëtar i cili merret me çështjet relevante të cilat i trajtojnë ato acquis.

Është Komisioni Evropian, ai i cili i vlerëson prioritetet kyçe të më larta si bençmarks në të ashtuquajturin raport të progresit, i cili i përshkruan relacionet mes Republikës së Maqedonisë dhe BEsë dhe në të njëjtën kohë e analizon gjendjen në Republikën e Maqedonisë në aspekt të kriterëve politike dhe ekonomike për anëtarësim dhe e shqyrton kapacitetin shtetëror për ti ndërmarrë obligimet e anëtarësimit, gjegjësisht ligjet dhe politikat e BEsë. Ky progres matet në bazë të vendimeve të sjellura, legjislacionit të miratuar dhe masave të zbatuara.

Në këtë aspekt duhet të merret në konsiderim Raporti i fundit i BEsë për Progresin e Maqedonisë (2009), në veçanti ajo e cila përmbahet në të lidhur me trajtimin e "të drejtave ekonomike dhe sociale", "të drejtat e pakicave, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e pakicave", "drejtësi dhe çështje vendore" dhe të ngjajshme.

## SHËNIM PËRMBYLLËS

Sa i takon nën-sekcionit më lartë dhe shikuar nga perspektiva më e gjërë e anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë në KiE, duhet të theksohet se shteti ende nuk ka ratifikuar Kartën sociale të revizionuar dhe Protokollin për ankesa kolektive të ndërlidhur me të.

E ka ratifikuar vetëm Kartën sociale origjinale dhe në këtë drejtim duhet të theksohet se njëherit që Republika e Maqedonisë do ta ratifikojë Kartën e revizionuar, do të ketë një sërë të obligimeve të reja, të cilat duhet të përmbushen në nivel kombëtar dhe të cilat do të duhet të inkorporohen dhe/ose të merren parasyshtë në mënyrë të përshtatshme gjatë freskimit dhe/ose miratimit të dokumenteve të reja strategjike në sferat relevante.

Në çdo rast, ratifikimi dhe zbatimi i Kartës sociale të revizionuar do të ketë nevojë për një qasje më gjithëpërfshirëse në zbatimin e plotë e të gjitha instrumenteve ligjore të KiE të ratifikuara nga shteti, gjë e cila është në linjë (gjë shumë e rëndësishme) me Planin veprues të Varshavës të KiE.

Prandaj gjatë trajtimit të këtyre çështjeve gjithashtu duhet të merren parasyshtë të gjitha raportet mbikqyrëse lidhur me Maqedoninë, ndërsa kanë të bëjnë me instrumentet e posaçme ligjore të KiE; kjo përfshin jo vetëm KEDNJ, por gjithashtu edhe ato të tjerat siqë është Konventa kornizë për pakicat kombëtare, ajo kundër torturës (CPT), ajo e lidhur me fëmijët, mbrojtje e të dhënave etj<sup>59</sup>.

E fundit gjithashtu përfshin (gjë shumë e rëndësishme) praktikën e lartpërmendur ligjore të GJEDNJ, si dhe atë të krijuar në bazë të mekanizmeve mbikqyrëse të Kartës sociale (si dhe asaj të revizionuar). Me siguri se këtu duhet të theksohet se paralelisht ka një numër të instrumenteve tjera ligjore të KiE, të cilat as janë nënshkruar, as janë ratifikuara nga shteti, temat e të cilave janë relevante për sfidat e ndërlidhura me anti-varfërinë dhe ç'kycjen sociale.

Parë nga perspektiva më e gjërë e anëtarësimit të Maqedonisë në KiE, duhet të merret parasyshtë puna e ndërmarrë nga të gjitha organet tjera kryesore të KiE, siqë është Komisioni evropian kundër racizmit dhe jotolerancës (KERJ), raporti i fundit i të cilit merret me Maqedoninë (qershor 2010) përmban një sërë të rekomandimeve të posaçme për veprim, të cilat duhet të ndërmerren nga shteti lidhur me çështjet specifike, të trajtuara nga ky botim.

E më larta është drejtëpërdrejtë e lidhur me obligimet e Maqedonisë përbrenda sistemit të KB, të cilat më së shumti janë të reflektuara në procesin aktual të zbatimit të OZHM të KB<sup>60</sup> dhe standardet e lartpërmedura të KB për të drejtat njerëzore.

Parë nga perspektiva e statusit aktual të shtetit kandidat të Republikës së Maqedonisë për anëtarësim në BE dhe më saktësisht, nga procesi aktual i përgatitjes shtetërore të Memorandumit të përbashkët për përfshirje sociale, i cili duhet të përgatitet së bashku me BEnë, duhet të rikujtohet se njëherit që ky Memorandum është miratuar, do të jetë më se e nevojshme që shteti të ketë qasje më gjithëpërfshirëse drejt miratimit dhe zbatimit të mëtejshëm të acquits së BE-së në sferat sociale dhe ato për të drejtat njerëzore (siqë është cekur në pjesën e dytë të këtij botimi).

Me këtë të fundit duhet (mes tjerave) të merret parasyshtë praktika ligjore të Gjykatës evropiane për drejtësi në sferat relevante.

Me siguri se në këtë pikë, duhet të theksohet se procesi i integritit të shtetit në BE, në aspektin e më lartë është (dhe ende do të jetë) për së afërmi i ndërlidhur me obligimet e shtetit nga anëtarësimi i plotë të tij në KB (p.sh. sa i takon zbatimin i instrumenteve relevante ligjore dhe OZHM), ONP dhe organizatat tjera ndërqeveritare, siqë janë UNESCO, UNICEF, ONSH, etj), si dhe organizata evropiane, siqë janë KiE, OSBE, etj.

59. Shihni listën e instrumenteve të përzgjedhura ligjore të KiE dhe statusin e tyre ratifikues në Republikën e Maqedonisë, të dhëna në shtojcën 2 të bashkangjitur në këtë botim. Ju lutemi gjithashtu shini listen e plotë të konventave të KiE, e cila mund të gjendet në [www.coe.int/treaties](http://www.coe.int/treaties).

60. Ju lutemi shini dy Raportet për progres të Maqedonisë lidhur me zbatimin e Objektivave të mijëvjeçarit (OZHM) të KB, të disponueshme në [www.undp.org.mk](http://www.undp.org.mk). Të dy raportet e ilustrjnë hollësisht gjendjen aktuale lidhur me çështjet e trajtuara në këtë botim, siqë janë romët, mbrojtja e grave, fëmijët, etj.

## SHTOJCA 1

### LISTA E INSTRUMENTEVE LIGJORE TË ONP TË RATIFIKUARA NGA REPUBLIKA E MAQEDONISË<sup>61</sup>

Konventa	Data e ratifikimit	Statusi
C2 Konventa për papunësimin, 1919	17.11.1991	E ratifikuar
C3 Konventa për mbrojtje të amësisë, 1919	17.11.1991	E ratifikuar
C8 Konventa për dëmshpërblim në rast papunësie (falimentim) 1920	17.11.1991	E ratifikuar
C9 Konventa për vendosjen e marinarëve 1920	17.11.1991	E ratifikuar
C11 Konventa mbi të drejtën e asociimit (agrikulturë), 1921	17.11.1991	E ratifikuar
C12 Konventa për kompenzimin e punëtorit (agrikulturë), 1921	17.11.1991	E ratifikuar
C13 Konventa për cerusën (pikturë), 1921	17.11.1991	E ratifikuar
C14 Konventa për pushim javor (industri), 1921	17.11.1991	E ratifikuar
C16 Konventa për egzaminimin mjekësor të personave të rinj të punësuar si marinarë, 1921	17.11.1991	E ratifikuar
C17 Konventa për dëmshpërblim të punëtorit (aksident), 1925	17.11.1991	E ratifikuar
C18 Konventa për dëmshpërblim të punëtorit (sëmundje në profesion), 1925	17.11.1991	E ratifikuar
C19 Konventa për barazinë gjatë trajtimit (dëmshpërblimi në rast aksidenti), 1925	17.11.1991	E ratifikuar
C22 Konventa e neneve të marrëveshjes së marinarëve, 1926	17.11.1991	E ratifikuar
C23 Konventa për riatdhesim të marinarëve, 1926	17.11.1991	E ratifikuar
C24 Konventa për sigurim në rast sëmundje (industri), 1927	17.11.1991	E ratifikuar
C25 Konventa për sigurim në rast sëmundje (agrikulturë), 1927	17.11.1991	E ratifikuar
C27 Konventa për përcaktimin e peshës (pako të transportuara me anije), 1929	17.11.1991	E ratifikuar

61. Burim: ILOLEX-17.08.2010



<b>Konventa</b>	<b>Data e ratifikimit</b>	<b>Statusi</b>
C29 Konventa për punën e detyruar, 1930	17.11.1991	E ratifikuar
C32 Konventa (e revizionuar) për mbrojtje nga aksidentet (ngarkuesit), 1932	17.11.1991	E ratifikuar
C45 Konventa për punën e nëndheshme (gra), 1935	17.11.1991	E ratifikuar
C48 Konventa për mbrojtjen e të drejtave të pensionit të migrantëve, 1935	17.11.1991	E ratifikuar
C53 Konventa për çertifikimin e kompetencave të oficerëve, 1936	17.11.1991	E ratifikuar
C56 Konventa për sigurim në rast sëmundje (det), 1936	17.11.1991	E ratifikuar
C69 Konventa për çertifikimin e kuzhinierëve të anijeve 1946	17.11.1991	E ratifikuar
C73 Konventa për egzaminime mjekësore (për marinarët), 1946	17.11.1991	E ratifikuar
C74 Konventa për çertifikimin e marinarëve të aftë, 1946	17.11.1991	E ratifikuar
C80 Konventa për revizionimin e neneve përfundimtare, 1946	17.11.1991	E ratifikuar
C81 Konventa për inspektimin e punës, 1947	17.11.1991	E ratifikuar
C87 Konventa për lirinë e asociimit dhe mbrojtje e të drejtës së organizimit, 1948	17.11.1991	E ratifikuar
C88 Konventa për shërbimet e punësimit, 1948	17.11.1991	E ratifikuar
C89 Konventa (e revizionuar) për punë nate (gra), 1948	17.11.1991	E ratifikuar
C90 Konventa (e revizionuar) për punë nate të personave të rinj (industri), 1948	17.11.1991	E ratifikuar
C91 Konventa (e revizionuar) për pushim të paguar (marinarë), 1949	17.11.1991	E ratifikuar
C92 Konventa (e revizionuar) për strehimin të ekipazhit, 1949	17.11.1991	E ratifikuar
C97 Konventa (e revizionuar) për migracionin për punësim, 1949	17.11.1991	E ratifikuar
C98 Konventa për të drejtën e organizimit dhe marrëveshjes kolektive, 1949	17.11.1991	E ratifikuar
C100 Konventa për barazinë e pagesës, 1951	17.11.1991	E ratifikuar
C102 Konventa për sigurim social (standarde minimale), 1952	17.11.1991	E ratifikuar

<b>Konventa</b>	<b>Data e ratifikimit</b>	<b>Statusi</b>
C103 Konventa (e revizionuar) për mbrojtje të amësisë, 1952	17.11.1991	E ratifikuar
C105 Konventa për ndalimin e punës së detyruar, 1957	15.07.2003	E ratifikuar
C106 Konventa për pushim javor (tregtia dhe zyrat), 1957	17.11.1991	E ratifikuar
C109 Konventa (e revizionuar) për pagat, orarin e punës dhe ekuipazhin (det), 1958	17.11.1991	E ratifikuar
C111 Konventa mbi diskriminimin (punësim dhe profesion), 1958	17.11.1991	E ratifikuar
C113 Konventa për egzaminim mjekësor (peshkatarë), 1959	17.11.1991	E ratifikuar
C114 Kontrata për nenet e marrëveshjes së peshkatarit, 1959	17.11.1991	E ratifikuar
C116 Konventa për shqyrtimin e neneve përfundimtare, 1961	17.11.1991	E ratifikuar
C119 Konventa për ruajtjen e maqinerisë, 1963	17.11.1991	E ratifikuar
C121 Konventa për beneficion lidhur me lëndimin në punë, 1964	17.11.1991	E ratifikuar
C122 Konventa për politikën e punësimit, 1964	17.11.1991	E ratifikuar
C126 Konventa për akomodimin e stafit (peshkatarë), 1966	17.11.1991	E ratifikuar
C129 Konventa për inspektionin në punë (agrikulturë), 1969	17.11.1991	E ratifikuar
C131 Konventa për rregullimin e rrogës minimale, 1970	17.11.1991	E ratifikuar
C132 Konventa (e revizionuar) për pushime të paguara, 1970	17.11.1991	E ratifikuar
C135 Konventa për përfaqësuesit e punëtorëve, 1971	17.11.1991	E ratifikuar
C136 Konventa për benzinën, 1971	17.11.1991	E ratifikuar
C138 Konventa për moshën minimale, 1973	17.11.1991	E ratifikuar
C139 Konventa për kancerin e fituar në punë, 1974	17.11.1991	E ratifikuar
C140 Konventa për pushimin e paguar për shkaqe arsimore, 1974	17.11.1991	E ratifikuar
C142 Konventa për zhvillimin e resurseve njerëzore, 1975	17.11.1991	E ratifikuar

<b>Konventa</b>	<b>Data e ratifikimit</b>	<b>Statusi</b>
C143 Konventa për punëtorët migrantë (rregullat plotësuese), 1975	17.11.1991	E ratifikuar
C144 Konventa për konsultimin trepalësh (standardet ndërkombëtare të punës), 1976	08.12.2005	E ratifikuar
C148 Konventa për ambientin punues (ndotja e ajrit, zhurma dhe vibrimet), 1977	17.11.1991	E ratifikuar
C155 Konventa për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, 1981	17.11.1991	E ratifikuar
C156 Konventa për punëtorët me përgjegjësi familjare, 1981	17.11.1991	E ratifikuar
C158 Konventa për përfundim të punësimit, 1982	17.11.1991	E ratifikuar
C159 Konventa për rehabilitim dhe punësim profesional (personat me invaliditet), 1983	17.11.1991	E ratifikuar
C161 Konventa për shërbime të shëndetit në punë, 1985	17.11.1991	E ratifikuar
C162 Konventa për asbestin, 1986	17.11.1991	E ratifikuar
C182 Konventa për format më të këqija të punës femënore, 1999	30.5.2002	E ratifikuar

**LISTA E INSTRUMENTEVE TË PËRZGJEDHURA LIGJORE TË KËSHILLIT TË EVROPËS DHE STATUSI I TYRE RATIFIKUES NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

- \* **Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare** (STE Nr. 157). Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar këtë konventë më 1/2/1998;
- \* **Konventa evropiane për të drejtat fëmimore** (STE Nr. 160). Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar këtë konventë më 1/5/2003;
- \* **Konventa evropiane për statusin legal të punëtorëve migrant** (STE Nr. 093). Republika e Maqedonisë ende nuk e ka nënshkruar këtë konventë;
- \* **Konventa evropiane për ndërmarrjet** (STE Nr. 019). Republika e Maqedonisë ende nuk është palë kontraktuese e këtij instrumenti;
- \* **Konventa evropiane për mbrojtjen sociale të fermerëve** (1974). Ky instrument ligjor ende nuk është miratuar nga Republika e Maqedonisë;
- \* **Konventa kulturore evropiane** (STE Nr. 018). Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar më 24/11/1995;
- \* **Marrëveshja evropiane lidhur me rregulloret e qeverisjes së lëvizshmërisë së personave mes shteteve anëtare të Këshillit të Evropës** (STE Nr. 025). Republika e Maqedonisë ende nuk është palë kontraktuese e këtij instrumenti;
- \* **Marrëveshja për importimin e përkoshëm, pa taksa, të paisjeve mjekësore, kirurgjike dhe laboratorike për përdorim falas në spitalet dhe institucionet e tjera për qëllime të diagnostimit dhe trajtimit** (STE Nr. 033). Republika e Maqedonisë ende nuk është palë kontraktuese e këtij instrumenti;
- \* **Marrëveshja evropiane për shkëmbimin e reagjentëve të grupeve të gjakut** (STE Nr. 039). Republika e Maqedonisë ende nuk është palë kontraktuese e këtij instrumenti;
- \* **Konventa për përpilimin e listës farmaceutike evropiane** (STE Nr. 050). Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar më 1/7/1994;
- \* **Konventa evropiane për birësimin e fëmijëve** (STE Nr. 058). Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar më 16/4/2003;
- \* **Konventa evropiane për statusin legal të fëmijëve të lindur jashtë martesës** (STE Nr. 085). Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar më 1/3/2003;
- \* **Marrëveshja evropiane për transferin e përgjegjësisve për refugjatët** (STE Nr. 107). Republika e Maqedonisë ende nuk është palë kontraktuese e këtij instrumenti;
- \* **Konventa për mbrojtjen e individëve lidhur me procesimin automatik të të dhënave personale** (STE Nr. 108). Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar këtë konventë më 1/7/2006;
- \* **Konventa evropiane për të drejtat fëmimore** (STE Nr. 160); Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar këtë konventë më 1/5/2003;
- \* **Konventa mbi kontaktin lidhur me fëmijët** (STE Nr. 192); Republika e Maqedonisë ende nuk është palë kontraktuese e këtij instrumenti;
- \* **Konventa evropiane për birësimin e fëmijëve** (STE Nr. 058). Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar këtë konventë më 15/01.2003;
- \* **Konventa evropiane për birësimin e fëmijëve** (e revizionuar), (STKE Nr. 202); Republika e Maqedonisë ende nuk është palë kontraktuese e këtij instrumenti;
- \* **Konventa evropiane për riatdhesimin e të miturve** (STE Nr. 071, ende nuk ka hyrë në fuqi);
- \* **Konventa evropiane për parandalim të torturës dhe trajtimit johuman dhe degardues ose dënimit** (STE Nr. 126). Konventa është amendura nga rregulloret e përmbajtura në Protokollin e saj Nr. 1 (STE Nr. 151) dhe Nr. 2 (STE Nr. 152). Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar më 1/10/1997;
- \* **Konventa për pjesëmarrjen e të huajve në jetën publike në nivel lokal** (STE Nr. 144). Republika e Maqedonisë ende nuk është palë kontraktuese e këtij instrumenti;
- \* **Karta për gjuhët regjionale ose të pakicave** (STE Nr. 148). Republika e Maqedonisë vetëm e ka nënshkruar më 25/7/1996;
- \* **Konventa evropiane për nënshtetësinë** (STE Nr. 166). Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar këtë konventë më 1/10/2003;

- \* **Konventa e ligjit penal lidhur me korrupcionin** (STE Nr. 173). Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar këtë konventë më 1/7/2002;
- \* **Konventa e ligjit civil lidhur me korrupcionin** (STE Nr. 174). Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar këtë konventë më 1/11/2003;
- \* **Konventa për krimin kompjuterik** (STE Nr. 185). Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar këtë konventë më 1/1/2005. Kjo gjithashtu i përfshin protokollet e ndërlidhura me të;
- \* **Konventa mbi kontaktin në lidhje me fëmijët** (STE Nr. 192). Republika e Maqedonisë ende nuk është palë kontraktuese e këtij instrumenti;
- \* **Konventa për mbrojtjen e fëmijëve nga eksploatimi seksual dhe keqpërdorimi seksual** (CETS Nr. 201). Republika e Maqedonisë vetëm e ka nënshkruar këtë konventë më 25/10/2007;
- \* **Konventa kundër trafikimit të qenieve njerëzore** (CETS Nr. 197). Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar këtë konventë më 25.05.2009 dhe ka hyrë në fuqi më 01.09.2009 .

### SHTOJCA 3

#### LISTA E MARRËVESHJEVE BILATERALE TË MAQEDONISË NË SFERËN E SIGURIMIT SOCIAL<sup>63</sup>

SHTETI	Të botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë"	Ka hyrë në fuqi më
Austria	Nr.28/97	1.4.1998
Kroacia	Nr.34/97	1.11.1997
Turqia	Nr.7/99	1.7.2000
Sllovenia	Nr.13/99	1.4.2001
Zvicra	Nr.44/2000	1.1.2001
Mbretëria e Danimarkës	Nr.37/2000	/
Republika Federale e Jugosllavisë	Nr.13/02	1.4.2002
Bullgaria	Nr.31/03	1.8.2003
Republika Federale e Gjermanisë	Nr.70/03	1.1.2005
Bosnia dhe Hercegovina	Nr.82/05	1.4.2006
Republika Çeke	Nr.20/06	1/1.2007
Holanda	Nr.20/06	1.4.2007
Romania	Nr.59/06	13.3.2008
Polonia	Nr.27/07	1.7.2007
Luksemburgu	Nr.47/07	1.4.2009
Belgjika	Nr.74/07	1.6.2009
Kanada	Nr.19/2010	/
Australia	Nr.19/2010	/

Lista e më lartë plotësohet nga disa marrëveshje të nënshtruara nga Republika e Maqedonisë përmes suksesionit<sup>64</sup>.

63. Për më tepër informata lidhur me konventat e lartpërmendura dhe ato të tjera të KfE, si dhe për raportet mbikqyrëse të Republikës së Maqedonisë lidhur me këto instrumente, shihni në: <http://conventions.coe.int/Treaty>

64. Burim: Ministria për punë dhe politikë sociale, [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

## BIBLIOGRAFI E PËRZGJEDHUR

### I. Sa i takon pjesës së parë të botimit, kushtuar Këshillit të Evropës, e më larta përfshin (mes tjerave):

- Statutin e organizatës, konventat relevante, rekomandimet dhe dokumentet politike, si dhe praktikën ligjore të Gjykatës për të drejta njerëzore, të gjitha nga të cilat janë të disponueshme në: [www.coe.int](http://www.coe.int);
- Dokumentacionin zyrtar dhe hulumtues në sferën e të drejtave sociale dhe njerëzore, i cili mund të gjenden në [www.coe.int](http://www.coe.int);
- Botime të tjera: "Gjykatat dhe përforcimi i të drejtave sociale dhe kulturore: eksperiencë krahasuese e arsyeshmërisë", Gjenevë: GJND 2008.

### II. Sa i takon pjesës së dytë të botimit, të kushtuar Bashkimit Evropian, e më larta përfshin (mes tjerave):

- Traktatet e BEsë, dokumentet relevante ligjore dhe politike, të qasëshme në: <http://eur-lex.europa.eu>;
- Raporte zyrtare dhe botime të tjera në sferën sociale të cilat mund të gjenden në: [ec.europa.eu/social](http://ec.europa.eu/social);
- Praktika ligjore e Gjykatës së drejtësisë e cila mund të gjendet në: [www.curia.europa.eu](http://www.curia.europa.eu);
- Botime dhe ueb faqe të tjera si:  
i. "Shëndetësia mentale në raportet kombëtare strategjike lidhur me mbrojtjen sociale dhe përfshirjen sociale 2008-2010", Analizë e raporteve kombëtare nga anëtarët e MHE; [www.mhe-sme.org](http://www.mhe-sme.org)  
ii "Plakja e mirë në Evropë: instrumente dhe mjete të disponueshme për vepruesit lokal dhe regjional", tetor 2009.  
iii "Krijim i i treguesve për mbrojtjen, respektimin dhe promovimin e të drejtave feminare në Bashkimin Evropian, mars 2009, të disponueshme në: [www.fra.europa.eu](http://www.fra.europa.eu)  
iv. Rrjeti për përfshirje financiare evropiane –EFIN; [www.fininc.eu](http://www.fininc.eu)  
v. Rrjeti evropian kundër varfërisë, [www.eapn.org](http://www.eapn.org)  
vi. Ueb faqja e Eurofund, [www.eurofound.europa.eu](http://www.eurofound.europa.eu)  
vii. Të drejtat e migrantëve të padokumentuar në shëndetësi dhe arsim në Evropë: nevojat mbrojtëse përballë kontrollit imigrues", nga Eve Geddie, Platforma për bashkëpunim ndërkombëtar lidhur me migrantët e padokumentuar (PICUM), të botuar nga Raporti për mbikqyrje sociale evropiane 2009.  
viii. Politika e BEsë lidhur me migrimin për punë: pasoja për të drejtat e migrantëve", Nicola Flamigni dhe Rene Plaetevoet, të botuar në Raportin për mbikqyrje sociale evropiane 2009;  
ix. Eurochild, [www.eurochild.org](http://www.eurochild.org)  
x. <http://www.againstchildpoverty.com/employment/education/health/housing-casestudies.php>  
xi. "Shënimi hulumtues Nr. 1 lidhur me banimin dhe përfshirjen sociale", nga Erhan Özdemir dhe Terry Ward, nëntor 2009, të prodhuar nga Komisioni Evropian, më saktësisht nga Rrjeti i shpërndarjes së të ardhurave dhe kushtet jetësore të Observatorisë evropiane për gjendjen sociale dhe demografinë;  
xii. 2010 Raporti i ENAR's Ad Hoc Grupit ekspert lidhur me promovimin e barazisë në punësim, të disponueshme në: [www.enar-eu.org](http://www.enar-eu.org) ;  
xiii. 2009 Dimensionet sociale dhe ato të punësimit të Strategjisë së Lisbonit të BEsë për rritje dhe vende pune. Autorë: Mary-Ann Kate, Grupi për politika të migrimit;  
xiv. Migrimi dhe llojlojshmëria: Qasje e bazuar mbi të drejtat në migrim, dhjetor 2009;  
xv. "Varfëria në Evropë: Kufinj të padukshëm – një pengesë për përfshirje, Caritas Evropë, Dokumente të varfërisë 2010, [www.zeropoverty.org](http://www.zeropoverty.org)

### III. Sa i takon pjesës së tretë të botimit, kushtuar Republikës së Maqedonisë, e më larta përfshin (mes tjerave):

- i. Kushtetutën dhe ligjet specifike të Maqedonisë, të cilat mund të gjenden në: (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë), [www.sluzbenvesnik.org.mk](http://www.sluzbenvesnik.org.mk)
- ii. Strategjitë dhe Planet vepruese kombëtare, si dhe dokumente të tjera në sferat e punës dhe atë sociale, të cilat mund



të gjenden në: [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

iii. Programe kombëtare dhe dokumente të tjera strategjike lidhur me relacionet mes Maqedonisë dhe BEsë, të cilat mund të gjenden në: [www.sei.gov.mk](http://www.sei.gov.mk) ;

iv. Programe kombëtare dhe dokumente të tjera në sferën e shëndetësisë, të cilat mund të gjenden në: [www.moh.gov.mk](http://www.moh.gov.mk)  
v. Strategjia kombëtare për banim dhe dokumente të tjera nën kompetencat e Ministrisë për transport dhe lidhje, të cilat mund të gjenden në: [www.mtc.gov.mk](http://www.mtc.gov.mk) .

**Botime të tjera siqë janë (mes tjerave):**

- “Rrugës drejtë BEsë: një kontribut i shoqërisë civile në krijimin e politikave për përfshirje sociale në Republikën e Maqedonisë”, të disponueshme në: [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk) ;
- “Raport për varfërinë fëmijore ” të botuar nga Zyra e UNICEF Shkup;
- Raporti i progresit të Maqedonisë në zbatimin e OZHM të KB, i cili mund të gjendet në [www.undp.org.mk](http://www.undp.org.mk) ;
- Raporte të ndërlidhura me Dekadën e romëve, të cilat mund të gjenden në:
- [http://www.romadecade.org/mk\\_decade\\_watch\\_2008\\_2010](http://www.romadecade.org/mk_decade_watch_2008_2010);
- Organizata ndërkombëtare e punës dhe Këshilli i Evropës (2006), Shqyrtim i politikës së punësimit të Republikës së Maqedonisë, i cili mund të gjendet në: [www.ilo.org](http://www.ilo.org)
- Banka Botërore (2007), Vlerësimi i varfërisë në Republikën e Maqedonisë;
- Raporte mbikqyrëse lidhur me konventat e ndryshme të KiE, të cilat mund të gjenden në: [www.coe.int](http://www.coe.int)
- BE Raporti i progresit për Maqedoninë, i cili mund të gjendet në: [www.sei.gov.mk](http://www.sei.gov.mk)
- Raporte mbikqyrëse lidhur me konventat e ndryshme të KB, të cilat mund të gjenden në:
- <http://daccess-dds-ny.un.org/doc>



CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски",  
Скопје

364.662:341.24(4-672EU)

314.662:341.24(4-672EU)

364.662:340.13(497.7)

316.614:340.13(497.7)

KORNIZA ligjore dhe politike e të drejtave njerzore me fokus në  
përfshirjen sociale dhe uljen e varfërisë. - Shkup : Llundvig  
Bolltzman Instituti për të drejtat e njeriut – BIM-FV Shkup 2011. - 66 стр. ;  
21см

Публикацијата е во рамките на проектот: "Тë Drejtat Njerëzore dhe  
Përfshirja Sociale në Maqedoni". - Фусноти кон текстот. -  
Библиографија: стр. 65-66. - Содржи и: Shtojca 1-2

ISBN 978-608-65251-8-7

- а) Сиромаштија - Искоренување - Правна регулатива - Европска унија
  - б) Социјална инклузија - Правна регулатива - Европска унија
  - в) Сиромаштија - Искоренување - Законодавство - Македонија
  - г) Социјална инклузија - Законодавство - Македонија
- COBISS.MK-ID 88378634



KORNIZA LIGJORE  
DHE POLITIKE E TE  
DREJTAVE NJERZORE  
me fokus në përshirjen sociale dhe uljen e varfërisë

